



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
RININË DHE FËMIJËT

RAPORT MONITORIMI
PËR ZBATUESHMËRINË E STRATEGJISË KOMBËTARE TË RINISË 2022-2029
PERIUDHA JANAR - DHJETOR 2024

Tabela e përmbajtjes

1. INFORMACIONI PËRMBLEDHËS	3
1.1 REFORMA TË ZBATUARA ME SUKSES NË VITIN PËRKATËS	4
1.2 IMPAKTI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË NË PËRPUTHJE ME AGJENDËN E INTEGRIMIT EVROPIAN	10
1.3 KOMPONENTËT QË KANË NEVOJË PËR ADRESIM ME QËLLIM PËRMIRËSIMIN E IMPLEMENTIMIT	10
1.4 EKZEKUTIMI I PËRGJITHSHËM I MASAVE TË STRATEGJISË	11
2. PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKE, OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE MASAT	14
QËLLIMI I POLITIKËS I	14
QËLLIMI I POLITIKËS II	41
QËLLIMI I POLITIKËS III	76
3. VLERËSIMI I ARRITJEVE KRYESORE DUKE PËRDORUR TREGUESIT E PERFORMANCËS	102
4. VLERËSIMI I SFIDAVE, BOSHLLËQEVE, RISQEVE DHE HAPAT PËR TË ADRESUAR	112
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	113
6. HAPAT E RADHËS	115

1. Informacioni përmbledhës

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bazuar mbi VKM nr. 524 dt 22.09.2021 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët” harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve, garantimin e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën shoqërore dhe koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen, përkujdesjen, shëndetin, mirërritjen dhe mirë edukimin e fëmijëve.

Në këtë kuadër, Strategjia Kombëtare për Rininë 2022–2029, e miratuar me VKM nr. 692, datë 26.10.2022, përfaqëson dokumentin kryesor që orienton zbatimin e politikave rinore në vend. Ajo është ndërtuar mbi parimet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ku Neni 54 garanton mbrojtje të veçantë për të rinjtë: “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti”, si dhe mbi Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, i cili krijon bazën ligjore për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve strategjike për këtë grupmoshë

Ky raport monitorimi synon të pasqyrojë ecurinë e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022–2029, duke vlerësuar progresin e arritur, sfidat e hasura dhe ndikimin e masave të ndërmarra në funksion të objektivave strategjike për përmirësimin e jetës së të rinjve në Shqipëri përgjatë vitit 2024.

Dokumenti SKR 2022 – 2029 ka parashikuar realizimin e tre qëllimeve të politikës, si vijon:

Qëllimi i politikës I: *Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t’u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.*

Qëllimi i politikës II: *Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.*

Qëllimi i politikës III: *Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social.*

Siç paraqitet edhe në mënyrë më të zgjeruar në këtë raport monitorimi, gjatë kësaj periudhe janë shënuar një sërë zhvillimesh dhe arritjesh të rëndësishme në fushën e rinisë, në kuadër të përmbushjes së tre qëllimeve politike që qëndrojnë në bazë të SKR-së.

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 përcaktohet në pjesën e saj të katërt “Zbatimi, Llogaridhënia dhe Koordinimi”. Është përdorur metodologjia e monitorimit të bazuar në standardet IPSIS që përcakton se si do të kryhet procesi i monitorimit dhe vlerësimit me qëllim krijimin e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit të të dhënave të të gjithë institucioneve të përfshira në zbatimin e sistemit IPSIS. Kështu parashikohet se, zbatimi efektiv dhe i suksesshëm i SKR 2022-2029 do të arrihet përmes një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për të verifikuar progresin në plotësimin ose jo të objektivave specifike dhe masave të vendosura në Planin e Veprimit. Sipas SKR-së, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të secilit objektiv specifik dhe masave, mbi buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi.

Në këtë raport përfshihet: raporti i monitorimit 6 mujor për periudhën korrik-dhjetor 2024 me qëllim monitorimin e zbatueshmërisë së masave të SKR gjatë kësaj periudhe, ndërsa për realizueshmërinë financiare është marrë në konsideratë i gjithë viti 2024.

Ndërkohë nga monitorimi i zbatimit të masave të parashikuara në SKR 2022-2029, për vitin 2024 rezulton se:

Për periudhën raportuese, janar 2024 - Dhjetor 2024, ka vijuar zbatimi i tre Qëllimeve të Politikës. Për Qëllimin e Politikës I janë raportuar 16 masa, për Qëllimin e Politikës II janë raportuar 11 masa, dhe për Qëllimin e Politikës III, janë raportuar 14 masa. Në total janë raportuar 41 masa.

Monitorimi financiar është bërë në nivel masash, objektivash specifike dhe qëllimesh të politikës. Për secilën masë, objektiv ose qëllim janë krahasuar vlerat e raportuara financiare me vlerat e planifikuara në momentin e miratimit të strategjisë për secilin nga zërat e buxhetit që janë (i) paga dhe sigurime shoqërore (ii) materiale, shërbime dhe kontigjenca dhe (iii) shpenzime kapitale.

Norma e realizimit të shpenzimeve kapitale është 106%, norma e realizimit të pagave dhe sig shoqërore është 72%, ndërkohë që norma e realizimit të materiale, shërbime dhe kontigjenca është në vlerën 83%. Arsytet e detajuara jepen më poshtë për secilin qëllim apo objektiv apo masë të strategjisë.

Norma e realizimit të fondeve totale të strategjisë është 86%. Nëse bëhet krahasimi i realizimit të shpenzimeve për tre qëllimet e politikës të strategjisë vihet re se norma e realizimit luhet nga njëri qëllim në tjetrin, ku realizueshmëria sipas 3 Qëllimeve të politikës është përkatësisht:

- për Qëllimin e I-rë të politikës 83%,
- për Qëllimin e II-të të politikës 91%,
- për Qëllimin e III-të të politikës 72%,

1.1 Reforma të zbatuara me sukses në vitin përkatës

Masat dhe aktivitetet e mëposhtme, reflektojnë reformat, programet dhe projektet specifike të ndërmarra në funksion të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe Planit të Veprimit për periudhën referuese 1 Korrik 2024-31 Dhjetor 2024, grupuar sipas qëllimeve politike:

- Q1: Të rehat dhe të rinjtë marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërat e tyre.

Rishikimi i Ligjit për Rininë për të konsoliduar dhe zhvilluar më tej bazën ligjore me fokus organizatat rinore, përfaqësimin rinor, punën rinore dhe ofrimin e shërbimeve të pranueshme e miqësore për të rinjtë ka vijuar me ecuri të shpejtë. Grupi i Punës është mbledhur tre herë gjatë periudhës së raportimit dhe puna ka qenë e fokusuar kryesisht në zbardhjen dhe përpunimin të dhënave dhe rekomandimeve pas zhvillimit të turit të konsultimeve me të rinjtë, workshopit me organizatat e shoqërisë civile dhe rekomandimet e përcjella pranë MSHRF nga aktorë të ndryshëm shoqërorë gjatë kësaj periudhe. Pas konsultimit të realizuar edhe me ekspertët e projektit UNOPS për harmonizimin e propozimeve ligjore me rekomandimet e Këshillit Evropian, Janë hartuar dokumentet përkatëse (Projektligji dhe relacioni shoqërues) dhe janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike

(RENJKP). Projektligji është dërguar për mendim pranë Ministrive të linjës dhe Këshillit Konsultativ Qeverisjes Qendrore-Vetëqeverisjes Vendore. Në vijim, grupi i punës është angazhuar në reflektimin e propozimeve dhe sugjerimeve të Ministrive/Ministrave me qëllim finalizimin e procesit dhe përcjelljen e tij për miratim në Këshillin e Ministrave, në përputhje me parashikimet në Planin e Veprimit të SKR-së, si dhe raportimet përkatëse në PPAP 2024 dhe Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian PKABE 2030.

Ngritja e Këshillave Vendorë Rinorë në 61 bashkitë e vendit ka qenë në fokus të punës së MSHRF-së dhe AKR-së. Në të 61 bashkitë e vendit janë ngritur KVR-të, krahasuar me 8 bashki me KVR të ngritura në vitin 2021 kur nisi ky proces. Me ngritjen dhe konstituimin e të gjithë KVR-ve dhe punësimit të punonjësve rinorë në bashkitë e vendit, fokusi ka kaluar në fuqizimin dhe përmirësimin e punës së këtyre strukturave.

Përgjatë vitit 2024 MSHRF dhe AKR kanë vijuar me zhvillimin e aktiviteteve me fokus ngritjen e kapaciteteve të të rinjve të angazhuar në këto struktura¹. Megjithatë, mbetet ende punë për të bërë² që këto struktura ende të reja, të kthehen në mekanizma efektive të nxitjes, zhvillimit dhe menaxhimit të politikave rinore në bashki. Përveç nevojës për ngritjen e kapaciteteve të vetë këtyre strukturave, pengesë për funksionimin efektiv të tyre mbetet edhe mungesa e informacionit e të rinjve mbi instrumentet ligjore në dispozicion të tyre. Kjo ndikon drejtpërdrejt në mos përfshirjen e tyre në proceset vendim-marrëse, sidomos në bashkitë e vogla dhe zonat rurale.

Lidhur me miratimin e marrëveshjes së financimit për programin kombëtar IPA 2022 me BE-në³, dhe parashikimit në program të dokumentit të veprimit BE-ja për Rininë, është punuar në hartimin e projekt

¹ Në datat 29-31 korrik u zhvillua aktiviteti "Rinia ndryshon ligjet". Në këtë aktivitet ishin të pranishëm 110 të rinj anëtarë të KVR-ve, qeverive të nxënësve, grupet Impakt etj. Gjatë këtij aktiviteti, ndër të tjerat, të rinjtë patën mundësi të shprehnin mendimet e tyre lidhur me ndryshimin e "Ligjit Për Rininë" si dhe për "Ligjin për Vullnetarizmin".

Në kuadër të bashkëpunimit me Deloitte Albania & Kosovo në datë 11 korrik u realizua trajnimi me temë "Aftësitë komunikuese dhe e folura në publik" në të cilin morrën pjesë 20 të rinj nga KVR-të, të rinj aktivë si dhe punonjës të Rinorë të Bashkisë Kamëz.

- Në datat 14-15 Nëntor 2024 në qytetin e Elbasanit, u zhvillua Shkëmbimi Rinor me këshillat vendorë rinorë të jugut, ku morren pjesë mbi 20 KVR përfaqësuar nga 50 të rinj. Të rinjtë diskutuan gjithashtu mbi aspektet ligjore të funksionimit të KVR-ve dhe aktivizmin qytetar e tyre në nivel lokal.

- Nëpërmjet Projektit me titull "ConnectED: Building Bridges, Creating Futures", financuar nga British Council në kuadër të programit Alternative Pathways-"Reduktimi i emigracionit ilegal nga Shqipëria në Mbretërinë e Bashkuar", përgjatë muajit dhjetor janë zhvilluar disa trajnime me të rinj të Këshillave Vendor Rinorë.

² Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis AKR dhe World Vision fokusi i të cilës është fuqizimi i KVR-ve, realizimi i manualeve për KVR-të dhe fuqizimin e stafit të AKR-së, në fund të vitit 2024 është përfunduar hartimi i manualit mbi Këshillat Vendor Rinorë dhe pritjet lançimi i tij.

³ Miratuar përmes vendimit Nr. 165, datë 24.3.2023 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2022, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III), <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/03/24/166>;

propozimit i cili përfshin tre fusha mbështetjeje, ku angazhimi i MSHRF dhe AKR vihet re në fushën e parë që ka mbështetja nga BE në masën 2 milion Euro:

- Fusha e mbështetjes #1: Pjesëmarrja qytetare e të rinjve, të drejtat e njeriut të të rinjve dhe vullnetarizmi i të rinjve dhe pjesëmarrja në zhvillimin e komunitetit lokal, kulturën dhe sportin;
- Fusha e mbështetjes #2: Arsimi dhe punësimi i të rinjve të grupeve vulnerabël;
- Fusha e mbështetjes #3: Aftësitë e shekullit të 21-të dhe këshillimi në karrierë për nxënësit e shkollave.

Në kuadër të realizimit të fushës së mbështetjes #1, *Pjesëmarrja qytetare e të rinjve, të drejtat e njeriut të të rinjve dhe vullnetarizmi i të rinjve dhe pjesëmarrja në zhvillimin e komunitetit lokal, kulturën dhe sportin*, parashikohen të angazhohen shërbime të asistencës teknike me synim rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e veprimtarisë së KKR-së dhe KVR-ve për angazhimin e të rinjve në vendimmarrje, informimin e të rinjve mbi mekanizmat e Ligjit për angazhimin në vendimmarrje, përmirësimin e kapaciteteve dhe ndërveprimet mes AKR-së, Bashkive, organizatave rinore/për të rinjtë dhe të rinjve në zhvillimin e politikave dhe veprimtarive rinore.

Strategjia Kombëtare për Rininë 2022–2029 ka përcaktuar në objektivat e veta *mbështetjen e ndërtimit, riparimit dhe rinovimit të hapësirave publike të projektuara për të rinjtë me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurt takimi dhe në kohën e lirë*. Ndërtimi i bibliotekave, qendrave rinore, parqeve dhe hapësirave të tjera rekreative të cilat janë miqësore, të hapura, të sigurt dhe të aksesueshme nga të rinjtë shihet si parakusht për të rritur dhe promovuar veprimtarinë rinore dhe siguruar një bazë për nxitjen e ndërveprimit social kulturor, vetë shprehjes dhe promovimit të zhvillimit të punës rinore.

Agjencia Kombëtare e Rinisë nëpërmjet thirrjeve të mëparshme për projekt-propozime për infrastrukturë rinore, për Njësitë e Vetqeverisjes Vendore ka financuar rikonstruksionin, ndërtimin, rindërtimin dhe vënien në funksion të qendrave rinore. Në datë 20 nëntor 2024 është hapur thirrja Publike numër 4 për Njësitë e Vetqeverisjes Vendore.

Organizatave shoqërisë civile nga vetë natyra e veprimtarisë së tyre, janë aktorë të përshtatshëm për *kthimin e këtyre strukturave apo strukturave të tjera ekzistuese në nyje sociale për pjesëmarrjen dhe aktivizimin rinor*. Gjatë periudhës raportuese ka vijuar procesi i monitorimit dhe përmbylljes së aktivitetit për projektet fituese të thirrjes Publike Nr.3, gjithashtu ka nisur implementimi i projekteve fituese të Thirrjes Publike Nr.4 nëpërmjet të cilës Agjencia Kombëtare e Rinisë po mbështet financiarisht 26 projekt-propozime të organizatave rinore/për të rinjtë me një shtrirje gjeografike në 30 bashki.

- Q2: Rritje e aftësive për punësimin e të rinjve, mbështetur nga shërbimet e këshillimit të karrierës dhe punësimit që janë të orientuara nga të rinjtë, rritja dhe përmirësimi i mundësive për të hyrë në tregun e punës në bazë të drejtësisë dhe të shanseve të barabarta;

Programi i Qeverisë 2021-2025 ka përcaktuar përmirësimin e aftësive për punë dhe inovacionin si një nga tri shtyllat për fuqizimin e konkureshmërisë së ekonomisë shqiptare. Në të gjitha takimet konsultuese për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022-29, të reja dhe të rinjtë kanë cilësuar *nevojën për rritjen e mundësive të tyre për punësim, këshillim për karrierë dhe zhvillimin profesional si çështjen me interesin më të lartë për to*. Kjo përfordhet edhe nga studimet e kryera nga organizatat të shoqërisë civile me të rinjtë në nivel vendor⁴.

Qeveria Shqiptare ka identifikuar sektorët e turizmit, teknologjisë së informacionit, energjisë dhe bujqësisë si sektorë parësorë për zhvillimin e vendit dhe që ofrojnë mundësitë më të mira për punësim dhe mirëqenie për të rinjtë e vendit. Parashikohet që ndikimi i drejtpërdrejtë e kësaj industrie në PBB të rritet me rreth 5.4% deri në vitin 2026, duke pasur kështu një rritje deri në 8%.

Rrjedhimisht edhe fokusi i politikave shtetërore për rritjen e punësimit dhe përmirësimin e kushteve të punësimit për të rinjtë, orientimi i karrierës së tyre, zhvillimi i sipërmarrjeve dhe nxitjes së inovacionit përmes mbështetjes së ideve të reja dhe start-ups nga të rinjtë, me qëllim parandalimin e rrjedhjes së trurit dhe nxitjes së të rinjve të kthehen nga migrimi, po synon këto sektorë.

Në mbështetje të nenit 14, pika 6 të Ligjit nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”, i ndryshuar, të pikës 14, Kreu V, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 61, datë 7.2.2024 “Për miratimin e kërkesave e të kriterëve që duhet të plotësojnë start up-et dhe lehtësuesit e startup-eve, të procedurave e të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kriterëve, procedurës së përzgjedhjes e të shpërblimit të anëtarëve të tyre, gjatë muajit shkurt 2024 është hapur Thirrja “për mbështetjen e kompanive startup nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse”.

Referuar të dhënave të publikuara nga Agjencia “Start UP Albania” për vitin 2024 janë përzgjedhur 94 fitues, të cilët do të përfitojnë nga financimi në tre faza të ndryshme të zhvillimit të tyre. Faza e parë e financimit është projektuar për mbështetjen e individëve në fazë ideje ku janë përzgjedhur 22 projekte, të cilët sigurojnë deri në 1.5 milionë lekë për ta realizuar dhe për të krijuar një bazë të qëndrueshme për sipërmarrjen e tyre. Për fazën e dytë janë përzgjedhur 54 projekte fituese, startup-e që tashmë kanë një produkt apo shërbim dhe kanë krijuar një prototip. Përfituesit e kësaj faze sigurojnë deri në 4.5 milionë lekë për të avancuar zhvillimin e biznesit të tyre dhe për të gjetur klientë të mundshëm në treg. Në fazën e tretë janë përzgjedhur 18 startup-e fituese, të cilët ofrojnë një produkt në treg dhe me mbështetjen e siguruar nga Grant2024 do të zgjerojnë aktivitetet e tyre në tregje të reja. Startup-et në këtë fazë përfitojnë deri në 9 milionë lekë për të rritur dhe zhvilluar biznesin e tyre.

⁴ KRK “Implementimi i Ligjit 75/2019 “Për Rininë”: Perceptimi i të Rinjve dhe OSHC-ve”, dhjetor 2022, fq 19, “Në 90 % të rasteve të rinjtë kanë identifikuar punësimin si nevoja e tyre më imediate”.

Një instrument kryesor që po zhvillohet nga qeveria në bashkëpunim dhe me aktorët shoqërore dhe me financimin e Bashkimit Evropian është Programi Operacional i BE-së për punësimin rinor për Shqipërinë 2024-2027 (*i prezantuar si Garancia Rinore*), që do mbështesë të rinjtë jo në arsim, punësim apo trajnim (NEET) duke u garantuar atyre të drejtën për të vazhduar arsimimin, trajnimin ose sigurimin e një oferte pune, brenda katër muajve nga momenti kur mbeten të papunë ose largohen nga shkolla. Programi përfshin tre fusha mbështetje:

- Fusha 1: Punësimi Rinor
- Fusha 2: Arsimi profesional dhe trajnimi
- Fusha 3: Mbështetje të tjera teknike

Për të lehtësuar zbatimin me sukses të programit, me Vendimin nr. 173, datë 24.3.2023 të Këshillit të Ministrave është miratuar Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024 (YGIP). Faza fillestare pilot e programit ka nisur në vitin 2024. Ndërkohë AKPA ka vijuar punën me përshtatjen e skemave për nxitjen e punësimit duke u fokusuar në kombinimin e elementëve të mentorimit, edukimit të kombinuar mes institucionit të formimit profesional dhe vendit të punës dhe subvencionimin e pagës për individin e regjistruar në program, në përpunje dhe me vlerësimet nga studimet e kësaj çështje⁵, si dhe ka vijuar me digjitalizimin dhe rritjen e aksesueshmërisë të shërbimeve të veta dhe zyrat rajonale të punësimit, për të lehtësuar tranzicionin nga shkolla në tregun e punës për të rinjtë.

Në kuadër të zbatimit të programi operacional të BE-së për punësimin rinor për Shqipërinë 2024-2027 parashikohet që në kuadër të *fushës së mbështetjes 1, Punësimi Rinor, produkti 1.1.1 zbatimi i aktiviteteve promovuese me të rinjtë për mbështetjen e përfshirjes së tyre në tregun e punës*, të ketë një thirrje të dedikuar për projekt-propozime të organizatave të shoqërisë civile rinore/për të rinjtë me fokus promovimin dhe tërheqjen e të rinjve NEET në skemat mbështetëse të programit.

Duke qenë se lançimi i thirrjes pritet të ndodhë në vitin 2025, ai nuk ndikon në fondet e angazhuara për mbështetjen e rinisë për vitin 2024, *por do duhet të mbahet në konsideratë për vlerësimin e nevojave dhe përparësive për financim për rininë për vitin 2025.*

- Q3: Mirëqenie aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve;

Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-29 mbështet objektivat e strategjisë së promovimit shëndetësor duke synuar adoleshentët dhe të rinjtë e vendit, përmes rritjes së ndërgjegjësimit shëndetësor dhe duke krijuar mjedise mbështetëse për mënyra më të shëndetshme jetese, duke trajtuar çështje që përfshijnë ushqimin, veprimtarinë fizike, dhunën, pirjen e duhanit, alkoolin, drogën, shëndetin mendor, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe planifikimin familjar.

Organizatat e shoqërisë civile nga vetë natyra e punës dhe ndërlidhjeve të tyre në komunitet, janë aktorë të përshtatshëm për nxitjen e ndërgjegjësimit, këshillimit, aktivizimit dhe punës vullnetare me të rinjtë në kushte rreziku, vulnerabiliteti dhe marginalizimi, për promovimin e jetesës së

⁵ B.Bino, G. Hajdari, Udhërrëfyes për Tranzicionin e të Rinjve nga Shkolla në Vendin e Punës (TSP).

shëndetshme dhe mirëqenies mendore, sociale, fizike dhe seksuale të tyre dhe për nxitjen dhe lehtësimin e aksesit të tyre në shërbimet shëndetësore.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të Qëllimit 3 të politikës të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022 - 2029, si dhe të Strategjisë Kombëtare të Shëndetësisë dhe Planit të Veprimit për Shëndetin Mendor 2023–2026, i cili vendos në fokus të veçantë shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, gjatë vitit 2024 ka realizuar një sërë aktivitete duke angazhuar Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor, trajnime të stafit mjekësor në lidhje me shëndetin mendor, hartim manuali “Si të flasim për shëndetin mendor me nxënësit” nga ekspertë të ASCAP dhe ISHP, etj, të cilat janë të zbërthyera konkretisht në masat specifike në vijim të këtij raporti.

Gjuthashtu, Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), kanë krijuar një faqe të posaçme për raportimin e përmbajtjeve të paligjshme gjatë shfletimit në internet⁶. Ky shërbim synon të ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë të raportojnë lidhje të paligjshme/të dëmshme, që hasen gjatë shfletimit në internet. Raportimet trajtohen me konfidencialitet të plotë nga autoritetet përgjegjëse për të ndërmarrë veprimet e duhura, si dhe për të marrë masa të menjëhershme ndaj këtyre përmbajtjeve. Në faqen zyrtare të MAS-it, dhe institucioneve vartëse të saj, që lidhen me portalin online www.cesk.gov.al të AKCESK-ut, është vënë në funksion shërbimi “Raportoni përmbajtje të paligjshme”, për bllokimin e aksesit në faqet e internetit me përmbajtje të paligjshme.

ASCAP ka hartuar "Manualin për sigurinë në internet", një material i cili ofron një paketë udhëzimesh dhe këshillash lidhur me promovimin e përdorimit të internetit në mënyrë të sigurt dhe efektive nga ana e nxënësve dhe mësuesve. Në vijim, gjatë vitit 2024 janë zhvilluar takime informuese dhe ndërgjegjësuese për sigurinë në internet, me përfshirjen e të gjitha grupmoshave. Në fokus kanë qenë adoleshentët, rrjetet sociale dhe komunikimi me prindërit.

Sporti është një mjet i vlefshëm për nxitjen e jetesës së shëndetshme, edukimin me vlerat e mira dhe largimin nga veset e të rinjve. MSHRF në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar në përgatitjen e zbatimit të programit të ekipeve sportive në shkolla në disiplinat volejboll dhe basketboll. Gjatë vitit 2024 janë angazhuar në program 10 647 vajza dhe djem në 757 ekipe në çdo bashki e vendit.

Në kuadër të realizimit të fushës së mbështetjes #1 *Pjesëmarrja qytetare e të rinjve, të drejtat e njeriut të të rinjve dhe vullnetarizmi i të rinjve dhe pjesëmarrja në zhvillimin e komunitetit lokal, kulturën dhe sportin*, të kontratës BE për Rininë, parashikohet angazhimi i një komponenti grantdhënie për organizatat e rinore/për të rinjtë me fokus nxitjen e veprimtarisë sportive së të rinjve në kushte të cënueshme, minoritetet dhe me aftësi të kufizuara. Duke qenë se angazhimi i kontratës parashikohet të ndodhë në vitin 2025, ai nuk ndikon në fondet e angazhuara për mbështetjen e rinisë për vitin 2024,

⁶ <https://cesk.gov.al/raporto/>

por do duhet të mbahet në konsideratë për vlerësimin e nevojave dhe përparësive për financim për rininë për vitin 2025.

Në të njëjtën linjë, nevoja për më shumë veprimtari edukative, argëtimi, artistike, kulturore, muzikore ka qenë një nga kërkesat më të artikuluar nga vetë të rinjtë gjatë vlerësimit të nevojave për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-29. Një nisëm e iniciuar nga MSHRF gjatë vitit 2022 ka qenë hartimi i Programit Jashtë Orarit Mësimor (JOM) si një program jashtë shkollor në 5 disiplina: arte, zeje, agrikulturë dhe mjedis, sport, dhe teknologji për fëmijët dhe të rinjtë. Gjatë vitit 2024 programi ka vijuar zbatimin e programit në 200 shkolla në të gjithë vendin dhe me përfitues rreth 10,000 të rinj. Edhe gjatë vitit 2024 po vijon puna për shtrirjen e programit në shkollat e tjera të vendit dhe për konceptimin e nivelit të dytë të tij që synon formimin e talenteve më të spikatura.

Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor RYCO ka lançuar një program të ri të quajtur Fondi Kulturor i Rinisë së Ballkanit Perëndimor që në vitin 2023 i cili do të ketë 10 thirrje të hapura deri në vitin 2026.

Përmes punës dhe veprimtarisë së organizatave rinore/për të rinjtë *mund të nxitet angazhimi dhe krijimtaria e të rinjve në dimensionet artistike, kulturore, sociale dhe edukative dhe përcimi i vlerave tek bashkëmoshatarët e tyre.*

1.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e Integrimit Evropian

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 e miratuar përmes vendimit Nr.692, datë 26.10.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022-2029”, është një dokument i cili ishte parashikuar në PPAP 2022 dhe PKIE 2022-2024 si pjesë e Kapitullit 26 “Arsimi dhe Kultura”.

Implementimi me sukses i masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe përafrimi i tyre me agjendën e integrimit në Bashkimin Evropian, ndihmon në përmbushjen e prioriteteve të integrimit dhe përmbushjen e kriterëve thelbësorë dhe të nevojshme për funksionimin si një shtet me parime Evropiane.

Në këtë kuadër, në përfundim të proceseve screening në BE, rinia si pjesë e Kap. 26 “Arsimi dhe Kultura”, ka vijuar raportimet periodike pranë strukturave Negociatore dhe Kryenegociatore lidhur me zhvillimet e fundit në këtë sektor. Konkretisht në PKIE 2025-2027, janë parashikuar dy ndryshime ligjore si vijon: Ndryshimi i “Ligjit për rininë” dhe ndryshimi i “Ligjit për vullnetarizmin”, në bashkëpunim edhe me institucionet e tjera të linjës. Projekligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për rininë”, pritet të miratohet gjatë Q1 të vitit 2025, ndërsa Ligji “Për vullnetarizmin” gjatë Q3 të vitit 2025. MSHRF vijon me raportimet periodike të zhvillimeve dhe arritjeve në fushën e rinisë si pjesë e grupit të punës të Kapitullit 26 po ashtu edhe në Nënkomitetin Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale.

Gjithashtu, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët raporton edhe në kuadër të Kap. 23 “Lufta kundër korrupsionit”.

1.3 Komponentët që kanë nevojë për adresim me qëllim përmirësimin e implementimit

Nga analiza e bërë për realizimin financiar të qëllimeve të politikës, objektivave specifike dhe masave respektive për vitin 2024 ka rezultuar që ka 7 masa të parealizuara që janë:

Masa të parealizuara:

Masa 1.1.3 Përmes platformës rinore “Të rinjtë për të Rinjtë” dhe formave të tjera të komunikimit social shpërndahen informacione dhe udhëzues për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje 2023-2029.

Masa 1.2.3 Në konceptin "Të Rinjtë për Të Rinjtë" zhvillohen dhe aplikohen shërbime të informacionit për të rinjtë dhe rininë. Në këtë portal krijohet një platformë informimi dhe shërbimesh për të rinjtë dhe organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë që do të mbështesë formimin, punësimin, edukimin, mirëqenien, zhvillimin dhe aktivizimin e tyre.

Masa 1.3.1. Krijohen baza të dhënash statistikore dhe studimore për rininë në Shqipëri përmes forcimit të kërkimit shkencor rreth rinisë si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe fuqizohet studimi i rinisë si fushë akademike dhe shkencore

Masa 1.3.2 Politikat zhvillimore rinore ndërtohen mbi analiza faktike dhe dokumentare.

Masa 1.3.3 Në përputhje me Ligjin për Rininë dhe aktin nënligjor të dalë në bazë dhe për zbatim të tij, zhvillohet baza e të dhënave për organizatat rinore dhe për rininë, duke përfutur edhe nga proceset e digjitalizimit të shërbimeve publike.

Masa 2.1.5 Përmirësohen programet dhe shërbimet që ofrojnë mbështetje për lëvizshmërinë e të rinjve dhe bashkëpunimin mes tyre brenda vendit e më gjerë.

Masa 2.1.6 Lehtësohet transporti publik ndërqytetas për të rinjtë, duke rritur lëvizshmërinë e tyre në qarqe.

Performanca e realizimit të masave të sipërcituara ka ndikuar në trendin e përgjithshëm të realizimit të tre qëllimeve të politikës të strategjisë dhe rekomandohet koordinimi i punës ndërmjet institucionit udhëheqës dhe institucioneve kontribuese për marrjen e hapave të nevojshëm konkretë për zbatimin e masave për secilin objektiv.

1.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i masave të strategjisë

Për periudhën raportuese, janar 2024 - Dhjetor 2024, ka vijuar zbatimi i tre Qëllimeve Politike. Për Qëllimin e Politikës I janë raportuar 16 masa, për Qëllimin e Politikës II janë raportuar 11 masa, dhe për Qëllimin e Politikës III, janë raportuar 14 masa. Në total janë raportuar 41 masa.

Realizimi Financiar

Analiza e realizimit financiar është realizuar duke u bazuar në informacionin e marrë nga institucionet kontribuese për secilën nga masat e objektivave specifike përbërës të qëllimeve të politikës.. Për çdo masë është ballafaquar vlera e planifikuar e kostove dhe vlera faktike për vitin 2024 për të tre zërat e

buxhetit të grupuar në (i) paga dhe sigurime shoqërore (ii) materiale, shërbime dhe kontigjenca dhe (iii) shpenzime kapitale. Grupimi bëhet duke u bazuar tek buxheti i shtetit dhe tek elementët e kostos që janë planifikuar sipas metodologjisë së IPSIS në planin e veprimit të strategjisë.

Hapat që janë ndjekur në monitorimin e realizimit të masave dhe rrjedhimisht edhe objektivave specifike dhe qëllimeve të politikës janë bazuar në parimet e monitorimit dhe më specifikisht janë:

1. Identifikimi i shpenzimeve të planifikuara në planin e veprimit të SKR për vitin 2024
2. Identifikimi i masave për të cilat është parashikuar që aktivitetet për realizimin e tyre të përfundojnë brenda 2023 dhe që janë shtyrë në kohë

Në rastet kur për arsye vendimmarrje, realizimi i masës është shtyrë në kohë, është bërë krahasimi duke u nisur nga buxheti i aktiviteteve që janë realizuar në 2023.

3. Identifikimi i masave për të cilat është parashikuar që aktivitetet për realizimin e tyre të fillojë pas vitit 2024 dhe që janë përafruar.

Në rastet kur për arsye vendimmarrje, realizimi i masës është sjellë përpara në kohë, është bërë krahasimi duke u nisur nga buxheti i aktiviteteve që janë realizuar në 2023.

4. Identifikimi i shpenzimeve faktike për të gjitha masat

Ky hap është edhe ai që paraqet më shumë vështirësi në mbledhjen e informacionit. Arsyet kryesore për këtë fenomen janë:


- a. ashtu si në vitet e mëparshme, mungon një metodologji standarde e monitorimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Mungesa e metodologjisë bën që institucionet publike të mos raportojnë fare të dhënat financiare, ose të raportojnë të dhëna të një cilësie të dobët;
- b. ka raste kur nuk vlerësohet monitorimi financiar i strategjisë pasi ka ndryshime të mëdha në krahasim me planin si pasojë e vendimmarrjeve insitucionale; Ndryshimet mund të jenë pozitive ose negative.
- c. burimet e informacionit për fondet e donatorëve janë të kufizuara dhe ka problematika në ndarjen e financimeve sipas viteve.

Për të shmangur këto vështirësi, të dhënat u morën nga raportimi i institucioneve, dokumente zyrtare, monitorimi të buxhetit vjetor, dokumenti i PBA publikuar nga Ministria e Financave dhe faqe zyrtare institucioni ku ka të dhëna financiare të raportuara dhe referencuara.

Në rastet kur cilësia e të dhënave ka qenë e dobët është gjykuar për realizimin e masës duke u nisur nga sasia dhe lloji i aktiviteteve që janë raportuar si të realizuara.


Rezultatet në nivel strategjie janë si vijon:

Realizimi i SKR për vitin 2024



Siç shihet edhe në grafik, norma e realizimit të shpenzimeve kapitale është 106% pasi ka pasur rritje fondesh në disa prej programeve në krahasim me parashikimet e vitit 2022 të dokumentit të miratuar të SKR 2022 - 2029. Norma e realizimit të pagave është 72% kurse norma e realizimit të shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime është 83%. Në nivel të agreguar, realizimi financiar për vitin 2024 është 86%.

Realizimi Strategjia dhe tre qëllimet



Vihet re se shpenzimet për të tre kategoritë e shpenzimeve variojnë nga njëri qëllim i politikës në tjetrin. Normën më të ulët të realizimit për paga dhe sigurime me 47% e kanë masat e qëllimit të tretë të politikës, ndërkohë qëllimi i parë ka normën e realizimit më të lartë prej 74%. Për shpenzimet kapitale, qëllimi i tretë i politikës nuk ka shpenzime të planifikuara, ndërsa për qëllimin e dytë evidentohet një mbirealizim i këtyre shpenzimeve. Ndërkohë për shpenzimet totale, qëllimi i tretë i politikës ka normën e realizimit më të ulët me 72%, ndërkohë qëllimi i dytë ka normën e realizimit më të lartë prej 91%.

2. Progresi i lidhur me qëllimet politike, objektivat specifike dhe masat

QËLLIMI I POLITIKËS I

Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore.


Qëllimi i Politikës I ka në përmbajtje të tij 3 Objektiva Specifikë dhe 16 Masa. Konkretisht Objektivi Specifik 1.1, me 9 masa, Objektivi Specifik 1.2, me 4 masa dhe Objektivi Specifik 1.3, me 3 masa. Për sa i përket raportimit mbi zbatimin e këtyre masave rezulton se është raportuar vijimi i zbatimit gjatë periudhës raportuese për të gjitha masat, por raportim financiar është bërë për 8 nga 9 masa të objektivit specifik 1, pra raportim financiar është bërë për 15 masa. Ky qëllim i politikës zbërthehet në masa që lidhen me rishikimin e legjislacionit në fuqi në fushën e rinisë, pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, nëpërmjet ngritjes dhe fuqizimit të mekanizmave/institucioneve në nivel vendor dhe qendror, si dhe në shkolla/universitete, mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e rinisë, si dhe hartimin e politikave rinore mbi baza shkencore dhe analiza faktike.

Përmbledhje për Qëllimin e Politikës 1

Realizimi Financiar

Për këtë qëllim të politikës janë analizuar 16 masa pasi për të gjitha masat e parashikuara këtu, viti i fillimit të zbatimit ka qenë kanë përpara vitit 2024. Realizimi i masave në bazë të analizës financiare për të tre objektivat e qëllimit të parë është si më poshtë:

Statusi i realizimit të masave të Qëllimit I




Siç vihet re rreth 67.% e masave janë realizuar ose janë pjesërisht të realizuara. Në analizën e mëposhtme do evidentohen edhe arsyet e mosrealizimit të 33% të masave që lidhen drejtpërdrejtë me ngritjen e platformës Të Rinjtë për Të Rinjtë.

Në bazë të analizës së masave kalohet tek analiza e realizimit të objektivave specifike dhe qëllimit të politikës përkatëse. Për këtë qëllim të politikës dhe dy qëllimet e mëtejshme është analizuar edhe realizimi nga ana financiare dhe rezultoni se zëra të ndryshëm të shpenzimeve kanë nivel realizimi të ndryshëm.

Realizimi i fondeve totale të këtij qëllimi të politikës është 83%. Kurse pjesa që përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 74%. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 81%, ndërkohë shpenzimet kapitale kanë një normë realizimi prej 93%.

Realizimi Qëllimi I dhe tre objektivat




Ashtu si edhe për objektivat specifike dhe masat e këtij qëllimi apo dy qëllimet e tjera me objektivat dhe masat përkatëse, mund të thuhet se ka masa, realizimi i të cilave është shtyrë në kohë, pra ka filluar në 2023 dhe si rrjedhim aktivitetet janë përfunduar ose janë zhvilluar edhe në 2024 ashtu siç edhe ka masa dhe objektiva, realizimi i të cilave është sjellë përpara në kohë si pasojë e vendimmarrjes qeveritare apo edhe e ofrimit të mbështetjes nga donatorë të ndryshëm, që në kohën e hartimit të strategjisë nuk ishte e planifikuar. Shembull mund të jepet masa që lidhet me strehimin e çifteve të reja.

Objektivi specifik i tretë i këtij qëllimi ka normën më të ulët të realizimit në të gjithë zërat e buxhetit. Ndërkohë normën e realizimit më të lartë e ka objektivi specifik i dytë.

Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik. Gjithashtu jepet informacioni në lidhje me shkallën e realizimit nga ana financiare për secilin nga objektivat dhe masat përkatëse.

Objektivi Specifik 1.1: Të rinjtë janë të mirë-informuar rreth mundësive për të mësuar, fituar përvojë organizative dhe vullnetarizëm, dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën qytetare, sociale dhe politike.

Realizimi Objektivi 1.1 i SKR për vitin 2024



Realizimi i shpenzimeve totale është në masën 95%. Kurse pjesa që përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore kanë nivelin e realizimit prej 66%. Zëri materiale, shërbime dhe kontigjenca ka nivel realizimi 95%, ndërkohë shpenzimet kapitale kanë një normë realizimi prej 100%. Pjesa më e madhe e fondeve të realizuara janë fonde të buxhetit të shtetit

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

Masa 1.1.1. Rishikohet Ligji për Rininë për të konsoliduar dhe zhvilluar më tej proceset e krijimit të organizatave rinore, përfaqësimin rinor, punën rinore dhe ofrimin e shërbimeve të pranueshme e miqësore për të rinjtë.

Grupi Ndërinstitucional i Punës i ngritur me Urdhrin nr.13, datë 13.11.2023, të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë” me anëtarë nga kabineti i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencisë Kombëtare të Rinisë, ka vijuar punën për rishikimin e ligjit.

Gjatë hartimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, në periudhën korrik-dhjetor 2024, janë zhvilluar konsultime fizike dhe online me aktorët e synuar dhe grupet e interesit për ndërmarrjen e vlerësimit ex post të ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, akteve nënligjore dhe përgatitjes së propozimeve ligjore bazuar në vlerësimin e nevojave, synimeve, prioritetëve dhe propozimeve të aktorëve shoqëror ku përfshihen:

- Zhvillimi i turit të konsultimeve me të rinjtë **“Rinia ndryshon ligjet”**, gjatë muajit korrik 2024 në 11 bashki të vendit, përkatësisht Kurbin, Shkodër, Lushnjë, Kuçovë, Dibër, Durrës, Librazhd, Tiranë, Tropojë, Konispol. Me qëllim lehtësimin e marrjes së kontributeve nga të rinjtë u përgatitën materialet informuese dhe pyetësorët për të dy ligjet në version elektronik, të cilat ju prezantuan të rinjve përmes platformës Kahoot;
- Zhvillimi i Bootcampit në datat 29-31 Korrik 2024, gjatë të cilit anëtarët e Këshillave Vendorë Rinorë diskutuan lidhur me propozimet e tyre për Ligjin për Rininë në të cilin ishin të pranishëm 110 të rinj anëtarë të KVR-ve, qeverive të nxënësve, grupet Impakt etj, ku ndër të tjerat, të rinjtë patën mundësi të shprehnin mendimet e tyre lidhur me ndryshimin e ligjit Për Rininë.

- Gjithashtu në datat 30 gusht - 2 shtator u zhvillua kampi rinor "Rin Camp", i cili është një aktivitet i përvitshëm që synon të aktivizojë dhe mbështesë të rinjtë në angazhimin e tyre në sferën rinore, duke u fokusuar në ngritjen e kapaciteteve personale dhe profesionale, si dhe fuqizimin e tyre përmes një sërë aktiviteteve dhe trajtimeve të temave në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Një fokus i veçantë këtë vit ju kushtua edhe prezantimit të disa prej ndryshimeve në Ligjin e Rinisë dhe si dhe u diskutua me të rinjtë pjesëmarrës mbi nevojat dhe problematikat e hasura prej tyre.

Në vijim, grupi i Punës është mbledhur tre herë gjatë periudhës së tretë të raportimit dhe puna ka qenë e fokusuar kryesisht në zbardhjen dhe përpunimin të dhënave dhe rekomandimeve pas zhvillimit turit të konsultimeve me të rinjtë, workshopit me organizatat e shoqërisë civile dhe rekomandimet e përcjella pranë MSHRF nga aktorë të ndryshëm shoqërorë gjatë kësaj periudhe. Grupi i punës ka hartuar dokumentet përkatëse, si projektligj dhe relacion shoqëruar të cilat janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP) në datat 27.11.2024 - 25.12.2024.


Projektligji është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-aktet pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Këshillit Konsultativ Qeverisje Qendrore-Vetëqeverisje Vendore. Në vijim, grupi i punës është angazhuar në reflektimin e propozimeve dhe sugjerimeve të Ministrive me qëllim finalizimin e procesit dhe përcjelljen e tij për miratim në Këshillin e Ministrave, në përputhje me parashikimet në Planin e Veprimit të SKR-së, si dhe raportimet përkatëse në PPAP 2024 dhe Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian PKABE 2030.

Realizimi Financiar

Siç përshkruhet edhe më lart, për hartimin dhe miratimin e ligjit janë ndërmarrë një sërë veprimesh apo aktiviteteve, por zbatimi i veprimeve ka filluar në 2023. Gjithashtu në 2024 ka mbaruar edhe faza e konsultimit publik.

Përsa i përket monitorimit të kostove dhe shpenzimeve të planifikuara për këtë, vlen të theksohet që krahasohen fondet e planifikuara në 2023 me fondet e realizuara në 2024. Kjo vendimarrje u bë pasi siç u përmend më lart, puna për këtë masë ka filluar në 2023, me një zhvendosje të lehtë krahasuar me fund vitin 2022 kur u miratua SKR. Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 90%.

Realizimi Masa 1.1.1 i SKR për vitin 2024



Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100% pasi janë realizuar të gjitha aktivitetet në lidhje me hartimin dhe konsultimin e ligjit. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca, niveli i realizimit është 60%, ndërkohë shpenzimet kapitale nuk janë planifikuar.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 1.1.2 Forcohen mekanizmat (në nivel qendror dhe vendor) për të garantuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e të rejave apo të rinjve në vendim-marrje.

Më qëllim rritjen e prezencës së të rinjve në procese vendimmarrëse në nivel qendror dhe vendor, strukturat e Këshillave Vendore Rinore dhe Këshillit Kombëtar Rinor, janë mbledhur në mënyrë të vazhdueshme përgjatë vitit 2024 dhe një sërë iniciativash e arritjesh janë shënuar si vijon

Përsa i përket forcimit të mekanizmave në nivel qendror, për të garantuar pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, përforcimin e kapaciteteve dhe aftësive të Këshillit Kombëtar të Rinisë (KKR) për konsultimin dhe përfaqësimin e të rinjve në datë 06 Nëntor 2024, bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 75/2019 “Për Rininë”, u mbledh Këshilli Kombëtar i Rinisë, ku ishin prezentë anëtarët e mandatit të dytë të KKR-së. Në këtë mbledhje u prezantuan projektet fituese të Thirrjes III për grante për infrastrukturë rinore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, si dhe u diskutua mbi shpalljen e Thirrjes IV për këtë program. Gjithashtu, anëtarët u njohën me objektivat kryesore të Projektligjit për Vullnetarizmin, duke u ofruar një përmbledhje të strukturës dhe ndikimit të tij të pritshëm në promovimin e vullnetarizmit në vend.

Më datë 26 Dhjetor 2024, u mbledh sërish Këshilli Kombëtar i Rinisë. Në këtë mbledhje u prezantua Relacioni për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 75/2019, “Për Rininë”, duke u fokusuar në përmirësimet e propozuara dhe ndikimin që ato do të kenë në fuqizimin e mekanizmave rinorë në nivel kombëtar dhe vendor.

Në vijueshmëri të bashkëpunimeve ndërinstitutionale AKR ka realizuar një sërë aktivitete të përbashkëta me World Vision si, BOOT Camp, Rinia Ndryshon Ligjet, të cilat janë realizuar përgjatë periudhës Janar-Korrik 2024. Në 16 gusht është firmosur Marrëveshja e bashkëpunimit midis AKR dhe World Vision fokusi i të cilës është fuqizimi i KVR-ve dhe fuqizimin e stafit të AKR-së. Në fund të vitit 2024 është përfunduar hartimi i manualit mbi Këshillat Vendor Rinorë dhe pritet lançimi i tij në bashkëpunimin e vazhdueshëm midis AKR dhe World Vision.

Ndërkohë, referuar forcimit të mekanizmave të pjesëmarrjes rinore në nivel lokal, përmes ndërveprimit institucional, aktiviteteve ndërgjegjësuere në terren dhe shkëmbimit të praktikave më të mira nga MSHRF-ja dhe AKR-ja, ka vijuar puna me realizimin e aktiviteteve, trajnimeve dhe workshopeve të ndryshme.

Në datat 29-31 korrik 2024 u zhvillua aktiviteti "Rinia ndryshon ligjet". Në këtë aktivitet ishin të pranishëm 110 të rinjë anëtarë të KVR-ve, qeverive të nxënësve, grupet Impakt etj. Gjatë këtij aktiviteti, ndër të tjera, të rinjtë patën mundësi të shprehnin mendimet e tyre lidhur me ndryshimin e ligjit Për Rininë si dhe për Ligjin për Vullnetarizmin.

- Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Deloitte sh.p.k, me fokus fuqizimin e të rinjve dhe Anëtarëve të Këshillave Vendorë Rinorë. Në kuadër të SKR-së 2022-2029 dhe programit CareerLab të krijuar nga Deloitte, përmes këtij bashkëpunimi synohet realizimi i trajnimeve në fushën e aftësive të buta, në fushën ligjore, taksave, këshillimit financiar, sipërmarrjes, etj, si dhe fuqizimi i Këshillave Vendorë. Gjithashtu, në 19 Korrik 2024 midis AKR dhe Deloitte Albania Sh.P.K, u organizua trajnimi për 20 të rinj të Këshillave Vendorë të Kamzës me temën “Aftësitë Komunikuese dhe e Folura në Publik”.

Mbështetur financiarisht nga MSHRF dhe AKR, në Thirrjen Publike Nr.3 organizata “AlbAccess Open” në kuadër të projektit me titull “Vlerësimi i Jashtëm me Pjesëmarrje - Program i thelluar trajnimi“, ka zhvilluar në datë 6 Korrik në Bashkinë Kamëz trajnimin me pjesëtarë të KVR dhe personave të interesit, në të cilin u diskutua mbi përvetësimin e dijeve qytetare, demokratike dhe aftësive të nevojshme për angazhimin e tyre në proceset vendim-marrëse në nivel qendror dhe vendor, duke e shoqëruar me zbatimin në praktikë të dijeve të përfituara. Në këtë aktivitet morrën pjesë 10 të rinj.

Në datë 8 tetor 2024 në prani të Ambasadorit Britanik në Shqipëri Z. Abbott, Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Muzhaqi, u firmos marrëveshja e bashkëpunimit midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe British Council, si dhe u zhvillua ceremonia e lançimit të projektit të përbashkët “Alternative Pathways: Reduktimi i Emigracionit Ilegal nga Shqipëria në Mbretërinë e Bashkuar”.

Nëpërmjet këtij projekti 80 të rinj nga 8 Bashki të Qarkut Kukës, Dibër dhe Shkodër do të përfitojnë në mënyrë direkte, duke marrë pjesë në programe të cilat kanë për qëllim fuqizimin, mobilizimin dhe përfshirjen rinore në politikë dhe vendimmarrje. Në shkollën “Havzi Nela” në Kukës, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Muzhaqi dhe Ambasadori Britanik, z. Abbott, zhvilluan një diskutim të hapur me nxënësit rreth stereotipeve dhe keqkuptimeve mbi trafikimin njerëzor, duke i nxitur të mendojnë në mënyrë kritike. Në vijim, gjatë vizitës në Qendrën YES, së bashku me Këshillin Vendor Rinor dhe institucionet lokale, u shkëmbyen mendime dhe perspektiva mbi angazhimin komunitar dhe emigracionin në këto zona dhe nismat e përbashkëta që janë ndërmarrë e do të ndërmerren për të zbutur këtë fenomen.

Agjencia Kombëtare e Rinisë, nëpërmjet Projektit me titull “ConnectED: Building Bridges, Creating Futures”, financuar nga British Council, në datën 5 dhjetor në Bashkinë Kukës zhvilloi një aktivitet për lançimin e dy manualeve. Manuali i lidershipit, i cili trajton format dhe mënyrat për të krijuar dhe

për të zhvilluar aftësitë udhëheqëse të të rinjve. Si edhe manuali i përfshirjes rinore i cili ka në fokus konsultimin e të rinjve mbi mënyrat e përfshirjes në proceset vendimmarrëse në nivel qendror dhe vendor. Manuali do të trajtojë edhe ushtrimin e të drejtës së votës, (veçanërisht për votuesit për herë të parë), si një nga format e përfshirjes së të rinjve në vendimmarrje. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të pushtetit lokal, punonjësit rinor të bashkive, mësues nga shkollat 9-vjeçare, shkolla të mesme, punonjës të qendrës rinore, anëtarë të Këshillave Vendorë Rinorë (KVR), të rinj të qarqeve Dibër, Kukës dhe Shkodër.

Pas lancimit të manualeve, rreth 80 të rinj nga Këshillat Vendorë Rinorë u bënë pjesë e trajnimit 3-ditor, zhvilluar në datat 5, 6 dhe 7 dhjetor, mbi zhvillimin e lidërshipt, përfshirjen e të rinjve, si dhe tema që lidhen me storytelling dhe komunikimin publik. Në Qarkun e Dibrës në datat 21-23 dhjetor u zhvillua work-shop me titull " Të rinjtë dhe Komuniteti", në të cilin morrën pjesë 40 të rinj aktivë (24 vajza dhe 16 djem). Qëllimi i këtij aktiviteti ishte trajnimi i pjesëmarrësve mbi shkrimin e projekteve që kanë në fokus impaktin në komunitet, veçanërisht në mjedis dhe në trashëgiminë kulturore të bashkisë së tyre. Mbas përvetësimit të metodologjisë pjesëmarrësit u ndanë në 8 grupe dhe prezantuan projekt-propozimet që synojnë ofrimin e zgjidhjeve specifike për komunitetin.

- Në datat 14-15 nëntor, në qytetin e Elbasanit në ambientet e Univers Hotel u zhvillua Shkëmbimi Rinor me Këshillat Vendorë Rinorë të jugut, ku morrën pjesë mbi 20 KVR përfaqësuar nga 50 të rinj, të cilët zhvilluan takime informuese me ekipin e rinisë dhe trajnerë të ndryshëm, si dhe zhvilluan biseda me kryetarin e bashkisë së Elbasanit, qytetit pritës, z. Gledjan Llatja. Të rinjtë diskutuan gjithashtu mbi aspektet ligjore të funksionimit të KVR-ve dhe aktivizmin qytetar të të rinjve në nivel lokal.

Realizimi financiar

Siç përshkruhet edhe më lart, punonjësit e AKR kanë qenë të angazhuar gjatë gjithë vitit në koordinimin e aktiviteteve të ndryshme. Gjatë 2024 janë realizuar dhe janë mbështetur aktivitete si "Rinia ndryshon ligjet", si dhe bashkëpuime të ndryshme me aktorë të tjerë në kuadër të rritjes së angazhimit dhe fuqizimit të këtyre strukturave.

Gjatë 2024 është punuar për koordinimin e aktiviteteve të ndryshme të organizuara dhe realizimi i fondit të pagave ka qenë 100%. Mallra dhe shërbime ka realizim prej 100% pasi në kuadër të kësaj mase janë realizuar manualët dhe gjithashtu janë realizuar edhe trajnime të KVR-ve. Në 2024 janë ngritur të gjitha KVR.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar.**

Masa 1.1.3 Përmes platformës rinore “Të rinjtë për të Rinjtë” dhe formave të tjera të komunikimit social shpërndahen informacione dhe udhëzues për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje 2023-2029.

Kjo masë **nuk është realizuar ende.**

Realizimi financiar

Portali "Të Rinjtë për Të Rinjtë" nuk është ngritur ende dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në lidhje me ngritjen dhe përdorimin e tij nuk janë realizuar.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e parealizuar**.

Masa 1.1.4 AKR mbështet me anë të një programi grantesh organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes ngritjes së infrastrukturës për qendra rinore, biblioteka dhe hapësira për të rinjtë.

Në zbatim të ligjit nr.75/ 2019 "Për rininë", VKM nr. 681, datë 02.09.2020 "Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë", si edhe konform ndryshimeve ligjore, diktuar nga VKM nr. 566 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë", Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) në datë 20 nëntor 2024 ka hapur Thirrjen Publike Nr. 4 për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, me një grant të parashikuar prej 50 milionë Lekë, me fokus ndërtimin apo rikonstruksionin e objekteve publike dhe infrastrukturës rinore si qendra rinore, biblioteka apo qendra multifunksionale për të rinjtë. Thirrja qëndroi e hapur për 30 ditë, dhe me pas vijoi procesi i vlerësimit.

Ndërsa Thirrja Nr. IV për projekt-propozime për OSHC-të u hap në Prill 2024 dhe qëndroi hapur deri më Maj 2024 duke vendosur në dispozicion të të gjithë kandidatëve të interesuar paketën me dokumentacionin e konkurrimit për projekt-propozime rinore. Thirrja e IV e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, synoi të adresojë prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 sipas fushave të përparësisë si më poshtë:

- Nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe mbështetja e aktivizimit shoqëror dhe qytetar të tyre.
- Nxitja e punëve të denja dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës.
- Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve.

Gjatë periudhës së aplikimit janë zhvilluar 3 sesione informuese online dhe fizike.

Këto sesione informuese u zhvilluan me qëllim qartësimin e procesit të aplikimit për të gjithë OSHC-të e interesuara. Pas përmbylljes së procesit të vlerësimit dhe negocimit në muajin korrik 2024, AKR shpalli listën fituese. Në shtator nëpërmjet një aktiviteti u formalizua firmosja e marrëveshjeve me organizatat fituese dhe nisi monitorimi i zbatimit të projekteve. Nëpërmjet thirrjes së katërt për rininë, aktualisht po mbështeten financiarisht nga Agjencia Kombëtare e Rinisë 26 projekt-propozime të organizatave rinore/për të rinjtë në vlerën totale prej 70 milionë lekë. Thirrja publike Nr. IV në përfundim të saj synon mbështetjen dhe impaktimin pozitiv të rreth 27,634 të rinjve. Shtrirja gjeografike e projekteve fituese përfshin 30 bashki të vendit specifikisht: Dibër, Librazhd, Pogradec, Fier, Vlorë, Tiranë, Elbasan, Lushnjë, Prrënjë, Shkodër, Gjirokastër, Bulqizë, Lezhë, Korçë, Cërrik,

Gramsh, Tropojë, Kukës, Has, Vorë, Kamëz, Berat, Kuçovë, Dimal, Durrës, Delvinë, Rroskovec, Peqin, Kolonjë, Mat.

Nëpërmjet Thirrjes Nr. III për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore janë mbështetur financiarisht nga MSHRF dhe AKR 6 projekte me fokus ndërtimin apo rikonstruksionin e objekteve publike dhe infrastrukturës rinore prej të cilave kanë përfituar dhe vijojnë të përfitojnë 108,233 të rinj nëpërmjet projekteve të cilat kanë në fokus ngritjen e 5 qendrave multifunksionale rinore përkatësisht në Bashkitë Mat, Sarandë, Malësi e Madhe, Fier e Librazhd dhe rehabilitimin dhe përmirësimin e kushteve të qendrës rinore ekzistuese në Bashkinë Korçë. Buxheti i vënë në dispozicion për këtë thirrje për NJVV-të ishte 50 milion lekë, ku të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë bashkëfinancuar projekt-propozimin me të paktën 10% të shumës së financimit të kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë. Deri në Dhjetor të 2024 kanë përfunduar zbatimin e projekteve Bashkia Mat, Bashkia Korçë, Bashkia Librazhd dhe Bashkia Malësi e Madhe.

Gjatë vitit 2024 gjithashtu ka vijuar zbatimi i projekteve fituese të organizatave fituese nga thirrja 3.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të orgaizatave fituese dhe për të qenë sa më të qartë lidhur me metodologjitë e monitorimit dhe zbatimit të projekteve fituese, me datë 24-25 Shtator 2024, AKR ka zhvilluar 2 sesione informuese me organizatat fituese të Thirrjes IV lidhur me zbatimin e projekt-propozimeve. Gjatë këtyre sesioneve, përfaqësuesit e organizatave u udhëzuan dhe u informuan në detaje rreth afateve, procedurave për raportimin narrativ dhe financiar, raporteve progresive, si dhe raporteve të veçanta.


Gjithashtu në datë 04 Dhjetor 2024 u zhvillua një sesion informues, online, për stafin e NJVV-ve, gjatë të cilit ata u udhëzuan rreth dokumentacionit që duhet të paraqesin për aplikimin e tyre. Këto sesione informuese janë pjesë e përpjekjeve për të siguruar që të gjithë aplikantët të kenë informacion të plotë dhe të qartë rreth procesit të aplikimit dhe kërkesave të nevojshme për të qenë të përgatitur për të dhe zbatuar me sukses.

Realizimi financiar

Siç përshkruhet edhe më lart, në këtë masë përfshihet mbështetja e organizatave rinore dhe atyre për të rinjtë si dhe mbështetja infrastrukturore për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Realizimi i fondeve totale është 100% si për masën, ashtu edhe për zërat e veçantë të shpenzimeve të planifikuara.

Realizimi Masa 1.1.4 i SKR për vitin 2024



Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100% pasi AKR dhe MSHRF kanë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara. Edhe materiale shërbime dhe kontigjenca është realizuar 100% pasi këtu janë fondet e granteve që jepen për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë dhe shpenzimet për sesionet informuese. Gjithashtu është realizuar edhe trajnimi i stafit të AKR. Shpenzimet kapitale, që përfshijnë investimet në infrastrukturë, janë realizuar në masën 100%.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 1.1.5 Nxitet zhvillimi i një mjedisi shkollor përkrahës për të gjithë nxënësit dhe mbështetet bërja sa më aktive e Këshillave Studentore/Qeverive të Nxënësve dhe organizimeve të tjera të nxënësve.

Në kuadër të përditësimit të edukimit financiar dhe ekonomik në arsimin parauniversitar, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe bankat e nivelit të II, Junior Achievement Albania dhe World Vision Albania kanë përgatitur pilotimin e programit të Edukimit Financiar në sistemin parauniversitar. Synimi është që në çdo shkollë të arsimit parauniversitar në Shqipëri të ketë një program të mirëfilltë inovator që ndërlihd njohuritë ekonomike/financiare me aplikacione financiare, një sistem bonusi/shpërblimi për nxënësit në varësi të arritjeve gjatë vitit shkollor, të konvertuara në një vlerë monetare në llogaritë e secilit.

Më 5-6 tetor 2024, u organizua "Shkolla Rinore për Edukimin Financiar" në ambientet e Bankës së Shqipërisë, me pjesëmarrjen e të rinjve nga qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, ku një grup prej afro 60 të rinjsh të arsimit parauniversitar, u përfshinë në një workshop 2 ditor për të pilotuar këtë nismë të re. Të rinjtë provuan 10 metodologji të ndryshme mësimdhënieje të edukimit financiar, duke pasur mundësinë të shprehin mendimet e tyre përpara se të fillojë pilotimi i këtij programi në shkolla.

Ndërkohë që vijon puna e GNP në shqyrtimin e propozimeve të bankave, së shpejti do të fillojë pilotimi në disa shkolla, në mënyrë që të monitorohet zbatimi dhe në vitin tjetër shkollor, të fillojë zbatimi në një shkollë më të gjerë.

Në kuadër të bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë, në datat 24, 25 dhe 26 Korrik u zhvillua shkëmbimi kulturor "Trashëgimia dje, sot dhe nesër" organizuar nga MSHRF/AKR dhe MKRS Kosovë. Ky aktivitet përgjatë tre ditëve bëri bashkë 9 të rinj nga Shqipëria dhe 9 të rinj nga Kosova, me qëllim shkëmbimin kulturor dhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e trashëgimisë kulturore si pjesë e identitetit tonë kombëtar. Të rinjtë vizituan Kalanë e Ishmit, Amfiteatrin e Durrësit, Parkun Arkeologjik të Apolonisë dhe kalanë e Bashtovës. Gjithashtu në datat 21-23 Tetor u zhvillua shkëmbimi rinor në Kosovë, ku të rinjtë nëpërmjet këtij turi patën mundësinë të njihen me vende si, Çarshia e Vjetër e cila është zemra e ekonomisë në Gjakovë, Muzeun Etnografik të Gjakovës, Parkun Arkeologjik Ulpianës, Kalanë e Novobërdës, Lidhjen e Prizrenit, Muzeu Arkeologjik, Kalanë e Prizrenit, etj.


Gjithashtu në datat 30 gusht - 2 shtator u zhvillua kampi rinor "Rin Camp", i cili është një aktivitet i në Dhërmë, Vlorë, i financuar nga AKR, i përvitshëm që synon të aktivizojë dhe mbështesë të rinjtë në angazhimin e tyre në sferën rinore, duke u fokusuar në ngritjen e kapaciteteve personale dhe profesionale, si dhe fuqizimin e tyre përmes një sërë aktiviteteve dhe trajtimeve të temave në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Gjatë këtij kampi, rreth 110 të rinj dhe antarë të KVR morën pjesë dhe u trajtuan në tema të ndryshme, duke zgjeruar njohuritë e tyre në fusha si politikat rinore, strukturat rinore vendore, lidhshipi dhe aftësitë ndërpersonale, digjitalizimi i vendit të punës dhe arsimit, etj.

Realizimi financiar

Siç përshkruhet edhe më lart, në këtë masë përfshihen aktivitetet e ndryshme të sensibilizimit.

Realizimi i fondeve totale është në masën 70% dhe lidhet vetëm me zërin mallra, shërbime dhe kontigjenca.

Realizimi Masa 1.1.5 i SKR për vitin 2024



Në këtë masë janë parashikuar shpenzime vetëm për zërin e mallrave dhe shërbimeve të cilat po ashtu kanë një nivel realizimi 68%. Tek fondet e planifikuara përfshihet kosto e shkëmbimi kulturor "Trashëgimia dje, sot dhe nesër". Ndërkohë nuk ka informacion dhe nuk janë kryer aktivitete në lidhje

me mekanizmat e bashkëpunimit mes organeve përfaqësuese të nxënësve, studentëve, organizatave rinore, dhe qendrave rinore (pra konferencat rinore).

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë pjesërisht e realizuar**.

Masa 1.1.6 Rritet ndërgjegjësimi politik i të rinjve dhe në veçanti i vajzave dhe grave të reja, nëpërmjet promovimit të programeve të edukimit të votuesve dhe nismave të tjera ndërgjegjësuere.

Përgjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2024, është zhvilluar një fushatë intensive edukimi, informimi dhe sensibilizimi, të zgjedhësve në funksion edhe të përgatitjes së procesit zgjedhor 2025.

Në fushatë janë përfshirë target grupe të ndryshme në fokusin tonë, si të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuar, pakicat kombëtare që jetojnë në vendin tonë. Gjithashtu përgjatë vitit 2024 u përgatitën 3 draft programet e edukimit të zgjedhësve, për Zgjedhjet për Kuvend 2025, të cilët iu dërguan palëve të përfshira në procesin zgjedhor, si partive politike, organizatave vendase dhe të huaja për të marrë sugjerimet, të cilat më pas do të reflektoheshin në programet finale të miratuara me 3 vendime të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ku në të treja programet janë përfshirë të rinjtë (Vendimi 206, 207, 208 datë 11.12.2024 të KSHZ) të cilat mund të aksesohen në faqen zyrtare⁷.

1. Programi i Përgjithshëm që adreson të gjithë zgjedhësit⁸;
2. Programi i dedikuar i pakicave kombëtare që jetojnë në Shqipëri (ku përfshihen dhe të rinjtë)⁹;
3. Programi i dedikuar i personave me aftësi të kufizuar (PAK) (ku përfshihen dhe të rinjtë e PAK)¹⁰.

Programet e edukimit janë dokumente të rëndësishme, qëllimi dhe objektivat e të cilëve sigurohen nga përpjekjet e përbashkëta të të gjithë pjesëmarrësve. Palët e përfshira në këtë proces përveç institucioneve publike, janë edhe organizatat e Shoqërisë Civile që veprojnë në fushën e zgjedhjeve, partnerët ndërkombëtarë, me synim rritjen e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje.

Bashkëpunimi me Organizata të ndryshme pjesë e takimeve të institucionit me target grupet e ndryshme kanë rezultuar shumë frytdhënëse.

⁷ Për më shumë informacione klikoni në këtë faqe: www.kqz.gov.al

⁸ Për më shumë informacione klikoni në këtë faqe: [VendimKSHZ_2024_207_Per-miratimin-e-programit-te-informimit-te-zgjedhesve-Per-zgjedhjet-per-Kuvendin%20\(4\).pdf](#)

⁹ Për më shumë informacione klikoni në këtë faqe: [VendimKSHZ_2024_208_Per-miratimin-e-programit-te-informimit-te-pakicave-kombetare-2025%20\(3\).pdf](#)

¹⁰ Për më shumë informacione klikoni në këtë faqe: [VendimKSHZ_2024_206_Per-miratimin-e-programit-te-informimit-te-zgjedhesve-PAK%20\(2\).pdf](#)

U zhvilluan takime me organizatat e shoqërise civile që mbrojnë interesat e target grupeve të ndryshme, takime më të gjithë anëtarët e Komunitetit të pakicave kombëtare, për evidentimin e zonave ku zgjedhësit e këtyre pakicave jetojnë. Evidentimi i zonave ku jetojnë zgjedhësit e pakicave kombëtare ka qënë një vështirësi, përvec dy zonave të deklaruara sic janë Pusteci dhe Finiqi, zona në të cilat janë zhvilluar takime në shkollën e mesme të secilit vend, gratë dhe persona me aftësi të kufizuar.

Të rinjtë votues për herë të parë dhe studentët

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024 janë zhvilluar 24 workshop-e (aktivitete) me studentë dhe maturantë kryesisht votues për herë të parë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve, për të marrë pjesë në zgjedhje. Në sesionet informuese të zhvilluara me të rinjtë, diskutimet janë përqëndruar rreth rëndësisë së pjesëmarrjes në zgjedhje, mënyrës së votimit, parashikimeve ligjore për rastet e shitjes së votës, si dhe procesit të plotësimit të fletës së votimit dhe momenteve kur konsiderohet e pavlefshme.

Gjatë gjashtë muorit të dytë KQZ zhvilloi një konkurs “RIN-Krijon” me mbështetjen e partnerit tonë ndërkombëtar OSBE i cili synoi fuqizimin e të rinjve në procesin zgjedhor të vitit 2025, duke i angazhuar ata në krijimin e grafikave, videove dhe sloganeve, me qëllim përfshirjen e të rinjve në zgjedhje. Gjithashtu uorganizuan një seri takimesh në Universitete të ndryshme të vendit, në Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Elbasan, Durrës me qëllim përfshirjen e tyre në administratën zgjedhore, ose për tu bërë pjesë si operatorë të pajisjes së identifikimit elektronik (PEI) apo operatorët e votimit elektronik (PEVN).

Gjithashtu janë përfshirë në administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me kontratë të përkohshme të rinj, të rinj me aftësi të kufizuar dhe të rinj të minoriteteve, për procesin zgjedhor.

Realizimi Masa 1.1.6 i SKR për vitin 2024



Realizimi financiar

Siç përshkruhet edhe më lart, për realizimin e kësaj mase ka luajtur një rol të rëndësishëm KQZ dhe OSBE që e mbështet. Mbështetja e saj ka qënë e rëndësishme në hartimin e manualeve. Përsa i përket aktiviteteve të tjera, ato janë realizuar me fonde të buxhetit të shtetit dhe fonde të OSBE (“RIN-

Krijon”). Dy zërat e buxhetit të planifikuar që janë Paga dhe sigurime shoqërore dhe Mallra, shërbime dhe kontigjenca, janë realizuar me 100%.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 1.1.7 Promovohet dhe mbështetet e drejta e të rejave dhe të rinjve për vetë-shprehje në lidhje me orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor.

Të drejtat dhe liritë themelore të individit janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, pa përjashtim, dallim, apo diskriminim për arsye individuale, duke përfshirë orientimin seksual dhe shprehjen e identitetit gjinor. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, në bashkëpunim me institucionet në nivel qendror dhe vendor, OJF-të dhe partnerët ndërkombëtarë, MSHMS ka qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve ndërgjegjëse.

MSHMS po koordinon procesin për hartimin dhe miratimin e udhëzuesit në zbatim të protokollit Mjekësor Transgjinor, i cili nisi me ngritjen e grupit ndërsektorial të punës, si dhe me konsultimin e tij edhe me përfaqësues nga OJF-të, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së personave LGBTI+. Janë zhvilluar disa takime konsultuese me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Aleanca LGBT, Bashkia Tiranë dhe përfaqësues nga qendra për trajtimin e rasteve LGBTI+. Qëllimi ka qenë prezantimi i protokollit, për parandalimin dhe trajtimin e praktikave të dëmshme ndaj personave LGBTI+.


Në kuadër të Masës 1.1.7, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) ka mbështetur organizatën “OMSA” për projektin me titullin “Diversiteti dhe Gjithëpërfshirja për Komunitetin LGBTIQ+”. Qëllimi i këtij projekti është të sigurojë një shoqëri më të barabartë, më të diversifikuar dhe më të përfshirë për të gjithë pjesëtarët e komunitetit LGBTIQ+ në Shqipëri. Për të arritur këtë qëllim, projekti synon të bashkëpunojë ngushtë me bashkitë në disa qytete të rëndësishme, si partnerë kyç për implementimin e aktiviteteve dhe për të garantuar një ndikim të qëndrueshëm dhe të gjerë në nivel lokal. Projekti shtrihet në bashkitë Tiranë, Shkodër, Lezhë, Librazhd.

Realizimi financiar

Në këtë masë përfshihet promovimi i të drejtës së të rinjve/të rejave për vetë-shprehje.

AKR ka mbështetur këtë promovim nëpërmjet thirrjes për projekte për organizatat rinore dhe për të rinjtë edhe pse buxheti i kësaj mase është planifikuar me donatorë. Një projekt është financuar me fonde të buxhetit të shtetit për organizatën “OMSA” për projektin me titullin “Diversiteti dhe Gjithëpërfshirja për Komunitetin LGBTIQ+”. Gjithashtu Këshilli i Europës ka mbështetur aktivitete në këtë fushë, ku MSHRF është pjesë e Komitetit Drejtues Steering Committee në “Advancing the Protection from Discrimination in Albania”, me takime të realizuara në 23 shtator 2024.

Realizimi Masa 1.1.7 i SKR për vitin 2024



Realizimi i fondeve totale është 88% pa përfshirë financimin e projektit të lartpërmendur pasi fondet për këtë projekt janë të përfshira në një masë tjetër të këtij objekti. Kurse përsa i përket zërave specifikë mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100% pasi stafi i MSHMS ka marrë pjesë në aktivitetet ndërgjegjëse. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit (pa përfshirë projektin e financiar) është 88% pasi mosngritja e portalit “*Të rinjtë për të rinjtë*” bën që kostot e planifikuara për promovimin nëpërmjet këtij portali të mos jenë plotësuar.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 1.1.8 Rishikohet ligji “Për vullnetarizmin”, me qëllim fuqizimin e mundësive për vullnetarizmin e të rejave/rinjve.

Hapat e ndërmarra në lidhje me procesin e rishikimit të ligjit 45/2016 “Për vullnetarizmin”, janë si vijon:

Ligji 45/2016 “Për vullnetarizmin”, u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë me iniciativë të një grupi deputetësh, duke ngritur kornizën ligjore për zhvillimin e vullnetarizmit në Republikën e Shqipërisë. Ligji në nenin 2 të tij, parashikon se ky rregullim ka si qëllim rritjen e angazhimit qytetar dhe rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, si dhe zhvillimin e vlerave të solidaritetit njerëzor.

Pas miratimit të ligjit janë miratuar dhe aktet nënligjore: Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 506, datë 17/07/2019 “Për miratimin e Kodit të Etikës së Vullnetarëve”; Urdhri i MFE Nr. 229/2018 “Mbi formatin dhe përmbajtjen e Kartës së Vullnetarit” dhe Urdhri i MFE NR 300/ 2018 “Mbi formatin dhe përmbajtjen e Regjistrimit të Kontratës së Vullnetarizmit”.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit janë: Ministria përgjegjëse për çështjet e punës dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (pas ristrukturimit të shërbimit kombëtar të punësimit). AKPA ka detyrën të regjistrojë institucionet që janë të gatshëm të ofrojnë punë vullnetare, të lëshojë një numër reference dhe këto institucione mund të regjistrojnë më pas individë dhe t’i pajisin ata me librezë personale regjistrimi (Libreza e Vullnetarit) dhe dokumentet përkatëse.

Përmes urdhrit të Kryeministrit Nr 9, datë 17.1.2024, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës dhe në vijim është mbajtur takimi online më 04.07.2024, mes GNP-së dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile me fokus konsultimin e propozimeve të grupit të punës për çështjet që do të adresohen në kuadër të rishikimit të ligjit për vullnetarizmin.

Është realizuar më datë 09.07.2024, në Tiranë aktiviteti për “Ligjin për vullnetarizmin” në Shqipëri - si prioritet për zhvillimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin European, me rreth 50 përfaqësues të shoqërisë civile, organizatave aktive dhe kontribuese për vullnetarizmin në Shqipëri, përfaqësuesve të MSHRF, MEKI, AKPA, AKR si dhe të rinj e vullnetarë, me fokus diskutimin, dhënë rekomandime dhe sugjerime në kuadër të nevojave dhe çështjeve që duhen të adresohen në projekt-ligjin e ri, si dhe ndarjen e eksperiencave dhe praktikave më të mira europiane sa i përket kuadrit ligjor dhe zbatimit të politikave të suksesshme për vullnetarizmin.

Më datë 10.07.2024 është zhvilluar Takimi i GNP-së pranë zyrave të AKPA-s, i mbajtur bashkërisht me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertë ndërkombëtarë për vullnetarizmin, për diskutimin elementëve specifik të ligjit dhe qasjet për adresimin e tyre, bazuar në përvojën ndërkombëtare.


Gjatë muajit korrik 2024, u zhvillua Turi i Konsultimeve me të Rinjtë “Rinia Ndryshon Ligjet” për rishikimin e ligjit "Për Vullnetarizmin" përmes takimeve të organizuara dhe të drejtuara nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me mbështetjen e grupit të punës, duke përfshirë takime të veçanta në 11 bashki të vendit përkatësisht: Kurbin, Shkodër, Lushnjë, Kuçovë, Dibër, Durrës, Librazhd, Tiranë, Tropojë, Konispol dhe në një Bootcamp të dedikuar tre ditor. Ky tur u zhvillua me qëllim lehtësimin e marrjes së kontributeve nga të rinjtë.

Është realizuar një konsultim më datë 25.11.2024 me ekspertët e projektit UNOPS për harmonizimin e propozimeve ligjore me rekomandimet e Këshillit Evropian.

Grupi i punës ka hartuar dokumentet përkatëse, projektligj, relacion shoqërues dhe janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP) në datat 18.11.2024-16.12.2024.

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, projektligji është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-aktet pranë ministrive të linjës me qëllim dhënien e mendimeve dhe propozimeve të tyre për këtë projekt-akt.

Realizimi Masa 1.1.8 i SKR për vitin 2024



Realizimi Financiar

Realizimi i kësaj mase nuk ka filluar sipas parashikimeve në 2022 por, siç shpjegohet edhe më lart, ka filluar në 2023. Për këtë arsye për të përcaktuar nivelin e realizimit është bërë analiza e aktiviteteve faktike të realizuara në 2024 dhe kosto e tyre është krahasuar me fondet e planifikuara në 2023.

Realizimi i fondeve totale është 100% dhe ato përbëhen vetëm nga paga dhe sigurime shoqërore. Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se edhe për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100%

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 1.1.9 Në përputhje me ligjet dhe VKM për njohjen e përvojës së punës dhe mësimin informal dhe jo-formal njihen kompetencat e fituara nëpërmjet edukimit jo formal dhe punës rinore bazuar në përcaktimet e profesioneve të punës së të rinjve nëpërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (AKAFPK) dhe klasifikimit të profesioneve (European Youth Work Portfolio).

Në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 “Për Rininë”, në përputhje dhe me parashikimet e ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, është përcaktuar koncepti i punonjësit rinor. Ky parashikim ofron rregullime me qëllim standardizimin e këtij profesioni, përcaktimin e kompetencave që duhet të zotërojnë punonjësit rinorë, si dhe nxitjen dhe lehtësimin e ngritjes së programeve për formimin e punonjësve rinorë dhe kualifikimin e vazhdueshëm të tyre.

Punonjësi rinor mbështet dhe udhëzon të rinjtë, në grupe ose individualisht, në fusha të ndryshme dhe me interes për ta, duke mbështetur zhvillimin e tyre personal dhe shoqëror. Ky punonjës punësohet dhe angazhohet si vullnetar pranë institucioneve publike dhe jo publike që punojnë me të rinjtë, organizatave rinore dhe për të rinjtë, qendrave rinore dhe hapësirave rinore.

Institucioni përgjegjës për rininë do të mbështesë ofrimin e programeve për formimin profesional të punonjësve rinorë dhe veprimtaritë për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e vazhduar profesional të punonjësve rinorë.

Kriteret dhe procedurat e përfitimit të kualifikimit profesional të punonjësve rinorë do të miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rininë dhe ministrit përgjegjës për arsimin profesional.

Me miratimin e ndryshimeve të Ligjit për rininë, do të vijohet edhe me procedurat e rregullimit të punës rinore përgjatë 2025.

Realizimi financiar

Në lidhje me këtë masë dhe aktivitetet e planifikuara për të nuk ka raportime nga ana financiare pasi shpenzimet janë planifikuar deri në vitin 2023. Për këtë arsye, kjo masë nuk përfshihet tek monitorimi për vitin 2024


Përmbledhje për objektivin specifik 1.1

Realizimi financiar

Realizimi i 8 masave në bazë të analizës financiare është si në grafikun e mëposhtëm

Për këtë objektiv nuk ka masa të paraportuara dhe 74% e tyre janë të realizuara


Statusi i realizimit të masave të Objektivit 1.1



Objektivi specifik 1.2: Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm, duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave, Agjencinë Kombëtare të Rinisë.


Në këtë objektiv, ashtu si edhe në vitin 2023, realizimin e ul ndjeshëm masa që ka të bëjë me ngritjen e portalit “Të Rinjtë për të Rinjtë”.

Statusi i realizimit të masave të Objektivit 1.2



Realizimi i fondeve totale është 78%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 98%. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 78%, ndërkohë shpenzimet kapitale kanë një normë realizimi prej vetëm 6%.

Realizimi Objektivit 1.2. i SKR për vitin 2024



Masa 1.2.1 Fuqizohen rolet zbatuese, koordinuese, monitoruese të AKR përmes fuqizimit të saj me burime financiare dhe njerëzore për të siguruar zbatimin e politikave sektoriale për rininë të pasqyruara në këtë strategji.

Në funksion të fuqizimit të AKR-së është rishikuar akti nënligjor i vitit 2020, që rregullon procesin e financimit nga buxheti i shtetit të projekteve rinore, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1141, datë 24.12.2020, , “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, i cili shfuqizohet nga Vendimi Nr. 566, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë” i cili shfuqizon atë në fuqi.

Me qëllim forcimin e aftësive institucionale në përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të AKR në mënyrë më efektive, efikase dhe të qëndrueshme si dhe rritjen e ndikimit pozitiv dhe afatgjatë në shoqëri, përmes Urdhërit nr. 58 datë 18.04.2024 "Për miratimin e Strukturës së Agjencisë Kombëtare të Rinisë" të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë u miratua ristrukturimi i AKR-së si dhe rritja e numrit të punonjësve të saj në 30.

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së monitorimit dhe menaxhimit të projekteve, duke pasur parasysh edhe angazhimin e stafit të ri në procesin e monitorimit të projekteve fituese të Thirrjes IV, në datë 11 dhjetor 2024 u realizua trajnimi i stafit të AKR-së mbi përdorimin e metodës ReLOaD (Regional Programme on Local Democracy). Ky trajnim ndihmoi stafin në rritjen e aftësive për të monitoruar dhe menaxhuar projekte në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Realizimi financiar

Në 2024 është miratuar shtesa e stafit të AKR. Për këtë arsye realizimi i fondeve, në krahasim me 2023 është rritur ndjeshëm.

Realizimi Masa 1.2.1 i SKR për vitin 2024



Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 97%. Pagat dhe sigurimet shoqërore janë realizuar me 100%. Gjithashtu edhe shpenzimet kapitale kanë një normë realizimi prej 100%. Mallra, shërbime dhe kontigjenca ka normë realizimi 0% pasi nuk janë zhvilluar trajnime gjithëpërfshirëse dhe zhvillim të kapaciteteve në të gjitha fushat e strategjisë për stafin e AKR. Siç përmendet më lart, në datë 11 dhjetor 2024 u realizua trajnimi i stafit të AKR-së mbi përdorimin e metodës ReLOaD (Regional Programme on Local Democracy). Ky trajnim ndihmoi stafin në rritjen e aftësive për të monitoruar dhe menaxhuar projekte në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 1.2.2 Përmes AKR sigurohen fonde për rritjen e prezencës së Shqipërisë në proçeset e politikëbërjes rinore si në nivel rajonal, evropian dhe global.

AKR është partnere në Projektin “Pjesëmarrja e të rinjve në demokracinë Digjitale” i cili financohet nga Erasmus+ dhe synon të angazhojë dhe fuqizojë të rinjtë në Shqipëri, Mal të Zi, Serbi dhe Spanjë,

veçanërisht ata nga komunitetet rurale dhe të marginalizuara, në botën digjitale. Ky Projekt synon të zhvillojë aftësitë digjitale të të rinjve duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e tyre digjitale, me një qasje të balancuar që thekson mbrojtjen dhe pjesëmarrjen në demokracinë digjitale. Organizatat partnere janë nga Serbia, Mali i Zi, Shqipëria, Spanja.

Më 24 Tetor 2024 u zhvillua konferenca midis Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe SCiDEV, në House Europe, Tiranë, mbi fillimin e projektit “Pjesëmarrja e të rinjve në Demokracinë Digjitale: Nga Aftësitë Digjitale tek të Drejtat Digjitale”, i cili synoi informimin e të rinjve mbi rëndësinë e të drejtave digjitale. Objektivat kryesore përfshijnë edhe informimin e të rinjve mbi gjendjen e sigurisë kibernetike online dhe mbi të drejtat digjitale, dhe rëndësinë që ka të qenit i mbrojtur. Në vijim të implemetimit të këtij projekti, Agjencia Kombëtare e Rinisë ka qënë pjesë e workshop-it “EYDR-CO-Production and Design Thinking Workshop, Youth Digital Democracy and Digital Rights Accelerator Programme (WP3)” në datat 18 – 22 Nëntor 2024, Oviedo (Asturias) Spanjë në të cilin u punua për hapat vijues të zhvillimit të projektit.

Shqipëria është anëtare e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), një mekanizëm institucional që funksionon në mënyrë të pavarur, i themeluar nga 6 (gjashtë) shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe që është një produkt konkret i Procesit të Berlinit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, që synon të promovojë frymën e bashkëpunimi mes të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit.

Në bazë të neneve 36 dhe 43 të ligjit Nr. 116/2016 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor, Statutit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (ZRBR)”, përqindja kontribuuese e Shqipërisë tek buxheti i RYCO-s është 17.3% e cila përkthehet në vlerën 173,000 euro në vit, tarifë e cila paguhet çdo vit nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Rinisë në monedhën vendase.


Gjatë muajit nëntor 2024 u zhvillua takimi me Bordin Drejtues të RYCO për të forcuar bashkëpunimin rajon. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, znj. Bora Muzhaqi, diskutoi strategjitë për menaxhimin dhe konsolidimin e rolit të këtij institucioni si një pikë kyçe për bashkëpunimin rinor në rajon.

Përfaqësues rinorë dhe partnerë nga GIZ ndanë idetë e tyre për fuqizimin e të rinjve shqiptarë dhe atyre nga rajoni. Znj. Muzhaqi theksoi se bashkëpunimi rajonal është një shtyllë e rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm, duke nënvizuar rolin e RYCO-s si një urë lidhëse për shkëmbimin e ideve dhe përvojave mes të rinjve. Ky bashkëpunim është një hap tjetër drejt ndërtimit të një rajoni të qëndrueshëm dhe të ndërthurur, ku rinia luan një rol vendimtar.

Realizimi financiar

Gjatë 2024 janë realizuar disa nga aktivitetet e planifikuara. Gjithashtu është siguruar pjesëmarrja në organizata ndërkombëtare në mënyrë që të mundësohet lëvizja e të rinjve.

Realizimi Masa 1.2.2 i SKR për vitin 2024



Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 83%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore niveli i realizimit është 100% pasi janë punësuar punonjësit e planifikuar. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca norma e realizimit është 82% pasi është siguruar anëtarësimi në organizata ndërkombëtare si RYCO dhe Erasmus¹¹ por nuk është krijuar fondi për mbështetjen e KKR dhe KVR.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë pjesërisht e realizuar.**

Masa 1.2.3 Bazuar në konceptin "Të rinjtë për të rinjtë" zhvillohen dhe aplikohen shërbime të informacionit për të rinjtë dhe rininë. Në këtë portal krijohet një platformë informimi dhe shërbimesh për të rinjtë dhe organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë që do të mbështesë formimin, punësimin, edukimin, mirëqenien, zhvillimin dhe aktivizimin e tyre.

Pavarësisht se masa parashikon aktivitete të lidhura me sistemin "Të Rinjtë për Të Rinjtë" i cili nuk është ndërtuar ende, AKPA në kuadër të iniciativave të veta ka ndërmarrë zhvillime të mëtejshme në këtë kontekst si:

- Portali i punësimit puna.gov.al është pasuruar me informacione të detajuara duke ofruar informacion cilësor mbi shërbimet dhe programet e ofruara nga zyrat e punësimit, duke rritur aksesueshmërinë dhe duke u bërë akoma më shumë userfriendly për të gjithë përdoruesit;
- Është realizuar shkarkimi i aplikacionit puna.gov.al edhe nga përdoruesit e telefonave smart;
- Janë organizuar takime promovuese me të rinjtë dhe subjektet me qëllim informimin e tyre mbi shërbimet dhe programet e ofruara nga zyrat e punësimit si edhe mundësitë e përfitimit nga ana e tyre;

¹¹ fondi i kontigjencës prej 11992000 lekë është skontuar

- Në shumë qytete janë organizuar panairë me pjesëmarrjen e të rinjve, duke bërë të mundur bashkëpunimin midis punëdhënësve dhe punëmarrësve me qëllim informimi mbi vendet e lira të punës dhe duke qenë një urë lidhëse midis dy aktorëve kryesorë;

Në kuadër rritjes së promovimit të Skemës së Pilotimit të Garancisë Rinore është realizuar krijimi dhe popullimi i Portalit të Garancisë Rinore (<https://garanciarinore.puna.gov.al/>) me informacion lidhur me shërbimet dhe ofertat sipas kësaj skeme, si dhe janë publikuar në kanalet zyrtare të komunikimit me publikun (media sociale): 29 publikime të rasteve të suksesit të zbatimit të Garancisë Rinore dhe 4 video promovuese për rritjen e ndërgjegjësimit të pjesëmarrjes në skemë.

Realizimi financiar

Edhe gjatë 2023 nuk është arritur të ngrihet portali “*Të rinjtë për të rinjtë*”. Për këtë arsye nuk është realizuar ndonjë aktivitet. E njëjta vonesë ka ndodhur edhe me ngritjen e këndeve digjitale të informacionit rinor (info-points) në të gjitha bashkitë me anë të tabletave ose tabelave smart.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e parealizuar**.

Masa 1.2.4 Fuqizohen kapacitetet e politikë-bërësve dhe nëpunësve civilë në fushën e rinisë dhe zbatimin e politikave rinore, bazuar në konceptin e shërbimeve miqësore dhe të pranueshme nga të rejtat dhe të rinjtë dhe forcohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e politikave rinore.

Lidhur me rritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë për të siguruar ofrim shërbimesh të përshtatshme dhe miqësore për rininë në bashkëpunim me organizatat rinore dhe aktorë të tjerë me peshë në këtë fushë në datë 11 korrik 2024, në kuadër të bashkëpunimit me Deloitte Albania & Kosovo, u realizua trajnimi me temë "Aftësitë komunikuese dhe e folura në publik" në të cilin morrën pjesë 20 të rinj nga KVR-të, të rinj aktivë si dhe punonjësit Rinor të Bashkisë Kamëz.

Gjatë muajit tetor 2024, Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Bora Muzhaqi mori pjesë në punimet e Samitit të Berlinit ku zhvilloi disa takime të rëndësishme me fokus zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë. Ministria mori pjesë në panelin “Perspektivat Rinore: Si mund të jemi ne ndryshimi?”, si pjesë e Forumit Rinor të Ballkanit Perëndimor, pjesë e Samitit të Procesit të Berlinit, në kuadër të 10-vjetorit të këtij procesi.

Në takime me përfaqësues rajonalë, por edhe homologë si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit të Malit të Zi, Anđela Jakšić-Stojanović, dhe aktivistë rinorë nga Bosnje Hercegovina, Serbia, dhe organizata të ndryshme europiane, Ministria Muzhaqi theksoi rolin e rëndësishëm të të rinjve në ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për Ballkanin Perëndimor. Ajo ndau punën e qeverisë shqiptare për rritjen e angazhimit rinor në vendimmarrje dhe zhvillimin e programeve për punësimin, ndërkombëtarizimin e universiteteve, dhe përmirësimin e ofertave studimore në Shqipëri.

Znj. Muzhaqi zhvilloi gjithashtu disa takime bilaterale me ministra të rajonit, përfshirë Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, për të diskutuar përf forcimin e bashkëpunimit rinor në Ballkanin


Perëndimor dhe përfshirjen e të rinjve në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Forumi i organizuar nga RYCO, OFAJ, dhe Bürger Europas, mbledhi mbi 100 pjesëmarrës nga rajoni dhe BE, duke ofruar një platformë diskutimi mbi arritjet dhe sfidat e ardhshme të bashkëpunimit rinor rajonal.

Gjatë muajit dhjetor 2024, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Znj. Bora Muzhaqi, përfaqësoi Shqipërinë në Forumin Ndërkombëtar të UNESCO-s Kundër Racizmit dhe Diskriminimit, i cili u zhvillua në Spanjë. Gjatë këtij forumi, Znj. Muzhaqi mori pjesë në Panelin Ministror, ku theksoi angazhimin e Shqipërisë në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, duke adresuar çështje që lidhen me minoritetet dhe barazinë gjinore në politikat kombëtare. Ajo veçoi rolin e rëndësishëm të të rinjve si aktorë të ndryshimit dhe mbështetjen që qeveria shqiptare ka ofruar ndaj shoqërisë civile, përmes granteve të akorduara nga Agjencia Kombëtare e Rinisë. Forumi shërbeu si një platformë për ndarjen e praktikave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, ku Shqipëria riafirmoi përkushtimin e saj ndaj iniciativave konkrete për luftën kundër diskriminimit dhe promovimin e barazisë.

Realizimi financiar

Norma e realizimit e fondeve të planifikuara është 84%.

Realizimi Masa 1.2.4 i SKR për vitin 2024



Norma e realizimit të pagave dhe sigurime shoqërore është 50% pasi janë realizuar trajnime të punonjësve rinoë, por jo trajnime të politikëbërësve apo nëpunësve civilë. Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 83% pasi edhe pse trajnimet apo manuali nuk është arritur të realizohen si pasojë e vonimit të procesit, përsëri janë zhvilluar aktivitetet e shpjeguara edhe më lart.


Si konkluzion mund të thuhet se **është masë pjesërisht e realizuar.**

Institucionet kanë raportuar të gjithë masat që lidhen me objektivin specifik 1.2.

Realizimi financiar

Për këtë objektiv është vlerësuar norma e realizimit të 4 masave. Realizimi i masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë


Statusi i realizimit të masave të Objektivit 1.2



Objektivi specifik 1.3: Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm, duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave Agjencinë Kombëtare të Rinisë.

Ky objektivi përbëhet nga 3 masa që kanë të bëjnë; me databazën e të dhënave për rininë, studimet rinore dhe databaza e organizatave rinore. Realizimi i fondeve totale është shumë i ulët 5%.

Realizimi Objektivi 1.3 i SKR për vitin 2024



Për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 17%. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 0%, ndërkohë për masat e këtij objektivi nuk janë planifikuar shpenzime kapitale. Në këtë objektivi, realizimin e ulin ndjeshëm studimet për të rinjtë dhe baza e të dhënave për të rinjtë.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

Masa 1.3.1 Krijohen baza të dhënash statistikore dhe studimore për rininë në Shqipëri, përmes forcimit të kërkimit shkencor rreth rinisë, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe fuqizohet studimi i rinisë si fushë akademike dhe shkencore.

Në datë 24 Qershor 2024 u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes AKR-së dhe INSTAT, e cila ka si objekt bashkëpunimin për kërkimin shkencor për rininë, realizimin e trajnimeve të stafit si dhe studimeve rinore, etj. Në kuadër të këtij bashkëpunimi jemi në kontakt të vazhdueshëm për marrjen e informacioneve të ndryshme statistikore si dhe për të nisur me trajnimet e para të stafit lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.


Gjithashtu, MSHRF ka kontribuar në realizimin e ushtrimeve për të përcaktuar indikatorët që konsiderohen me rëndësi për Shqipërinë në fushën e rinisë, për t'u përfshirë në modulet e anketimit MICS që është në proces realizimi nga UNICEF në bashkëpunim me INSTAT në Shqipëri. MICS (Multiple Indicator Cluster Surveys) është një platformë e përbërë nga një sërë anketash të ndërmarra nga UNICEF. Këto anketa mbledhin të dhëna mbi shumë tregues të lidhur me mirëqenien e fëmijëve dhe grave. Të dhënat e MICS janë gjerësisht përdorura për hartimin e politikave, planifikimin e programeve dhe monitorimin e progresit drejt qëllimeve ndërkombëtare për zhvillim, duke përfshirë këtu dhe lidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs).

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar 2 takime ndërinstitucionale. Në datën 1 tetor 2024 është zhvilluar takimi i parë i Komitetit Drejtues, në ambientet e INSTAT në të cilin u prezantua nga ekspertët dhe u diskutuan konkluzionet e arritura në Raportin Teknik të Vlerësimit të Nevojës për të Dhëna nga MICS2025, në Shqipëri. Në datat 12-13 Nëntor në ambientet e Hotel Marriot u mbledh grupit teknik të anketës MICS, në të cilin u sqarua dhe dakordësua mbi modulet, pyetsorin e familjes, pyetsorin për gratë dhe burrat (15-49), pyetsori i fëmijëve (5-17), dhe nën 5 vjeç.

Realizimi financiar

Viti 2024 është fillesa e aktiviteteve që janë planifikuar në SKR. Kjo është arsyeja se përse norna e realizimit nuk është 0. Megjithatë aktivitetet nuk konsiderohen të realizuara.

Realizimi Masa 1.3.1 i SKR për vitin 2024



UNICEF është angazhuar në 2024 por jo specifikisht për rininë. Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 7%. Kjo normë kaq e ulët realizimi lidhet me faktin që ka një mosrealizim të theksuar qoftë përsa i përket studimeve që ishin planifikuar të realizoheshin, qoftë edhe përsa i përket stafit të dedikuar për të punuar me të dhënat rinore.

Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 17%. Nuk është realizuar fondi i pagave pasi nuk janë shtuar punonjës që merren me të dhënat për të rinjtë, por nga ana tjetër punonjës të INSTAT kanë bashkëpunuar me UNICEF për hartimin e MICS. Për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 0%.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e parealizuar**.

Masa 1.3.2 Politikat zhvillimore rinore ndërtohen mbi analiza faktike dhe dokumentare.

Masa është e parealizuar për shkak të vështirësive në gjetjen e donatorëve për të mbuluar studimet.

Realizimi financiar

Ashtu si edhe në 2023, nuk janë kryer 6 studime në nivel kombëtar në lidhje me aspekte të ndryshme të lidhura me të rinjtë dhe të rejtat. Për këto studime nuk ka passur as mbështetje deri tani nuk ka pasur zhvillime.

Pra, niveli i realizimit në total dhe për çdo zë është 0%.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e parealizuar**.

Masa 1.3.3 Në përputhje me Ligjin për Rininë dhe aktin nënligjor të dalë në bazë dhe për zbatim të tij, zhvillohet baza e të dhënave për organizatat rinore dhe për rininë, duke përfutur edhe nga proçeset e digjitalizimit të shërbimeve publike.

Platforma “Baza e të Dhënave për Rininë” do të shërbejë për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave nga organizatat rinore/për të rinjtë në proçeset e politikave rinore, në nivel qendror dhe vendor, si dhe për nevojat dhe punën e tyre. Gjithashtu, databaza do të shërbejë edhe për të rritur ndërveprimin e të rinjve me këto organizata, qoftë si vullnetarë, praktikantë apo edhe si drejtues të ardhshëm.

Përgjatë vitit 2024, nëpërmjet vijimit të takimeve, të komunikimeve dhe monitorimit të vazhdueshëm të ecurisë së procedurave me AKSHI lidhur me krijimin e Regjistrimit Elektronik për Rininë (RER) dhe Implementimin e Sistemit Elektronik për Financimin e Projekteve të Dedikuara për të Rinjtë, është diskutuar me AKSHI teknikisht mundësia e bashkimit në një sistem të vetëm të Regjistrimit Elektronik për Rininë dhe Implementimit të Sistemit Elektronik për Financimin e Projekteve të Dedikuara për Rininë, me qëllim vijimin e procedurës së prokurimit në një të vetme e cila do të mundësonte përdorimin më me efikasitet të fondeve buxhetore, pa çënuar funksionalitetin e tyre. MSHRF dhe AKR dakordësuan bashkimin e dy sistemeve dhe përcaktuan përfaqësuesit në grupin e punës për hartimin e termave të referencës për llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit për procedurën e unifikuar të prokurimit. Specifikimet teknike të platformave janë përcaktuar nga grupi i punës.

Realizimi financiar

Nuk është realizuar asnjë nga aktivitetet e planifikuara që lidhen me realizimin e databazës dhe lidhjen e saj me eAlbania. Pra norma e realizimit të fondeve totale, që përbëhen vetëm nga mallra, shërbime dhe kontigjenca, është 0%.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e parealizuar**.

Përmbledhje për këtë objektiv specifik

Institucionet kanë raportuar të gjithë masat që lidhen me objektivin specifik 1.3

Realizimi financiar

Për këtë objektiv specifik, të tre masat përbërëse të tij janë të parealizuara.

QËLLIMI I POLITIKËS II

Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity)

Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

Qëllimi i Politikës II, ka në përmbajtje të tij 3 Objektiva Specifikë dhe 13 Masa, nga të cilat 11 fillojnë ose vazhdojnë zbatimin e tyre gjatë periudhës raportuese. Ky qëllim i politikës zbërthehet në masa që lidhen me punësimin e të rinjve, aftësimin e tyre në fushën e TIK dhe digjitalizimit, këshillimin e karrierës, zhvillimin e programeve sportive, artit, zejeve dhe programe të tjera jashtë-kurrikulare, mbështetjen e sipërmarrjes dhe start-up.


Përmbledhje për Qëllimin e Politikës 2

Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik.

Realizimi financiar


Gjithsej për qëllimin e politikës 2 janë analizuar 11 masa. Realizimi i masave në bazë të analizës financiare për të tre objektivat specifike të qëllimit të dytë të politikës është:

Statusi i realizimit të masave të Qëllimit II



Siç shihet vetëm 18% e masave është e parealizuar gjatë vitit 2024. Ndërkohë, përsa i përket realizimit financiar, norma e realizimit të fondeve totale është 91%.


Realizimi Qëllimi II i SKR për vitin 2024



Siç shihet edhe nga grafiku, tek kjo normë realizimi e lartë ka kontribuar mbirealizimi i shpenzimeve kapitale me një normë prej 116% lidhur me programet e kodimit të cilat nisur edhe nga rëndësia strategjike kanë patur edhe buxhetim më të lartë në buxhetin e shtetit krahasuar me parashikimin në dokumentin e SKR. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 69%. Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 86%.

Nga 3 objektivat specifike të këtij qëllimi të politikës, vetëm objektivi i parë ka shpenzime kapitale të planifikuara që kanë një mbirealizim. 2 objektivat e tjerë nuk kanë shpenzime kapitale të planifikuara.

Realizimi Qëllimi II dhe tre objektivat




Për të tre zërat e shpenzimeve dhe veçanariaht për paga dhe sigurime shoqërore, vërehet luhajtje e normës së realizimit nga një objektivi në tjetrin.

Më poshtë detajohen aktivitetet e ndërmarra për secilën nga masat e objektivave specifike si dhe jepet analiza e realizimit financiar të tyre

Objektivi specifik 2.1: Të rinjtë janë të aftësuar, të mirinformuar në lidhje me mundësitë për punësim dhe në gjendje të bëjnë zgjedhje autonome kur i bashkohen popullsisë ekonomikisht aktive.

Realizimi i fondeve totale për këtë objektivi është 91%. Kjo përqindje ndikohet nga disburdsimi i Fondit të StartUp i cili koordinohet nga MiSHMB dhe Agjencia e Start-upeve. Përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 70%. Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 86%, ndërkohë shpenzimet kapitale kanë një normë realizimi prej 116%.

Realizimi Objektivi 2.1 i SKR për vitin 2024



Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

Masa 2.1.1 Bashkërendohet Politika Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, duke rritur nivelin e punësueshmërisë rinore, punësimin dhe sipërmarrjen e të rinjve përmes angazhimit dhe ndërveprimit të këshillave vendorë rinorë, ndërmarrjeve dhe startup-eve.

➤ Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

Gjatë periudhës raportuese ka vijuar zbatimi i Thirrjes IX të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

● Thirrja IX (16 Shtator-16 Dhjetor 2024)

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar, kryen rolin e sekretariatit teknik dhe koordinimin ndërinstitucional të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në institucionet e administratës shtetërore në nivel qendror e vendor, institucionet e tjera publike dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Gjatë periudhës së raportimit është zhvilluar Thirrja e IX e PKPP-së, e shpallur më datë 8 korrik 2024 me 1,275 pozicione vakante prej të cilave 775 në administratën shtetërore, 427 në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe 73 në institucionet e pavarura. Thirrja e IX e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës është një vazhdimësi e thirrjeve të mëparshme, që ka si synim zhvillimin e një praktike profesionale 3-mujore për të gjithë të rinjtë 21-26 vjeç dhe njihet si përvojë pune gjatë rekrutimit në institucionet e administratës shtetërore.

Thirrja e IX të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, qëndroi e hapur deri më 15 gusht me 1,332 aplikime. Përgjatë muajit gusht dhe shtator, kanë vijuar procedurat për vlerësimin e aplikantëve nga institucionet pritëse. 463 kandidatët e përzgjedhur janë njoftuar nga institucionet përkatëse dhe kanë filluar procedurat për të nënshkruar marrëveshjen për zhvillimin e praktikës profesionale 3-mujore nga data 16 shtator deri më 16 dhjetor 2024, e cila njihet si përvojë pune nga DAP. Prej 463 kandidatëve, 435 të rinj përfunduan me sukses praktikën tre mujore. Të rinjtë e vlerësuar me pikë maksimale, do të

kenë mundësinë të punësohen me kontratë 1-vjeçare në bazë të performancës së tyre dhe nevojave të institucioneve pritëse.

MSHRF me mbështetjen e AKR-së në datën 30 tetor zhvilloi në Pallatin e Brigadave ceremoninë e mirëseardhjes për praktikantët e Thirrjes së IX të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.

Në datën 23 Dhjetor në ambjentet e Katedrales Orthodhokse MSHRF me mbështetjen e AKR-së organizoi ceremoninë përmbyllëse të programit 3 mujor të praktikave të punës, aktivitet në të cilin u ndan certifikatat për praktikantët të cilët përfunduan me sukses këtë cikël.

➤ Programi i Kodimit

Një nga programet e krijuara me qëllim rritjen e nivelit të punësueshmërisë rinore dhe punësimin dhe sipërmarrjen e të rinjve është dhe Programi i Kodimit, i cili është lancuar më datë 23 janar 2023 nën koordinim të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe implementohet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Që prej implementimit të programit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është në kontakt me AKPA për të ndjekur ecurinë e regjistrimeve në program, ecurinë e programit në tërësi si dhe të kurseve specifike, për të koordinuar promovimin e programit në vijimësi. Gjatë muajit shtator-tetor 2024, janë regjistruar edhe 200 të rinj të tjerë në këtë proogram dhe gjatë vitit 2025, do të rihapet skema me mbështetje nga buxheti i shtetit.

Kurset e formimit profesional në fushën e teknologjisë së informacionit për periudhën 3-12 mujore, mbështeten në masën 50% ose 100% nga Qeveria Shqiptare sipas kategorisë së aplikantëve, të cilët pas përfundimit të kursit mund të integrohen lehtësisht në tregun e punës së teknologjisë.

Aplikimi për kurset profesionale kryhet online me anë të portalit e-Albania, nëpërmjet shërbimit “Aplikim për Kursin e Formimit Profesional me Mbështetje Financiare”. Gjithashtu, kurset tashmë përtej Tiranës, ofrohen dhe në Korçë, Shkodër dhe Dibër, si dhe është në proces shtrirja dhe në qytete të tjera në të cilat kërkesa nga të rinjtë është e lartë si dhe nga ana e kompanive për të punësuar individë të trajnuar në fushat e teknologjisë. Gjatë vitit 2024, vazhdoi zbatimi i VKM 646 (Programi i Kodimit).

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2024, ky program është ndjekur nga 844 pjesëmarrës (791 punëkërkues dhe 53 punëkërkues të papunë) prej të cilëve 629 pjesëmarrës ose 75% e totalit ishin 15-29 vjeç.

Pu.pa dhe punëkërkues 15-29 vjeç pjesëmarrës në Programin e Kodimit janar- dhjetor 2024

Emri i Kursit	Punëkërkuës	Punëkërkuës i Papunë	Total
.NET	15	2	17
Analist Biznesi dhe Trajnues i Sistemit IMPRO ERP	24		24
Bazat e Shkencës Kompjuterike	4	1	5
Cyber Security	62		62
Data Science	8		8
Database SQL	1		1
DevOps	10	1	11
FullStack Development	33	2	35
Full Stack Web Development	9		9
Java	127	10	137
JavaScript	54	4	58
JavaScript FullStack	19	8	27
Oracle	16		16
Programim i Avancuar	7		7
Programim FrontEnd	15	3	18
Programming dhe Data Processing	13	1	14
Python	35	1	36
Python FullStack	12	7	19
Software Development	24		24
Software Tester	14	1	15
System Administrator	11	3	14
Web Development	18	1	19
Web Development, ASP, .NET, Web API BackEnd	4		4
Web Development, FrontEnd Programmer	20	2	22
Web Development, Java BackEnd Programmer	8		8
Zhvillues dhe Implementues i Sistemit IMPRO ERP	19		19
Total	582	47	629

Gjatë kësaj periudhe, u krye ndarja e certifikatave për 16 të rinj të Dibrës, të cilët përfunduan me sukses kursin e programimit në gjuhën Java si dhe u zhvillua një vizitë në “Holberton School Albania”, nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, bashku me Ministrin e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive..

- Programe të tjera të nxitjes së punësimit, (programi i praktikave profesionale dhe të tjerë)

Programet e Nxitjes së punësimit që targetojnë të rinjtë

Në të gjitha VKM -të e programeve të nxitjes së punësimit, punëkërkuesit e papunë të rinj të moshës 15-29 vjeç janë prioritet për t'u përfshirë në programe kryesisht në programe të dedikuara për këtë kategori si programi i praktikës profesionale i cili targeton të gjithë studentët e sapodiplomuar dhe maturantët e shkollave të mesme profesionale, programi i punësimit dhe programi i vetëpunësimit i cili i jep mundësi pu.pa-ve që kanë një ide biznesi të aplikojnë dhe të përfitojnë grant deri në 500,000 lekë për hapjen e biznesit të ri.

Pu.pa 15-29 vjeç pjesëmarrës në PNP

Lloji i Programit	Janar - Dhjetor 2024		
	Total	15 - 29 Vjeç	%
V.K.M. 17 (Programi 1: Punësimi)	346	167	48%
V.K.M. 17 (Programi 2: Formimi Nëpërmjet Punës)	262	136	52%
V.K.M. 17 (Programi 3: Praktikant e Punës)	602	584	97%
V.K.M. 535 (Punë në Komunitet)	1135	95	8%
V.K.M. 348 (Programi i Vetëpunësimit)	120	57	48%
Total	2,465	1,039	42%

➤ Shërbimi i Orientimit në Karrierë

Sistemi i menaxhimit të AKPA-s është i standardizuar në 3 nivele në zbatim të VKM-së nr. 554 datë 31.07.2019, e ndryshuar mbi krijimin dhe funksionimin e AKPA-s në:

- Niveli qendror - Drejtoria e Përgjithshme;
- Niveli rajonal - Drejtoritë Rajonale;
- Niveli vendor - Zyrtat Vendore të Punësimit.

Organizimi dhe proceset e punës të realizuara nga zyrtat e punësimit mbështetet në Vendimet e Këshillit të Ministrave, në Paketën e Udhëzuesve të miratuar dhe në Rregulloret e ndryshme.

Një prej Udhëzuesve të miratuar është Udhëzuesi për orientimin në karrierë dhe formimin profesional të punëkërkuesve të papunë të regjistruar.

Shërbimet ndaj punëkërkuesit të papunë që janë pjesë e orientimit në karrierë janë:

Këshillim individual/ ose në grup

Qëllimi i takimeve individuale është të identifikojë në mënyrë të përshtatshme dhe të merret me sfidat me të cilat përballet pjesëmarrësi individual. Takimet individuale janë të rëndësishme dhe ndodhin më shpesh për punëkërkuesit e nivelit të parë dhe të dytë të punësueshmërisë. Takimet në grup janë të përbërë prej 7-10 individë, të cilët takojnë njëri-tjetrin në një takim grupi i cili moderohet nga

këshilluesi 1 herë në javë. Takimet zgjasin 1 deri 2 orë. Takimet e grupit ndihmojnë punëkërkuessit të mësojnë dhe praktikojnë sjellje sociale, të krijojnë ose të zgjerojnë një rrjet pozitiv dhe mbështetës social, të shkëmbejnë dhe të mësojnë nga përvojat e njëri-tjetrit, të identifikojnë dhe të praktikojnë aftësitë metodologjike për të mësuar dhe zgjeruar njohuritë dhe orientimin e tyre në botën e punës.

Aftësitë e buta (Soft Skills)

Qëllimi i ofrimit të këshillimit për karrierë është të mbështesë dhe mobilizojë punëkërkuessit e papunë për të kërkuar vetë një punë. Duke ndjekur kursin Start SMART dhe Programin më të ri “Aftësi për Punësim”, një program i veçantë që ndihmon punëkërkuessit e papunë të zhvillojnë aftësitë sociale, komunikimin, vetëbesimin dhe kompetencat digjitale, si dhe i përgatit për kërkimin dhe aplikimin për punë. më të ri të organizuar, ata supozohet se duhet të bëhen të vetëdijshëm se para se të marrin një vendim, ata duhet të njohin vetveten, aftësitë e tyre, potencialin e tyre në tregun e punës, për të synuar një profesion.

Kurikula për aftësitë digjitale

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2024 rezulton se 1,667 pu.pa kanë ndjekur kursin aftësi digjitale prej të cilëve 64% i përkisnin grupmoshës 15-29 vjeç. Gjithashtu, në QFPP Fier u zhvillua kursi Start Smart i cili u ndoq prej 55 punëkërkuess të papunë (pu.pa) 11% e të cilëve ishin të rinj.

Pu.Pa pjesëmarrës në kursin Aftësi Digjitale

QFPP-të	Total	15 - 29 Vjec	%
QFPP Durrës	393	250	64%
QFPP Elbasan	140	86	61%
QFPP Fier	110	57	52%
QFPP Gjirokastrë	69	52	75%
QFPP Korçë	105	64	61%
QFPP Lëvizëse	217	123	57%
QFPP Nr. 1	212	141	67%
QFPP Nr. 4	237	143	60%
QFPP Shkodër	132	107	81%
QFPP Vlorë	52	44	85%
Total	1,667	1,067	64%


Pu.Pa pjesëmarrës në kursin Start Smart

QFPP-të	Total	15 - 29 Vjec	%
QFPP Fier	55	6	11%

Realizimi financiar

Norma e realizimit të shpenzimeve totale është 72% si dhe një sërë aktiviteteve të zhvilluara.

Realizimi Masa 2.1.1 i SKR për vitin 2024



Përsa i përket zërave specifike për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 14%. Pjesa e paplotësuar konsiston në përcaktimin e standardeve për shërbime të pranueshme e miqësore për të rinjtë në zyrat e punës apo edhe identifikimi nga KVR dhe KKR në nivel bashkie i situatës së të rinjve të kategorisë APAA/ NEET (As në punë, arsim apo aftësim). Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca, norma e realizimit është 31%, Ndërkohë realizimi i shpenzimeve kapitale është 116% dhe ka mbi realizim pasi financimi për programet e kodimit nga buxheti i shtetit ka ardhur duke u rritur dhe ka rezultuar më i lartë se ai i planifikuar në strategji.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë pjesërisht e realizuar**.

Masa 2.1.2 Nxitet dhe forcohet punësimi rinor në fushën e TIK dhe digjitalizimit përmes zhvillimit të programeve të aftësimin në kodim, TIK dhe digjitalizim, bazuar në studimet e tregut dhe zhvillimit të punësimit në këtë fushë si në Shqipëri dhe me gjerë

“Gjenerata e Inovacionit” është projekti më i ri i cili synon që të ofrojë një hapësirë të re për idetë më inovatore për transformimin e administratës publike. Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët Bora Muzhaqi, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionin, Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës (AIE) dhe UNICEF Albania, ka hapur thirrjen për platformën inovative ‘Gjenerata e Inovacionit’, e cila fton të rinjtë e moshës 15-29 vjeç të kontribuojnë me idetë e tyre për transformimin e administratës publike shqiptare. Rruga fillon me aplikimin online, ku pjesëmarrësit mund të shprehin kreativitetin e tyre dhe të dërgojnë idetë që synojnë të sjellin ndryshim.

Pasi idetë të dorëzohen, një komision ekspertësh vlerëson ato më të spikaturat, duke përzgjedhur ato që kanë potencialin më të madh. Të përzgjedhurit marrin mbështetjen e mentorëve profesionistë, të cilët do t'i udhëheqin në zhvillimin e mëtejshëm të ideve të tyre.

Lidhur me sigurimin e informacioneve të përshtatshme dhe miqësore për të rinjtë mbi punësueshmërinë e të rinjve, punësimin dhe sipërmarrjen rinore, projektet fituese të thirrjes IV të AKR që kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e këtij synimi janë:

“Qendra për Formim dhe Zhvillim” po implementon projektin me titull “RinPunë → në kilometrin 0”. Qëllimi i këtij projekti është ngritja e kapaciteteve dhe aftësimi i të rinjve punë-kërkues për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut rajonal të punës si një garanci për punësim dhe vetëpunësim imediat por edhe për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm e afatgjatë për ta, familjet e tyre dhe për komunitetin, në bashkitë e Delvinës, Roskovecit dhe Peqinit

Qendra A.L.T.R.I. po implementon projektin me titull “Fuqizimi i të rinjve drejt sipërmarrjeve të suksesshme!”, i cili ka si qëllim të fuqizojë të rinjtë e Bashkive Korçë, Pogradec dhe Librazhd duke ofruar mjete dhe informacion për rritjen e kapaciteteve të tyre mbi mundësitë ekonomike favorizuese për zhvillimin e sipërmarrjes nga të rinjtë. Projekti shtrihet në Bashkitë, Librazhd, Pogradec dhe Korçë.

Instituti për Zhvillimin dhe Iniciativat Qytetare-IZHIQ po implementon projektin “Të rinjtë PRO punësimit të denjë”, i cili përmes trajnimeve synon të rrisë kapacitetet e të rinjve për të identifikuar, zhvilluar dhe realizuar ide inovative për biznese që kanë potencial për të rritur punësimin dhe kontribuar në zhvillimin ekonomik të rajonit. Projekti synon të promovojë kulturën e punësimit të denjë dhe të inkurajojë të rinjtë të ndërmarrin iniciativa konkrete drej krijimit të mundësive të punësimit për veten dhe komunitetin e tyre. Projekti shtrihet në Bashkitë Shkodër, Lezhë dhe Tiranë.

Shoqata AGRI-EN po implementon projektin me titull “Zhvillimi i Iniciativave të turizmit të qëndrueshëm për të fuqizuar komunitetet lokale” i cili ka për qëllim nxitjen e aktiviteteve sipërmarrëse për të rinjtë 19-29 vjeç në zonat rurale pjesë të Parkut Natyror Shebenik dhe Bashkisë Gramsh, për të zhvilluar veprimtari alternative dhe plotësuese bazuar në burimet natyrore që gjenerojnë punësim, mbrojtje të natyrës dhe zhvillimin e turizmit rural. Projekti shtrihet në Bashkitë Librazhd, Prrenjas dhe Gramsh. Në total synohet të impaktohen 30 të rinj.

Lidhur me zhvillimin e programeve që mundësojnë zhvillimin e karrierës dhe punësimin në fushat e TIK dhe kodimit, projektet fituese të thirrjes IV të AKR-së që kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e këtij synimi janë:

Qendra ESN AL "The 7 talcs" po implementon projektin me titull “7 Talcs Platforma e fuqizimit të të rinjve mbi karrierën dhe punën e denjë”, i cili ka për qëllim krijimin e një Platforme për fuqizimin e të rinjve mbi karrierën dhe zhvillimin profesional të denjë në fushën e artit dhe teknologjisë, përmes modeleve pozitive në formatin e bashkëbisedimit TedTalk. Projekti shtrihet në Bashkitë të Qarkut Tiranë, Kamëz dhe Vorë.

Fondacioni DAVIDI po implementon projektin “House of Agro-Innovation 4 Youth”

Qëllimi i projektit është të krijojë një mjedis proaktiv, kreativ dhe inovativ për studentët dhe të rinjtë të cilët duan të mësojnë më shumë rreth agroinovacionit në fushën e bujqësisë dhe turizmit rural. Ky projekt ka si objektiv kryesor të rrisë brezat e rinj me dashurinë për agroinovacionin e sipërmarrjen në fushën e bujqësisë dhe turizmit rural, si dhe të zbusë drejt stopimit largimet massive nga zonat rurale. Projekti shtrihet në Bashkitë Tiranë, Kolonjë dhe Mat.

Fondacioni DRIN po implementon projektin “Iniciativa për fuqizimin e të rinjve”, i cili ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të të rinjve dhe orientimit të tyre drejt mundësive më të vlefshme në tregun e punës duke nxitur dhe promovuar sipërmarrjen përmes mentorimit të tyre në realizimin e ideve të biznesit dhe mbështetjes me kurse profesionale. Shkëmbimin e përvojës për fuqizimin dhe rritjen e mundësive të punësimit, vetëpunësimi me temat "Konceptet bazë të kodim-programimit", "Konceptet bazë të kodim-programimit", “Hyrje në gjuhët kryesore të programimit, “Gjuha e programimit Java”, “Programimi në CC++”, “Programimi në CC++(trajtim më i thelluar i kësaj gjuhe programimi)”, “Marketingu në median sociale-strategjitë dhe teknikat më të fundit”.

Qendra IMPULS po implementon projektin me titull “COOL Ambassadors”, qëllimi i cilit është të ndihmojë në promovimin dhe zhvillimin e turizmit lokal në zonat e Elbasanit, Përrenjasit dhe Gramshit duke përdorur inovacionin dhe pjesëmarrjen e të rinjve, komunitetit dhe të strukturave lokale. Projekti shtrihet në Bashkitë Elbasan, Gramsh dhe Përrenjas.

Action for Albania po implementon projektin me titull “Orientimi dhe aftësimi i të rinjve për tregun e punës” qëllimi i të cilit është nxitja e punësimit dhe vetëpunësimit të të rinjve përmes promovimit të arsimit profesional, rritjes së kapaciteteve, duke u fokusuar në forcimin e aftësive profesionale, mbështetjen dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës nëpërmjet informimit, orientimit, këshillimit e trajnimit duke krijuar kështu një mjedis favorizues në zonat ku do zbatohet projekti. Projekti shtrihet në Bashkitë Tropojë, Has dhe Kukës.

Organizata “The Youth of Ura” po implementon projektin me titull “Rinia në veprim inovacioni rinor në turizëm” sipas fushës së përparësisë nr. 1&2, i cili ka për qëllim të rrisë pjesëmarrjen aktive të të rinjve dhe të rejave në proceset vendimmarrëse në komunitetet e tyre, duke zhvilluar njohuritë politike, aftësitë komunikuese, krijimin e platformave të përfshirjes për të adresuar çështjet problematike dhe trajnimin e tyre mbi guidat turistike si mënyrën e promovimit të vendit. Shtrirja e projektit në Bashkitë Berat, Kuçovë, Dimal.

Realizimi financiar

Realizimi i kësaj mase ka të bëjë me fushatat informuese dhe sensibilizuese. Gjithashtu janë zhvilluar mundësi që të zhvillohen dhe promovohen programe që mundësojnë zhvillimin e karrierës dhe punësimin në fushat e TIK dhe kodim. Tashmë, që në vitin 2023, kushdo mund të regjistrohet në kurse nëpërmjet e-Albania.

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 100%. Përsa i përket zërave specifikë mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 100%.

Realizimi Masa 2.1.2 i SKR për vitin 2024



Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 100%. Kurrikulat janë ngritur por portali “Të rinjtë për të rinjtë” nuk është ngritur. Por mbështetja është dhënë nëpërmjet formave të tjera që janë përfshirë në masat e tjera. Sidomos informacioni është shpërndarë nëpërmjet projekteve të ndryshme të financuara nëpërmjet thirrjeve për projekte të AKR gjatë 4 thirrjeve. Për të gjithë elementët, komponenti i aplikimit është shtuar në eAlbania. Këto shpenzime nuk ishin parashikuar në strategji.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 2.1.3 Pranë institucioneve arsimore dhe aftësuese zhvillohen shërbime inovative dhe digjitale të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë miqësore për të rinjtë dhe në respektim të shanseve të drejta dhe të barabarta për të arritur potencialin e plotë rinor.

➤ Udhëzuesi i Orientimit në Karrierë

Lidhur me orientimin dhe këshillimin e nxënësve për karrierën në institucionet arsimore parauniversitare janë në zbatim aktet e mëposhtme:

- Urdhri nr. 600, datë 19.10.2023 i MAS, “Për miratimin e “Udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9)”.
- Urdhri i përbashkët i MAS dhe MEKI nr. 661, datë 01.12.2023 “Për miratimin e rregullore për zhvillimin e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Urdhri nr. 463, datë 30.08.2024 i MAS “Për përcaktimin e kriterëve për miratimin e “Mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë” dhe të “Mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës” në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”.

Janë zhvilluar trajnimet me IAP-të mbi marrjen e masave për hartimin e grafikut lidhur me njohjen e Rregullore së MSH 2024 nga të gjithë aktorët. Takime me drejtues të IAP-ve të mesme për ngritjen e komisioneve në nivel institucioni të këshillimit të karrierës. Janë organizuar biseda informuese me kryetaret e këshillimit të karrierës në IAP, përfaqësues lokalë, prindër, përfaqësues të shërbimit psiko-social për planifikimin e veprimtarive me fokus informimin dhe këshillimin e maturantëve drejt një

karriere të sukseshme. Është hartuar kalendari i veprimtarive për “Ditët e informimit të maturantëve” në kuadër të për t'i njohur më nga afër me degët e studimit dhe mundësitë që Universiteti ofron. Të gjitha IA-të kanë organizuar takime me stafet pedagogjike, SHPS, rreth informimit të karrierës si dhe diskutime për hartimin e planit të çdo mësuesi kujdestar për realizimin e veprimtarive të orëve të karrierës.

Janë zhvilluar pyetësorët për të identifikuar aftësitë dhe prirjet për nxënës të AMU. Realizohet përpunimi i pyetësorëve në bashkëpunim me mësuesit kujdestarë. Të dhënat mbi prirjet e nxënësve ndihmojnë për ngritjen e temave dhe veprimtarive për të cilat nxënësit kanë më shumë nevojë. Janë orientuar nxënësit e klasave të nënta për hartimin e një CV, si dhe biseda apo debate mbi orientimin e karrierës për t'i ndihmuar nxënësit të jenë më kritik. Në shkollë janë zhvilluar programe mbështetëse, që orientojnë të rinjtë në procesin e përzgjedhjes së llojit të arsimit kur marrin vendimet në lidhje me zgjedhjen e arsimit të mesëm të lartë ose atij profesional dhe më pas vendimin për të zgjedhur degën e studimeve universitare apo punësimin.

Disa nga temat e realizuara:

- Formimi, miratimi dhe funksionimi i organit të “Këshillimit të Karrierës”, sipas udhëzimeve të MAS dhe ZVAP;
- Informimi i maturantëve për suportin që përfitojnë nga bashkëpunimi me “Këshillimin e Karrierës”;
- Takime me nxënësit maturantë, për t'i orientuar në marrjen e informacionit fizik dhe online, për njohjen me kriteret, mënyrën e pranimit në universitete si dhe përditësimin mbi ecurine e shpalljes së fituesve;
- Dhënia e informacioneve dhe shpjegimeve mbi rëndësinë dhe vlerën që kanë vlerësimet vjetore dhe rezultatet në D1, D2, D3 & Z1, në fitimin e degës së preferuar sipas kriterëve të shpallura nga IAL;

Informimi i nxënësve maturante lidhur me kriteret e përzgjedhjes në perputhje me prirjet dhe meritat që zotërojnë.

AKPA në bashkëpunim me Agjencinë Austriake për Arsimin dhe Ndërkombëtarizim, OeAD kanë hartuar Udhëzuesin praktik për Koordinatorin e Orientimit të Karrierës të AFP-së. Nëpërmjet këtij udhëzuesi synohet qartësimi i detyrave të Koordinatorit të Orientimit për Karrierën në AFP, dhe bashkëpunimi me Koordinatorët e Njesisë së Zhvillimit dhe aktorët e tjerë të fushës së arsimit.

Gjithashtu ai synon të qartësojë detyrat që lidhen me koordinimin dhe ndërveprimin midis arsimit 9-vjeçar, gjimnazit dhe atij profesional, duke evidentuar elementët që lidhen me tranzicionin arsimor të nxënësve nga një nivel në tjetrin dhe mbështetjen e tyre përmes funksionit të Koordinatorit të Orientimit për Karrierën. Për ta bërë sa më praktik dhe të dobishëm, janë përfshirë shtojca të ndryshme që ofrojnë modele planifikimi, integrimi dhe raportimi të veprimtarive të orientimit për karrierën, si dhe fletë pune dhe aktivitete, të krijuara për të nxitur zhvillimin e aftësive dhe njohjen me strategjitë e kërkimit të punës.

➤ Koordinator për orientimin në karrierë

Bazuar në Udhëzimin nr. 759 datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të AFP, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të AFP dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", çdo IOAFP ka në përbërje të saj edhe njësinë e zhvillimit.

Neni 104 i këtij udhëzimi përcakton:

Për realizimin e funksionit të orientimit dhe këshillimit për karrierë të nxënësve/kursantëve të ofruesit të AFP-së, njësia e zhvillimit, nëpërmjet koordinatorit përkatës:

- a) siguron që kandidatët për nxënës/kursant, prindërit dhe komuniteti, kanë informacion të mjaftueshëm mbi natyrën e profesioneve dhe kualifikimeve që ofrohen;
- b) analizon këndvështrimin e nxënësve lidhur me zgjedhjen e profilit, në mbështetje të procesit të diversifikimit të ofertës mësimore në nivel ofruesi;
- c) kontribuon në procesin e regjistrimit dhe hartimit të procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për programe të AFP-së;
- d) siguron që nxënësit kanë informacion të mjaftueshëm për zgjedhjen e profilit, sipas strukturës së programit të kualifikimit;
- e) siguron në bashkëpunim me koordinatorin/en për zhvillimin e kurrikulës, që kurrikula e zbatuar përmban elemente të edukimit për karrierë;
- f) informon dhe orienton në bashkëpunim me koordinatorin/en për marrëdhënie me biznesin, nxënësit dhe prindërit e tyre me tregun e punës, mundësitë për karrierë dhe punëdhënësit e mundshëm, si edhe nivelet e pagave.
- g) mbështet nxënësit për hartimin e jetëshkrimit (CV) për aplikime në praktikë profesionale dhe në pozicionet vakante të punës për nxënësit punëmarrës.

Për sa më sipër në të gjitha shkollat e mesme profesionale janë ngritur njësitë e zhvillimit me personat përgjegjes si dhe është kryer trajnimi dhe zhvillimi profesional i tyre nëpërmjet mbështetjes së AKPA dhe projekteve që mbështesin arsimin profesional.

- Në kuadër të projektit Flamurtar për Bashkëpunimin Zhvillimor të Bashkisë së Qytetit të Vjenës "AL-VET – Cilësi për të Gjithë", Zyra rajonale për bashkëpunim e Agjencisë Austriake për Arsim dhe Internacionalizim (OeAD) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) organizuan në muajin mars 2024 Trajnimin Rrjetëzues për orientimin në karrierë ku morën pjesë Koordinatorët e Orientimit për Karrierë të shkollave të AFP-së dhe specialistë të trajnuar për edukimin për karrierë nga Zyrat Arsimore Rajonale.
- Agjencia Austriake për Arsim dhe Ndërkombëtarizim, OeAD në bashkëpunim me AKPA ka organizuar në muajin qershor 2024 "Workshopin e Rrjetëzimit për Orientimin në Karrierë" për Koordinatorët e orientimit të Karrierës të Shkollave të AFP-së dhe QFPP-ve, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës ndërmjet koordinatorëve të karrierës mbi sfidat dhe praktikat më të mira të ofrimit të shërbimeve të orientimit në karrierë, si dhe stimulimi i një rrjeti ndërmjet koordinatorëve të karrierës për shkëmbim të vazhdueshëm mbi ofrimin e shërbimit të karrierës.

➤ **Projekti Super-Schools**

Programi i Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) për programin rajonal **Supershkollat – Program i Shkëmbimit të Shkollave në Ballkanin Perëndimor**. Supershkollat ka për qëllim ndërtimin e paqes dhe të pajtimit në Ballkanin Perëndimor. Ky projekt i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian (BE), Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) si edhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO).

Në ciklin e parë, nga Shqipëria u mbështetën 11 shkolla të mesme (gjashtë gjimnaze të përgjithshme, një privat dhe 4 shkolla profesionale) dhe u shkëmbyen mbi 120 nxënës shqiptar. Në ciklin e tretë të programit, u përzgjedhën 9 shkolla të mesme profesionale për të qenë pjesë e mobilitetit në rajon janë si më poshtë: Shkolla “Beqir Çela”, shkolla "Rakip Kryeziu", shkolla “Hamdi Bushati, shkolla "Tregtare", shkolla "Kristo Isak", shkolla “Petro Sota”, shkolla "Salih Ceka", shkolla Kamëz, shkolla "Charles Telford Erickson".

Gjatë periudhës 2024-2025, që përkon me ciklin e tretë të programit, do të mbështetën 16 shkolla të mesme, ndër të cilat pesë shkolla profesionale, përkatësisht: shkolla “Petro Sota”, Fier, shkolla "Tregtare", Vlorë, shkolla profesionale Shërbime, Korçë, shkolla “Hysen Çela”, Durrës, shkolla “Gjergji Canco”, Tiranë.

➤ **Projekti kombëtar “Re-Debate” në kuadër të projektit "Qëndro" në bashkëpunim me UNICEF.**

Në kuadër të projektit “QENDRO”, UNICEF gjatë vitit 2024 ka mbështetur projektin kombëtar “Re-Debate” të zbatuar nga organizata Liburnetik, duke përfshirë dhe 14 shkolla të mesme profesionale, përkatësisht: Kolin Gjoka, Nazmi Rushiti, Hoteleri-Turizëm, Teknike Ekonomike, Profesionale Kamëz, Shkolla Profesionale Elbasan, Shkolla Tregtare Vlorë, Antoni Athanas, Charles Telford Ericson, shkolla Herman Gmeiner, shkolla Pavarësia, Vlorë, Hamdi Bushati, Shkodër dhe shkolla Beqir Çela, Durrës.

➤ **Promovim nëpërmjet rasteve të suksesit**

AKPA nëpërmjet kanaleve të saj të komunikimit promovon në mënyrë të vazhdueshme rastet e suksesit të të rinjve që pas trajtimit me shërbime apo programe integrohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të suksesshme në tregun e punës. Gjatë vitit 2024 janë publikuar nga AKPA 49 raste (video/postime) me rastet e suksesit të të rinjve.

➤ **Rritja e pjesëmarrjes në AFP (vitit i arsimit profesional) dhe nxitja e të nxënësve gjatë gjithë jetës.**

Nismat dhe masat e ndërmarra për rritjen e pjesëmarrjes në arsim profesional për vitin shkollor 2024-2025:

- Organizimi i aktiviteteve të perbashkëta me MAS në nivel kombëtar dhe në 4 rajone në kuadër të identifikimit dhe referimit të sfidave të rritjes së pjesëmarrjes në AP;
- Konferenca kombëtare “Viti i Arsimit Profesional” (zhvilluar më 23-24 mars);

- 4 takime të përbashkëta rajonale të organizuara nga grupi nderinstitucional i punës midis MEKI dhe MAS;
- Takime dhe tryeza të përbashkëta me bizneset, ZP, QFP,/shkollë për pasurimin dhe promovimin e ofertës;
- Në zbatim të planit të promovimit për vitin shkollor 2024-2025 i cili përfshiu periudhën mars shtator 2024 përveç aktiviteteve në nivel kombëtar IOAFP-të kanë zhvilluar aktivitete në nivel shkolle si me poshtë:
 - 1930 - Vizita në shkollat 9 -vjeçare
 - 2142 - Familje të nxënësve të klasave të 9-ta të kontaktuara
 - 350 - Ditët e hapura në shkollë
 - 137 - Promovim në televizionet lokale
 - 90 - Pjesëmarrja në panairë Zhvillimi dhe përditësimi i faqes së dedikuar për AFP-në aftësi.al
 - 815 - Takime me aktorë të tregut të punës/ ZP, bashki, biznes, shoqata
 - 3175 - Postime në rrjete sociale (FB, Instagram, Twiter, etj)
 - 644 - Organizimin e aktiviteteve të këshillimit për karrierë
 - 132 - Pjesëmarrja e nxënësve të shkollës në konkurse
 - 88 - Aktivitete të tjera
- Zhvillimi dhe përditësimi i faqes së dedikuar për rrjetin e profesionistëve afro.al
- Zbatimi për here të parë të nismës së Qeverisë Shqiptare, të arsimit profesional në formën e dyfishtë në 10 shkollat profesionale të vendit, me fokus në 8 rajone dhe në katër sektorë strategjikë, Turizëm, Teknologji Komunikimi dhe Informacioni, Transporti dhe Energjia.
- Shkolla Hoteleri Turizem do të ofrojë për herë të parë edhe kualifikimet e shkollës VET by EHL Group, e cila është lider në botë në edukim në fushën e hotelierisë me tre drejtime: Kuzhinë, Hoteleri dhe Shërbime ushqimi dhe pije.

Realizimi financiar

Realizimi i kësaj mase është 100%. Kjo vjen si pasojë e aktiviteteve të shumta të organizuara dhe mbështetjes së donatorëve.

Realizimi Masa 2.1.3 i SKR për vitin 2024



Pagat dhe sigurimet shoqërore e kanë normën e realizimit 100%. Për zërin materiale, shërbime dhe kontigjenca niveli i realizimit është 100%.

Kjo masë nuk ka hendek financiar. Për këtë masë 100% e fondeve janë të buxhetit të shtetit.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 2.1.4 Nxitet dhe forcohet novacioni, përmes sipërmarrjeve rinore dhe nga të rinjtë duke e vënë novacionin rinor në fokus të kuadrit ligjor dhe politikave publike të Start Up-eve, politikave të punësimit dhe mbështetjes së nismave si co-working spaces.

Në mbështetje të nenit 14, pika 6 të Ligjit nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”, i ndryshuar, të pikës 14, Kreu V, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 61, datë 7.2.2024 “Për miratimin e kërkesave e të kritereve që duhet të plotësojnë start up-et dhe lehtësuesit e startup-eve, të procedurave e të afateve, si dhe të rregullave për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kritereve, procedurës së përzgjedhjes e të shpërblyerimit të anëtarëve të tyre, shpallen projektet fituese të mbështetjes me grante nga qeveria shqiptare.

Pas një procesi të kujdesshëm dhe të detajuar të vlerësimit të 539 aplikimeve të mbërritura nga të gjitha qytetet e vendit, janë përzgjidhedhur startup-et që do të sigurojnë financimin nëpërmjet skemës Grant 2024, për të realizuar projektin e tyre inovativ. Ky grant, me një fond total prej 300 milionë lekësh, përfaqëson një nga nismat më të fuqishme të akorduara nga qeveria shqiptare në mbështetjen e inovacionit dhe zhvillimit të startup-eve në vend. Thirrja e mbështetjes, e cila u hap më 16 shkurt të 2024, është shprehje e përpjekjeve të qeverisë Shqiptare për të rritur mundësitë për sipërmarrësit dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Fituesit e përzgjedhur do të përfitojnë nga financimi në tre faza të ndryshme të zhvillimit të tyre. Faza e parë e financimit është projektuar për mbështetjen e individëve në fazë ideje ku janë përzgjedhur 22 projekte, të cilët sigurojnë deri në 1.5 milionë lekë për ta realizuar dhe për të krijuar një bazë të qëndrueshme për sipërmarrjen e tyre. Për fazën e dytë janë përzgjedhur 54 projekte fituese, startup-e që tashmë kanë një produkt apo shërbim dhe kanë krijuar një prototip. Përfituesit e kësaj faze sigurojnë deri në 4.5 milionë lekë për të avancuar zhvillimin e biznesit të tyre dhe për të gjetur klientë të mundshëm në treg. Në fazën e tretë janë përzgjedhur 18 startup-e fituese, të cilët ofrojnë një produkt në treg dhe me mbështetjen e siguruar nga Grant2024 do të zgjerojnë aktivitetet e tyre në tregje të reja. Startup-et në këtë fazë do të përfitojnë deri në 9 milionë lekë për të rritur dhe zhvilluar biznesin e tyre.

Projektet fituese janë të kategorizuara sipas sektorëve dhe nën-sektorëve industrialë, konkretisht: 14 fitues nga fusha e IT-së, 8 fitues nga AI, 7 fitues nga E-commerce, 6 fitues nga Prodhimi, 6 fitues nga EdTech, 4 fitues nga HealthTech, 5 fitues nga FinTech, 5 fitues nga Lojërat Elektronike, përkatësisht nga 4 fitues për Business Services, Energjitikë, Turizëm, Marketing; 3 fitues nga AgriTech; përkatësisht nga 2 fitues për ESG, Siguria Kibernetike, Robotika, Logjistika, SportTech Ekonomia Ricikluese si edhe përkatësisht nga 1 fitues për Fashion, Media, Turizëm Profesional, Zhvillim Profesional, Blockchain dhe Infrastrukturë.

Thirrja për masa mbështetëse, Grant2024 është vetëm një nga shumë programet dhe iniciativat që qeveria Shqiptare ka planifikuar për të mbështetur dhe zhvilluar ekosistemin e startup-eve në Shqipëri. Në këtë kuadër, qeveria po do të miratojë së shpejti një strategji të re për zhvillimin e kompanive inovative, e cila do të përfshijë krijimin e instrumenteve të reja financiare dhe përmirësimin e kushteve për financimin alternative të startup-eve. Kjo strategji synon të krijojë një mjedis më të favorshëm për

rritjen e inovacionit dhe të nxisë bashkëpunimin ndërmjet sektorit privat, akademisë dhe institucioneve qeveritare.

Gjatë muajit Dhjetor 2024 është shpallur Thirrja për mbështetjen e Kompanive Startup dhe Lehtësuesit e Startup-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse 2025 për të stimuluar sipërmarrjen inovative duke ofruar financim për kompanitë startup më premtuese shqiptare.

Ky program është krijuar për të ndihmuar në vazhdimësi kompanitë startup dhe lehtësuesit e start up-eve në një fazë kritike të zhvillimit dhe për t'u mundësuar sipërmarrësve në Shqipëri të ndërtojnë bizneset e tyre inovative në vend. Kompanitë dhe përfituesit e tjerë që marrin financim nëpërmjet këtij programi pritet të ofrojnë një model të përdorshëm komercialisht, tregtojnë një pilot ose ofrojnë një produkt ose shërbim të gatshëm për tregun dhe shtrirje tek klientët e parë potencialë gjatë kohëzgjatjes së projektit.

Mbështetjen me grant e përfitojnë startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik të startup-eve dhe lehtësuesve, që janë të pajisur me pasaportën përkatëse. Aplikantët mund të jenë individë, nomadë dixhitalë, kompani private mikro, të vogla dhe të mesme të themeluara në Shqipëri, jo më të vjetra se 6 vjet në momentin e aplikimit.

Financimi i dhënë nga qeveria Shqiptare në kuadër të mbështetjes me grante 2025, do të mbulojë 100% të kostove totale të projektit për aplikantët fitues në fazën e parë – Faza e Ndërtimit të Konceptit; 85% të kostove për aplikantët fitues në fazën e dytë – Faza e Validimit dhe 75% të kostove për aplikantët në fazën e tretë – Faza e Zgjerimit dhe Ndërkombëtarizimit. Afati i implementimit të projekteve për vitin 2025 do të jetë afërsisht 9 muaj.

Vendimet e financimit do të merren në bazë konkurruese nga një komision i vlerësimit i përbërë nga specialistë të ekosistemit, administrate shtetërore dhe pjestarë të akademisë. Numri i projekteve fituese do të përcaktohet nga cilësia e aplikimeve dhe do të jenë subjekt i totalit të fondeve të disponueshme ose të alokuara për vitin 2025. Gjithashtu, në mbështetje të këtij programi, Agjencia Startup Albania do të ofrojë mbështetje me mentorë dhe trajnime në fusha të tilla si zhvillimi i biznesit, marketing, shitjet, mbrojtjen dhe menaxhimin e pronësisë intelektuale dhe të tjera, në varësi të nevojave specifike të startup-eve. Ky Manual i Thirrjes ofron informacion në lidhje me kriteret dhe procedurat e aplikimit dhe ne shpresojmë se informacioni do t'ju ndihmojë të lundroni lehtësisht gjatë procesit. Manuali i Thirrjes dhe procedurat përkatëse janë ndërtuar për të qenë transparente, të drejta dhe mbi të gjitha, për të evidentuar dhe mbështetur sipërmarrësit më të talentuar dhe kompanitë startup më të mira që operojnë në Shqipëri.

Realizimi Masa 2.1.4 i SKR për vitin 2024



Realizimi financiar

Fondet e planifikuara për këtë masë në vitin 2024 lidhen me fondin e mbështetjes për start up të Ministrit të Shtetit për Mbështetjen e Sipërmarrjes. Ky aktivitet është zhvilluar dhe fondet janë realizuar 100%. Pra, norma e realizimit për masën është 100%.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 2.1.5 Përmirësohen programet dhe shërbimet që ofrojnë mbështetje për lëvizshmërinë e të rinjve dhe bashkëpunimin mes tyre brenda vendit e më gjerë.

MSHRF dhe AKR në kuadër të mbështetjes së shkëmbimeve mes të rinjve në datat 24, 25 dhe 26 Korrik u zhvillua shkëmbimi kulturor **"Trashëgimia dhe, sot dhe nesër"** organizuar nga MSHRF/AKR dhe MKRS Kosovë. Ky aktivitet përgjatë tre ditëve bëri bashkë 9 të rinj nga Shqipëria dhe 9 të rinj nga Kosova, me qëllim shkëmbimin kulturor dhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë e trashëgimisë kulturore si pjesë e identitetit tonë kombëtar. Të rinjtë vizituan Kalanë e Ishmit, Amfiteatrin e Durrësit, Parkun Arkeologjik të Apolonisë dhe kalanë e Bashtovës. Gjithashtu në datat 21-23 Tetor u zhvillua shkëmbimi rinor në Kosovë, ku të rinjtë nëpërmjet këtij turi patën mundësinë të njihen me vende si, Çarshia e Vjetër e cila është zemra e ekonomisë në Gjakovë, Muzeun Etnografik të Gjakovës, Parkun Arkeologjik Ulpianës, Kalanë e Novobërdës, Lidhjen e Prizrenit, Muzeu Arkeologjik, Kalanë e Prizrenit, etj.

Lidhur me paketa të posacme që ofrojnë mbështetje për lëvizshmërinë dhe bashkëpunimin midis të rinjve, në vijim të ndryshimeve të Ligjit për Rininë, do të adresohen në vijim.

Realizimi financiar

Në këtë masë janë parashikuar aktivitete që lidhen me përdorimin e portalit "Të rinjtë për Të rinjtë". Janë bërë aktivitete por që lidhen më shumë me aspekte të tjera të bashkëpunimit dhe rrjetëzimit të të

rinjve. Ndërkohë, akoma nuk janë marrë masa për të ndihmuar dhe mbështetur të rinjtë për të lëvizur për punësim nga një qytet në tjetrin.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e përealizuar**.

Masa 2.1.6 Lehtësohet transporti publik ndërqytetas për të rinjtë, duke rritur lëvizshmërinë e tyre në qarqe.

Për këtë masë është planifikuar që në vitin 2023 të realizohej "Analizë e situatës së lëvizshmërisë së të rinjve (sa punojnë larg vendbanimeve) për të zhvilluar masa për lehtësimin e transportit publik ndërqytetas për të rinjtë." Për vitin 2024 është planifikuar, që në bazë të rezultateve të analizës së situatës, të bëhen amendime në ligjin për kompensimin e shpenzimeve të transportit. Aktualisht nuk është realizuar asnjëri nga dy aktivitetet.

Kjo **është masë e përealizuar**.


Përmbledhje për këtë objektiv specifik.

Institucionet kanë raportuar të gjithë masat që lidhen me objektivin specifik 2.1.

Realizimi financiar

Realizimi i 6 masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë:

Statusi i realizimit të masave të Objektivit 2.1



Objektivi Specifik 2.2: Të rinjtë janë të informuar mirë për mundësitë arsimore të lidhura me tregun e punës dhe ju mundësohet i mësuari cilësor si në arsimin formal ashtu edhe në atë joformal duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave, aftësive dhe virtyteve të tyre.

Realizimi i fondeve totale është 99.5%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 85% dhe mallra, shërbime dhe kontigjenca është realizuar 100%. Për objektivin 2.2 dhe atë 2.3 nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Realizimi Objektivi 2.2 i SKR për vitin 2024



Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

Masa 2.2.1 Mbështeten të rejtat dhe të rinjtë në pikat kritike të zhvillimit, si kalimi në shkollën e mesme të lartë dhe kalimi nga shkolla në tregun e punës ose në studimet e nivelit universitar, me këshillim dhe informacione, që lidhin përzgjedhjen e fushës së arsimimit me mundësitë në tregun e punës, në bashkërendim me masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.

Kurrikula e bazuar në kompetenca, që po zbatohet në të gjithë arsimin para universitar, synon që nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të nxënësve gjatë gjithë jetës. Në arsimin bazë (klasat 1-9) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12), njohuritë e integruara në lëndë të ndryshme, si qytetaria, gjuha shqipe etj., dhe aftësitë që nxënësit zhvillojnë, i udhëheqin ata në procesin e njohjes së interesave, potencialit dhe nevojave të tyre, i ndihmojnë të zbulojnë rëndësinë e secilit profesion, të orientohen për të menduar në të ardhmen, për të menduar mirë, për t'u orientuar drejt zgjidhjes së problemit të tyre dhe aftësitë sipërmarrëse.

Gjithashtu, në arsimin e mesëm të lartë, rreth 12 module profesionale, si pjesë e kurrikulës me zgjedhje, synojnë zhvillimin e aftësive profesionale dhe sipërmarrëse të nxënësve. Moduli "*Edukimi në karrierë*" është një lëndë që i kushtohet tërësisht orientimit të nxënësve në karrierën e tyre, e cila ofrohet në arsimin e mesëm të lartë si pjesë e kurrikulës me zgjedhje. Kjo lëndë ka 1 orë/javë ose 36 orë në vit.

Krahas mbështetjes që ofron kurrikula për edukimin në karrierë të nxënësve, orientimi në karrierë i nxënësve mbështetet edhe nëpërmjet planifikimit dhe zhvillimit të aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëshkollore, me pjesëmarrjen dhe angazhimin e mësuesve, drejtuesve të shkollave, shërbimit psiko-social në shkollë, si dhe bashkëpunimit e partneritetit me partnerë socialë, si prindërit, bizneset, pushteti vendor, institucione të tjera arsimore, organizata të tjera etj.

Vëmendje e veçantë i kushtohet dy pikave të tranzicionit, kalimit nga klasa e 9-të në arsimin e mesëm të lartë dhe kalimi nga klasa e 12-të në arsimin e lartë ose tregun e punës.

Në secilën shkollë është caktuar një koordinator i orientimit në karrierë, i cili në bashkëpunim me mësuesit, punonjësit e shërbimit psiko-social, drejtuesit e shkollës, prindërit dhe anëtarët e tjerë të komuniteteve mbështesin edukimin dhe orientimin në karrierë të nxënësve.

Aktivitetet e orientimit të karrierës në shkolla synojnë të sigurojnë që nxënësit të jenë të mirë informuar, të ndihen të mbështetur për ta bërë sa më efektiv kalimin nga arsimi 9-vjeçar në arsimin e mesëm dhe të lartë dhe të ndjekin me sukses rrugët e tyre të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Aktivitetet për orientim në karrierë përfshijnë ditët e karrierës, bisedat me prindërit, vizitat në institucionet arsimore dhe të zhvillimit profesional, aktivitete që mbështesin zhvillimin socio-emocional të nxënësve etj.

Krahas mbështetjes që kurrikula ofron për edukimin e nxënësve për karrierën në të gjithë arsimin para universitar, orientimi i nxënësve për karrierën është një fushë prioritare e përgatitjes dhe formimit të nxënësve në sistemin arsimor para universitar. Me Urdhërin Nr. 600, datë 19.10.2023 është miratuar dhe ka filluar zbatimin *“Udhëzuesi i orientimit për karrierë të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6 – 9)”*. Udhëzuesi ka si qëllim mbështetjen e shkollave dhe të institucioneve arsimore përgjegjëse për arsimin para universitar për ndërtimin e praktikave të qëndrueshme të orientimit dhe këshillimit për karrierën.

Ne këtë kuadër për fuqizimin e kapaciteteve të ekipeve të orientimit për karrierën në shkolla (drejtues, koordinatorë të shkollave, mësues të klasave 6 dhe 9) janë zhvilluar:

- Trajnime intensive për koordinatorët e këshillimit të karrierës në teknikat dhe strategjitë më efektive të këshillimit të karrierës, përfshirë metodat e intervistimit, analizën e preferencave të karrierës, dhe zhvillimin e planeve të karrierës për të rinjtë.
- Janë organizuar sesione trajnuese për të përmirësuar aftësitë e koordinatorëve të këshillimit të karrierës në fusha të tilla si komunikimi, konsultimi, dhe ndihma në zhvillimin e aftësive të punës. Këto sesione mund të përfshijnë role-playing, analiza të rasteve, dhe shkëmbim të përvojave. (ZVAP) (afërsisht 5,000 të trajnuar).
- Sigurimi i aksesit për koordinatorët e këshillimit të karrierës në një bazë të mirë informuar të burimeve dhe informacioneve për karrierën dhe zhvillimin e aftësive. Trajnimi në përdorimin e burimeve të ndryshme të informacionit dhe softuerëve të specializuar për këshillimin e karrierës. (ZVAP)
- Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave: organizimi i takimeve të rregullta dhe aktiviteteve kombëtare/ ndërkombëtare për koordinatorët e këshillimit të karrierës për të shkëmbyer përvojat dhe praktikat më të mira në fushën e këshillimit të karrierës, vizita në institucione të tjera, konferenca dhe workshop-e të përbashkëta.
- Promovimi i arsimit profesional nëpërmjet fushatës informuese *“Zgjidh zanatin”*, që ka si qëllim fuqizimin e ekipeve të këshillimit të karrierës në shkolla dhe promovimin e arsimit profesional, për t’i orientuar nxënësit drejt formimit profesional dhe zanatit, që do ju shërbejë për të ardhmen e tyre.

- Duke filluar nga klasa e 10-të e në vazhdim, por në mënyrë të veçantë në klasën e 12-të, zhvillohen seanca informuese me nxënës dhe prindër për lëndët dhe provimet me zgjedhje, në lidhje me mundësitë për ndjekjen e drejtimeve të caktuara, ditët e hapura të informimit pranë universiteteve, panairët e karrierës, vizita në kompani të ndryshme etj.
- Ditët e hapura dhe ditët e informimit me maturantët janë veprimtari që zhvillojnë bashkëpunimin e shkollave të mesme me universitetet përgjatë të cilave nxënësit informohen lidhur me programet e studimit që mund të ndjekin.

Në arsimin e mesëm e të lartë, duke e njohur rëndësinë e orientimit në karrierë për nxënësit, shkollat kryejnë aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe jashtëshkollore, përmes angazhimit dhe punës ekipore, për të informuar nxënësit dhe për të mbështetur zgjedhjet dhe vendimet e tyre në lidhje me arsimimin e mëtejshëm dhe përgatitjen për tregun e punës. Duke filluar nga klasa e 10-të e në vazhdim, por veçanërisht në klasën e 12-të, zhvillohen seanca informuese me nxënës dhe prindër për lëndët me zgjedhje dhe provimet. Organizohen ditë të hapura informimi në universitete, panairë karriere, vizita në kompani të ndryshme, panair pranë Dhomës së Tregtisë (Punë dhe Studim) etj.

Shërbimi psiko-social në shkolla luan një rol të rëndësishëm nëpërmjet mbështetjes që u ofron nxënësve në përpjekjet e tyre për të kapërcyer sfidat, për të njohur dhe kuptuar veten për sa i përket interesave, aftësive, pikave të forta dhe të dobëta, mundësive për përmirësim duke i mbështetur ata gjatë gjithë tranzicionit dhe karrierës së tyre.

Forcimi i orientimit në karrierë në arsimin para universitar mbështetet nëpërmjet trajnimeve dhe zhvillimit profesional të kapaciteteve të shkollave dhe të zyrave arsimore vendore dhe rajonale.

Gjithashtu:

- Zyrtar Vendore Arsimore Parauniversitare (ZVAP) dhe Institucionet e Arsimit Para universitar (IAP-shkollat e mesme), kanë hartuar kalendarin e aktiviteteve për informimin dhe këshillimin e nxënësve të klasave 10-të, 11-të dhe 12-të, me qëllim orientimin e tyre drejt rrugës së suksesit.
- ZVAP-të kanë ofruar mbështetje dhe këshillim pranë institucioneve arsimore, për çështje të ndryshme që lidhen me orientimin për karrierën.
- ZVAP-të kanë iniciuar shkëmbimin e përvojave pozitive midis institucioneve arsimore në punën edukuese mbi këshillimin e karrierës.
- Shërbimi Psiko-Social pranë ZVAP-ve, ka realizuar seanca trajnuese me mësues, nxënës, prindër, të tilla si: trajnim me mësues: *“Mësuesi si këshillues karriere në shkollë”*; trajnim me nxënës: *“Menaxhimi i kohës, element kyç në suksesin e përgatitjes për të ardhmen”*; *“Koncepti për veten dhe njohja e aftësive personale si faktor në zgjedhjen e profesionit”*. Bisedë me nxënës: *“Si të menaxhojmë stresin para provimeve”*. Takim me prindër: *“Roli i prindit në zgjedhjen e degëve të fëmijëve, dilema dhe çështje”*.

Bashkëpunimi i ZVAP-ve, IAP-ve me AKPA ku janë realizuar:

- Tryeza të rrumbullakëta me drejtues, mësues, nxënës të rinj të Qendrës Rinore, përfaqësues të IAP-ve, mbi rëndësinë e mbështetjes së të rinjve me qëllim orientimin për gjatë gjithë jetës për karrierën dhe sipërmarrjen.

➤ Biseda informuese me nxënës, mësues, prindër, drejtues të arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional, përfaqësues të AKPA, mbi rëndësinë e ndjekjes së kurseve afatshkurtra ose post-sekondare nga të rinjtë që janë duke ndjekur studimet e arsimit të mesëm të lartë ose arsimit profesional, si dhe atyre që kanë përfunduar studimet universitare me qëllim integrimin në tregun e punës, si dhe me aftësitë e duhura që duhet të zotërohen nga të rinjtë për punësim/vetëpunësim ose edhe për hapjen e një biznesi personal dhe familjar. Vizita pranë bizneseve lokale të nxënësve të grupmoshave të ndryshme të arsimit bazë dhe të lartë, të mësuesve, drejtuesve të IAP-ve për t'u njohur më nga afër me praktikën e punës, për t'u socializuar me mjedisin dhe profilin e punës etj.

➤ Ditë të hapura, të realizuara nga shkollat profesionale me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave 9-vjeçare të ZVAP, përfaqësues të bizneseve lokal, për orientimin dhe informimi e tyre mbi përfitimet e të ndjekurit të arsimit profesional dhe mundësitë e karrierës që rrjedhin prej arsimimit në këto IAP.

Takim me prindër: “Roli i prindit në zgjedhjen e shkollës së arsimit të mesëm të lartë të fëmijëve, dilema dhe çështje”. Bisedë me nxënës: “Si të menaxhojmë stresin para provimeve”.

Janë zhvilluar pyetësorët për të identifikuar aftësitë dhe prirjet për nxënës të AMU. Realizohet përpunimi i pyetësorëve në bashkëpunim me mësuesit kujdestarë. Të dhënat mbi prirjet e nxënësve ndihmojnë për ngritjen e temave dhe veprimtarive për të cilat nxënësit kanë më shumë nevojë. Janë orientuar nxënësit e klasave të nënta për hartimin e një CV, si dhe biseda apo debate mbi orientimin e karrierës për t'i ndihmuar nxënësit të jenë më kritik.

Në shkolla janë zhvilluar programe mbështetëse, që orientojnë të rinjtë në procesin e përzgjedhjes së llojit të arsimit kur marrin vendimet në lidhje me zgjedhjen e arsimit të mesëm të lartë ose atij profesional dhe më pas vendimin për të zgjedhur degën e studimeve universitare apo punësimin¹².

Realizimi financiar

Për këtë masë janë raportuar shumë aktivitete, por në SKR 2022 – 2029 janë planifikuar shpenzime të lidhura me portalin Të rinjtë për Të rinjtë. Për këtë arsye evidentohet se norma e realizimit të paga dhe sigurime shoqërore është 71%.

¹² Disa nga temat e realizuara:

1. Formimi, miratimi dhe funksionimi i organit të “Këshillimit të Karrierës”, sipas udhëzimeve të MAS dhe ZVAP;
 2. Informimi i maturantëve për suportin që përfitojnë nga bashkëpunimi me “Këshillimin e Karrierës”;
 3. Takime me nxënësit maturantë, për t'i orientuar në marrjen e informacionit fizik dhe online, për njohjen me kriteret, mënyrën e pranimit në universitete si dhe përditësimin mbi ecurinë e shpalljes së fituesve;
 4. Dhënia e informacioneve dhe shpjegimeve mbi rëndësinë dhe vlerën që kanë vlerësimet vjetore dhe rezultatet në D1, D2, D3 & Z1, në fitimin e degës së preferuar sipas kriterëve të shpallura nga IAL;
- Informimi i nxënësve maturante lidhur me kriteret e përzgjedhjes në perputhje me prirjet dhe meritat që zotërojnë.

Realizimi Masa 2.2.1 i SKR për vitin 2024



Ndërkohë, Ka pasur një mbështetje edhe nga donatorët në aktivitetet e ndryshme të realizuara. Norma e realizimit të shpenzimeve totale është 99%, ndërkohë norma e realizimit e mallra, shërbime dhe kontigjenca është 100%.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 2.2.2 Promovohet përdorimi i sigurt i teknologjive të reja dhe mbështetet përvetësimi i aftësive dhe kompetencave digjitale të shekullit të 21-të për të rinjtë, si në sistemin arsimor të përgjithshëm dhe atë profesional ashtu edhe në sistemin e trajnimeve formale dhe jo-formale.

Gjatë vitit 2024 ndër rezultatet kryesore ka qenë zgjerimi i programeve të kodimit në arsimin fillor, duke u shtrirë në disa shkolla pilot në nivel kombëtar, si dhe zhvillimi i trajnimeve të specializuara në fushën e teknologjisë dhe programimit për të rinjtë përmes aktiviteteve jo-formale. Programet si kampet e kodimit, laboratorët digjitalë dhe kurset e aftësive teknologjike kanë rritur ndjeshëm përfshirjen dhe ndërgjegjësimin e të rinjve për përdorimin kreativ dhe të sigurt të teknologjisë, duke u dhënë atyre mjete konkrete për t'u përgatitur për tregun e punës dhe sfidat e epokës digjitale.

Realizimi financiar

Për këtë masë ka pasur shpenzime në 2024 pasi edhe pse është planifikuar që aktivitetet të realizohen në 2 vitet e para të zbatimit të SKR 2022 - 2029, qeveria vazhdon me mbështetjen e Programit të Kodimit dhe me përfshirjen e aftësive digjitale në klasat e para pasi aftësitë digjitale të fëmijëve dhe të të rinjve dhe të rejave janë prioritet.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 2.2.3 Mbështeten dhe zhvillohen programe të seksioneve sportive amatore, arteve, artizanatit dhe aktiviteteve të tjera jashtë-kurrikulare që synojnë zhvillimin e aftësive për jetë të shëndetshme, me fokus të veçantë tek të rejat.

- Programi Jashtë orarit mësimor

Implementimi i programit “Jashtë orarit mësimor” për fëmijët filloi në muajin janar 2023 gjatë semestrit të dytë të vitit shkollor 2022-2023 nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë në 200 shkolla në të gjithë Shqipërinë.

Për t’i ofruar çdo fëmije mundësinë të ndjekë kurse pas-shkolle falas është konceptuar Programi “Jashtë orarit mësimor”, i cili përfshin kurse në pikturë, muzikë, kor, teatër, zeje, teknologji, sport dhe kulturë. Programi ka si qëllim të rrisë orientimin pro-social dhe komunitar të fëmijët dhe të rinjtë, duke i shndërruar shkollat në qendra të jetës në komunitet; të përmirësojë të nxënës të nxënës, duke ofruar mundësi joformale të të nxënës në bashkërendim dhe si shtojcë e kurrikulës formale; të përmirësojë gatishmërinë dhe ndërgjegjësimin rreth karrierës; të mbështesë shëndetin fizik dhe psiko-social të nxënësve.

Programi po zbatohet në formën e lëndëve me zgjedhje që zhvillohen në mjediset e shkollës dhe zhvillohen nga mësuesit e së njëjtës shkollë, rregullisht (dy herë në javë) gjatë gjithë vitit shkollor. Në total, u hapën 1041 kurse tematike në 8 disiplina (pikturë, muzikë, kor, teatër, artizanat, teknologji, sport dhe permakulturë), duke angazhuar mbi 644 mësues dhe duke përfshirë më shumë se 10,000 nxënës të sistemin para universitar.

Gjatë periudhës së raportimit, grupi ndërinstitucional ka punuar në nivelin e dytë të Programit Jashtëkurrikular, i cili do të përbëhet nga kurse më të avancuara që zhvillohen në qendra të specializuara.

Në verën e vitit 2024, Thumana u bë mikëpritësja e një nisme që synonte tu ofronte fëmijëve një eksperiencë unike jashtë orarit mësimor. Kampi Veror për Fëmijë, një iniciativë e Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Save the Children në Shqipëri, Fondacionin Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkinë Krujë, i cili solli një qasje inovative në aktivitetet jashtëshkollore duke u fokusuar në argëtim, edukim dhe zhvillim të talentëve.

Ky kamp u organizua në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Rinisë, si një projekt pilot që synon të forcojë angazhimin e fëmijëve në aktivitete të strukturave jashtë mësimore. Ai erdhi si një zgjerim i programit “Art dhe Zeje”, i cili tashmë zhvillohet pas shkolle në 200 institucione të vendit.

Në kamp 80 fëmijë nga Thumana patën mundësinë të eksploronin pasionet dhe aftësitë e tyre përmes një programi të larmishëm që përfshinte arte, anglisht, volejboll, muzikë dhe pikturë. Këto aktivitete u mbajtën në qendrën “Atrium”, me mbështetjen e ekspertëve të fushës, duke krijuar një mjedis ku fëmijët mund të mësonin dhe të shprehnin kreativitetin e tyre.

Në këtë mënyrë u bë dhe zbatimi i nivelit të dytë të Programit Kombëtar për Aktivitetet Jashtë Orarit Mësimor (JOM), i cili synon të ofrojë kurse të specializuara për nxënës të ciklit të mesëm të ulët dhe të lartë. Kampi Veror për Fëmijët në Thumanë është një model i ri për mënyrën se si edukimi jashtëshkollor mund të ndërtohet mbi bazën e pasioneve dhe talenteve të fëmijëve duke i ndihmuar ata të rriten si individë të aftë dhe kreativë.

➤ Ekipet Sportive

Programi i Ekipëve Sportive ka si qëllim të promovojë jetën e shëndetshme sportive, të largojë të rinjtë nga zakonet jo të mira që sjellin pasivitet në jetën e tyre sociale, si dhe t’i ndihmojë ata që të shpenzojnë kohën pas orarit mësimor në mënyrë cilësore.

Gjatë edicionit të tretë 2024-2025 ka patur një pjesëmarrje më të gjerë me 10 647 nxënës dhe 423 trenerë, duke futur dhe ciklin U10 me pjesëmarrjen e 2123 fëmijëve. Janë pjesë e programit 291 shkolla në 12 qarqet e vendit. Të rinjtë e ekipeve sportive stërviten rregullisht 3 herë në javë me trajner. Për çdo individ, pjesëmarrës në ekipet sportive, janë kryer matjet antropometrike për të parë ecurinë shëndetësore të secilit prej tyre.

Të gjitha shkollat janë përzgjedhur duke plotësuar kushtin bazë të të paturit dy ambiente sportive, palestër të brendshme dhe të jashtme për kryerjen e stërvitjes si dhe përzgjedhje të trajnerëve të kualifikuar.

Ekipet për edicionin e tretë të programit kanë nisur stërvitjen sipas planit stërvitor miratuar nga federatat për të dyja disiplinat, volejboll dhe basketboll. Kampionati fillon në muajin mars dhe përfundon në maj ku do të zhvillohen me qindra ndeshje për të përcaktuar ekipet fituese në fazat finale si kampion vendi.

Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë periudhës raportuese lidhur me programin “Ekipet sportive” në shkolla gjithashtu ka ndërmarrë aktivitetet si më poshtë vijon:

- Trajnim me drejtues, mësues të edukimit fizik të IAP-ve tona ku zbatohet programi kombëtar “Ekipet sportive në shkolla”, në disiplinat e ndryshme sportive, si: volejboll, basketboll, futboll me qëllim njohjen dhe zbatimin e këtij programi që ka në fokus promovimin e jetës së shëndetshme sportive, largimin e të rinjve nga zakonet jo të mira që sjellin pasivitet në jetën e tyre sociale, si dhe t’i ndihmojë ata që të shpenzojnë kohën pas orarit mësimor në mënyrë cilësore;
- Zhvillimi i aktiviteteve/garave sportive në nivel shkolle, midis shkollave dhe në nivel qarku me qëllim nxitjen e të rinjve për pjesëmarrjen në këto aktivitete dhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë që ato kanë në sigurimin e një jetese të shëndetshme.
- “Shëndeti, sporti dhe mjedisi”, në kuadrin ligjor të politikave për mbrojtjen e shëndetit dhe të shtrirjes së edukimit shëndetësor në institucionet dhe kurrikulat e arsimit para universitar. Aktivitete në fushën e ndërgjegjësimit për ruajtjen e mjedisit. Fushata sensibilizuese mbi mbrojtjen e pyjeve, mbajtjen pastër të mjedisit, riciklimi.
- Kampionati i volejbollit për vajza/djemtë mes shkollave të qytetit me tematikë: “Të rinjtë e duan sportin”, me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm lokalë dhe sportistë të njohur të qytetit.
- Aktivitete ekstrakurrikulare të zhvilluara nga nxënësit gjimnazistë, vullnetarë, të talentuar në fusha dhe disiplina të ndryshme: art, sport, kulturë, me nxënës të shkollave 9-vjeçare me mbështetjen e ZVAP-ve dhe Qendrave Rinore;
- Shpërndarja e ndihmave për familjet në nevojë nga të rinjtë vullnetarë në bashkëpunim me Qendrën Lira (Berat). Konkurs me ese të nxënësve të shkollave të mesme, në bashkëpunim me UNICEF;
- Punë vullnetare: Vizitë në një qendër sociale në kuadër të ditës ndërkombëtare të të moshuarve. Qeveria e nxënësve shpërndau disa pako ushqimore në një qendër të moshuarish në qytetin e Elbasanit, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq dega Elbasan, me qëllim ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve me ndjenjën e respektit për të moshuarit;

- Plotësim i formularëve: Përzgjedhja e kurseve të arteve dhe zejeve nga ana e nxënësve dhe prindërve. Identifikimi i profesioneve dhe preferencave për të ardhmen. Aktivitete në kuadër të kurseve arteve dhe zeje.
- Zhvillimi i takimeve për organizimin e projekteve dhe trajnimeve edukative, me organizatat rinore për të promovuar njohuritë dhe aftësitë në fushat e edukimit global, qytetarisë globale, dhe paqëndrimit. Këto trajnime kanë patur në fokus temat e përfshira si, paqja në nivel lokal dhe global., solidariteti, dhe barazi gjinore;
- Organizimi i fushatave sensibilizuese dhe informuese për të rritur ndërgjegjësimin e të rinjve dhe komunitetit për rëndësinë e vlerave të shoqërisë gjithëpërfshirëse, tolerancës dhe barazisë gjinore;
- Krijimi i partneriteteve dhe rrjeteve të bashkëpunimit me organizata të tjera rinore, institucione akademike, dhe institucione të tjera për të përforcuar përpjekjet në fushën e edukimit global dhe të qytetarisë globale. Këto partneritete ndihmojnë në shkëmbimin e përvojave dhe burimeve për të përmbushur qëllimet e përbashkëta;

Gjatë periudhës Korrik-Dhjetor 2024, aktivitetet sportive në shkolla kanë vijuar me edicionin e tyre të tretë, duke synuar të promovojnë një stil jetese aktive tek të rinjtë dhe të forcojnë ndjenjën e sportivitetit në institucionet arsimore.

Në këtë edicion janë përfshirë 12 qarqe dhe një total prej 291 shkollash në të gjithë vendin, të cilat kanë kontribuar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e sportit. Në këto aktivitete janë angazhuar 826 ekipe, me një pjesëmarrje totale prej 10647 nxënësish, nga të cilët 5308 janë vajza dhe 5339 janë djem.

Në varësi të cikleve shkollore, numri i nxënësve të përfshirë ka qenë i shpërndarë si më poshtë: Në kategorinë U10 kanë marrë pjesë 1068 vajza dhe 1055 djem, ndërsa në ciklin 9-vjeçar janë përfshirë 2669 vajza dhe 2671 djem. Përsa i përket shkollave të mesme, pjesëmarrja ka qenë gjithashtu e lartë, me 1571 vajza dhe 1613 djem të angazhuar në aktivitetet sportive.

Në këtë edicion janë zhvilluar dy disiplina kryesore sportive, basketbolli dhe volejbolli, me një shpërndarje të ekipeve si më poshtë:

346 ekipe kanë konkuruar në basketboll, 480 ekipe kanë marrë pjesë në aktivitetet e volejbollit.

Organizimi i këtyre aktiviteteve ka kërkuar angazhim të madh të stafit mbështetës, duke përfshirë 50 koordinatorë, 423 trajnerë, 150 arbitra dhe 120 vullnetarë, të cilët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e garave dhe sigurimin e standarteve të duhura në zhvillimin e tyre.

Këto aktivitete janë zhvilluar në 57 bashki dhe kanë krijuar mundësi për nxënësit që të angazhohen në një mjedis konkurrues njëkohësisht duke nxitur bashkëpunimin, disiplinën dhe frymën sportive. Pjesëmarrja e lartë dhe shpërndarja e barabartë mes djemve dhe vajzave janë tregues pozitivë të rritjes së interesit për sportin në mjedisin shkollor, ndërsa përmirësimi i trajnimeve për stafin dhe investimet mbeten faktorë kyç në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj nisme.

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka organizuar trajnimet me drejtues, mësues të edukimit fizik të IAP-ve tona ku zbatohet programi kombëtar "Ekipet sportive në shkolla" në tri disiplinat sportive: volejboll, basketboll, futboll me qëllim njohjen dhe zbatimin e këtij programi, i cili ka në fokus promovimin jetës së shëndetshme sportive, largimin e të rinjve nga zakonet jo të mira që sjellin

pasivitete në jetën e tyre sociale, si dhe t'i ndihmojë ata që të shpenzojnë kohën pas orarit mësimor në mënyrë cilësore. Zhvillimi i aktiviteteve/garave sportive në nivel shkolle, midis shkollave dhe në nivel qarku me qëllim nxitjen e të rinjve për pjesëmarrjen në këto aktivitete dhe ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë që ato kanë në sigurimin e një jetese të shëndetshme. Është realizuar "School Mural Fest", për promovimin e nxësve të talentuar në pikturë, ku janë shpallur edhe fituesit për muralen e shkollës, janë zhvilluar olimpiada në lëndë të ndryshme, aktivitetet e KOKSH në kuadër të projektit "Ekipet Sportive në Shkollë".

1. 200 shkolla, të përfshira në nismën "Shkolla Qendër Komunitare" (SHQK), vazhdojnë të ndjekin aktivitetet "Jashtë Orarit Mësimor" (JOM), në zbatim të Programit Kombëtar "Art, Zeje, Sport".
2. Janë organizuar Kampionati i volejbollit për vajza/djemë mes shkollave me tematikë: "Të rinjtë e duan sportin", me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm lokalë dhe sportistë të njohur të qytetit. Kampionate edhe në disiplina të ndryshme: kampionati i shahut, art, sport, kulturë, me nxënës të shkollave 9-vjeçare me mbështetjen e ZVAP dhe Qendrave Rinore, Bashkive. Konkurs me ese të nxënësve të shkollave të mesme, në bashkëpunim me UNICEF, Bashkia, Qendra Rinore. Zhvillimi i projekteve që kombinojnë artin, kulturën dhe sportet për të ndihmuar në integrimin dhe zhvillimin e të rinjve. Në bashkëpunim me organizata rinore janë organizuar aktivitete artistike dhe kulturore në nivel lokal. Aktivitet muziko-letrar me rastin e 26 Shtatorit, Ditës së Gjuhëve të Huaja. Aktivitet festiv në shkollë me rastin e Festave të Nëntorit.

➤ Fushat e përparësisë së Thirrjes nr. 3 dhe 4 të AKR-së

Thirrjet III dhe IV të AKR-së, nëpërmjet përcaktimit të fushave të përparësisë, kanë synuar adresimin e prioriteteve të Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe konkretisht, e lidhur me këtë masë është, përcaktimi i një prej tre fushave të përparësisë "*Mbështetja mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore të të rinjve*".

Nga Organizatat rinore dhe Organizatat për të rinjtë nëpërmjet mbështetjes të projekteve rinore të Thirrjes Publike Nr. III, zbatimi i shumicës së projekteve të së cilës ka përfunduar gjatë periudhës raportuese, në raport me prioritetin "*Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve*" janë impaktuar 3601 të rinj në total. Lidhur me Thirrjen Publike Nr. IV e cila është ende në fazat e para të zbatimit, në raport me fushën e përparësisë numër 3 (*Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve*), pritet të impaktohen në mënyrë direkte rreth 4020 të rinj.

➤ Aktivitete të tjera

RINCAMP

Një nga aktivitetet më dinamike dhe interaktive ishte realizimi i Shkollës Verore "RinCamp", në përmbushjen e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029. Qëllimi i këtij aktiviteti është të ndihmojë të rinjtë të zgjerojnë horizontet e tyre, të zhvillojnë aftësi të reja, si dhe të socializohen me njëri-tjetrin.

“RinCamp 2024” solli së bashku rreth 100 të rinj nga 22 qytete të ndryshme të Shqipërisë, në një eksperiencë katërditore të mbushur me trajnime, diskutime dhe aktivitete. Gjatë kampit pjesëmarrësit patën mundësinë të ndjekin 11 sesione trajnimi dhe panele diskutimi mbi tema të rëndësishme si: politikat vendore, bujqësia dhe teknologjia, kreativiteti dhe inovacioni, edukimi financiar dhe mundësitë e reja për të rinjtë në vend.

Përveç komponentit edukativ, kampi ofroi edhe një dimension argëtues dhe sportiv, me organizimin e 10 aktiviteteve sportive, artistike dhe sociale që synonin të forconin frymën e bashkëpunimit dhe kreativitetit mes të rinjve. Në përfundim, të rinjtë u vlerësuan për kontributin e tyre, duke dhënë ide të reja dhe angazhim maksimal për të ardhmen.

Realizimi financiar

Nga sa është raportuar dhe përshkruhet më sipër, arrihet përfundimi që janë realizuar më shumë aktivitete dhe janë përfshirë më shumë aktorë se sa ata që janë parashikuar. mund të thuhet se masa ka mbi realizim

Realizimi i fondeve totale të planifikuara është 100%.

Realizimi Masa 2.2.3 i SKR për vitin 2024



Këtu është përfshirë programi i mbështetjes së zhvillimit të sporteve i zbatuar nga KOKSH. Si pagat dhe sigurimet shoqërore ashtu edhe shërbime, mallra dhe kontigjenca kanë normë realizimi 100%. Për këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar.**

Përmbledhje për këtë objektivin specifik 2.2,

Realizimi financiar

3 masat e këtij objektivi specifik janë realizuar.


Statusi i realizimit të masave të Objektivit 2.2



Objektivi Specifik 2.3: Të rinjtë, në të gjitha kushtet dhe situatat, përfaqësojnë një fokus të veçantë në aftësim, punësim, sipërmarrje dhe politika punësimi që ofrojnë një shumëllojshmëri të modaliteteve specifike rinore për rritjen e mbështetjes për ta në tranzicionin nga sistemi arsimor drejt tregut të punës dhe moshës madhore.

Edhe në vitin 2024 vazhdon realizimi i 2 masave (nga 4 masa të parashikuara, dy prej tyre fillojnë zbatimin në vitin 2027 e për rrjedhojë nuk janë matur) të këtij objekti specifik. Realizimi i fondeve totale është 74%, i pagave dhe sigurimeve shoqërore 29% dhe niveli i realizimit për mallra, shërbime dhe kontigjenca është 77%.

Realizimi Objektivi 2.3 i SKR për vitin 2024



Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

Masa 2.3.1 Nxiten punët e denja dhe të përshtatshme për të rejtat dhe të rinjtë përmes politikave të punësimit, miqësore dhe të orientuara nga të rinjtë, që kontribuojnë në krijimin e vendeve të punës për të rejtat dhe të rinjtë dhe që sigurojnë qasje novative dhe digjitale në informacionet mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e punësimit.


Që prej implementimit të programit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është në kontakt me AKPA për të ndjekur ecurinë e regjistrimeve në program, ecurinë e programit në tërësi si dhe të kurseve specifike, për të koordinuar promovimin e programit në vijimësi. Gjatë muajit shtator-tetor 2024, janë regjistruar edhe 200 të rinj të tjerë në këtë program dhe gjatë vitit 2025, do të rihapet skema me mbështetje nga buxheti i shtetit.

Gjatë periudhës së raportimit është zhvilluar Thirrja e IX e PKPP-së, e shpallur më datë 8 korrik 2024 me 1,275 pozicione vakante prej të cilave 775 në administratën shtetërore, 427 në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe 73 në institucionet e pavarura. Thirrja e IX e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës është një vazhdimësi e thirrjeve të mëparshme. Me datë 8 Dhjetor 2024, në kuadër të Ditës Kombëtare të Rinisë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, organizoi eventin “Under 30 (<30)”. Një aktivitet që synon fuqizimin dhe motivimin e të rinjve shqiptarë përmes informacionit dhe mundësive konkrete për angazhim. Ky ishte audicioni i dytë i këtij eventi dhe solli 93 mundësi të reja për të rinjtë, duke i orientuar ata drejt punësimit, trajnimeve, edukimit dhe sipërmarrjes. Përmes stendave informuese, prezantimeve dhe diskutimeve, të rinjtë patën mundësinë të njihen më afër me programet mbështetëse të institucioneve, organizatave dhe bizneseve që operojnë në fusha të ndryshme.

Realizimi financiar

Për këtë masë, për 2024 janë raportuar aktivitetet më lart.

Realizimi Masa 2.3.1 i SKR për vitin 2024



Kjo evidentohet edhe në nivelin e realizimit të shpenzimeve totale, atyre për paga dhe sigurime shoqërore si dhe shpenzimeve për mallra, shërbime kontigjenca me respektivisht 55%, 29% dhe 58%. Për këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale. Mosrealizimi vjen si pasojë e mosngritjes së portalit Të Rinjtë për Të Rinjtë dhe faktit që nuk është përgatitur Dokument komunikimi për shpërndarjen vertikale dhe horizontale të informacioneve për punësimin.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë pjesërisht e realizuar**.

Masa 2.3.4 Fuqizohen qasjet e integruara për të mbështetur të rinjtë që rrezikojnë lënien e parakohshme të shkollimit dhe pa mbështetje për shkollim në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit (Garancia Rinore dhe UNICEF).

Nxitja e punësimit të të rinjve është një nga prioritetet e Qeverisë shqiptare dhe Garancia Rinore është një prej programeve për të cilin ka filluar hartimin gjatë vitit 2023.

Në bazë të rekomandimeve të ardhura nga Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor në vitin 2020 për prezantimin e Skemës së Garancisë Rinore në Shqipëri me qëllim adresimin e inaktivitetit të të rinjve në Shqipëri. Në vijim të këtyre rekomandimeve, në vitin 2021-2022 u hartua Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024 në Shqipëri. Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore në Shqipëri u dizajnuar nga Grupi Ndërinstitucional dhe me mbështetjen e Asistencës Teknike për Mbështetjen e Reformës në Politikat e Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional (SREPVET) dhe më pas nga Asistenca Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Reformave në Fushat e Përfshirjes Sociale në Shqipëri (EU4SI).

Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore është në linjë të plotë me Pilarin Evropian për të Drejtat Sociale, si dhe Inkorporon rekomandimet e paraqitura nga Bashkimi Evropian.

Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore është i integruar në dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive të miratuar me Vendim nr.173, datë 24.3.2023 të Këshillit të Ministrave. Ky plan përcakton fazat dhe kontributin e institucioneve të ndryshme, për zhvillimin dhe koordinimin e politikave arsimore, të punësimit dhe ato sociale për të rinjtë, duke synuar heqjen e barrierave dhe krijimin e mundësive që të rinjtë të hyjnë në tregun e punës dhe të kenë një zhvillim të suksesshëm profesional.

Në zbatim të Planit të Garancisë Rinore dhe duke synuar diversifikimin e ofertave dedikuar target grupit të synuar, përkatësisht: të rinjtë 15-29 të cilët nuk janë të punësuar, nuk janë duke ndjekur një trajnim apo formim profesional dhe nuk janë duke ndjekur një cikël arsimor, u miratua një Program i ri Nxitjeje të Punësimit “të Nxënimit në Vendin e Punës, sipas Skemës së Garancisë Rinore”. Programi i ri synon të zbatohet sipas skemës të garancisë rinore, realizohet me anë të kurseve 3 deri në 6-mujore të formimit profesional nëpërmjet të nxënimit në vendin e punës dhe më pas punësimit për 6 (gjashtë) muaj të tjerë. Programi do të zbatohet për here të pare në 3 rajonet pilot të Garancisë Rinore.

Lancimi i Fazës Pilot

Me qëllim nisjen e fazës pilot, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë realizuan planin e zbatimit të Fazës Pilot në tre bashki; përkatësisht në bashkinë Tiranë, Vlorë dhe Shkodër. Sipas rekomandimeve të Bashkimit Evropian, për përzgjedhjen e rajoneve për pilotimin e Garancisë Rinore, indikatorët që janë analizuar dhe konsideruar një set indikatorësh, si: Hartëzimi i të rinjve, Flukset e të rinjve; ekonomia rajonale; mbulimi me institucione të Arsimit dhe Formimit Profesional; eksperiencia në lëvrimin e masave aktive të tregut të punës, etj.

Plani i Zbatimi të Fazës Pilot të Garancisë Rinore në Shqipëri u nda dhe dakordësua nga Koordinatori Kombëtar në Grupin Teknik të Skemës së Garancisë Rinore në muajin Tetor 2023 me qëllim lancimin dhe nisjen e zbatimit të Skemës. Kështu me datë 27 Tetor 2024, u lancua Faza Pilot e Garancisë Rinore

me prezencën e përfaqësuesve të lartë të Delegacionit European në Shqipëri, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Shtetit të Fëmijëve dhe Rinisë, si dhe partnerëve të tjerë si ILO, EU4SI, UNICEF, etc.

Me qëllim zbatimin në bashkitë Pilot të Garancisë Rinore, Agjencia Kombëtare e Punësimit u gjatë vitit 2024 ka realizuar:

- Në këtë kuadër është bërë dhe dizejnim i shërbimit për këtë program në e-Albania për krijimin e shërbimit online.
- Në fillim të vitit 2024, AKPA, në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe DG Near u realizua takim teknik në Zyrën e Punës, Shkodër.
- Gjithashtu u zhvilluan sesione informative online për të inkurajuar punëdhënësit vendas që të ofrojnë oferta cilësore pune.
- Gjatë zbatimit të Fazës Pilot të Garancisë Rinore, në partneritet me Delegacionin European në Shqipëri, ETF dhe partnerë të projekteve janë zhilluar 4 takime rajonale me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Partnerët Socialë, përkatësisht në:
 - *18 Prill 2024, takim me aktorët e Ekosistemit në Rajonin e Vlorës,*
 - *19 Prill 2024, takim me aktorët e Ekosistemit në Rajonin e Tiranës,*
 - *26 Qershor 2024, takim me aktorët e Ekosistemit në Rajonin e Shkodrës,*
 - *7 Nëntor 2024, takim me aktorët e Ekosistemit dhe të Qeverisjes së Garancisë Rinore.*
- Pas përfundimit të fazës fillestare pilot, e cila përfshinte 200 NEET, më datë 3 Qershor 2024, Grupi Teknik i Punës i Garancisë Rinore vlerësoi progresin dhe vendosi të zgjasë fazën pilot për vitin buxhetor 2024.
- Me mbështetjen e projektit Boost Employment, AKPA realizoi ciklin e trajnimeve të stafit dedikuar shërbimit me punëkërkuuesin, em një fokus të veçantë në stafin në nivel rajoni të Garancisë Rinore mbi ofrimin e Këshillimit për Punësim dhe Sipërmarrje me fokus të rinjtë target i Garancisë Rinore të realizuar në muajin Nëntor 2024.
- Në kuadër të diversifikimit të instrumenteve dedikuar këshillimit ndaj të rinjve, në bashkëpunim me projektin Boost Employment, AKPA ka interguar në portalin puna.gov.al, Testin “Eksploro Vetën”. “Eksploro Vetën” është një test i thjeshtë dhe praktik, i cili ofron mundësinë për të zbuluar dhe kuptuar më mirë aftësitë, prirjet dhe preferencat tuaja profesionale. Përmes pyetjeve të strukturuar dhe 30 aktiviteteve të përzgjedhura profesionale, udhëzon drejt një karriere që jo vetëm përputhet me aftësitë, por edhe me aspiratat e të rinjve.
- Gjatë vitit 2024, AKPA, me mbështetjen e EU4Youth, ka vijuar punën për ngritjen modelit të Kontaktimit (outreach), i cili bazohet në 3 ndërhyrje kryesore:

1. **Ndërhyrje e hershme**, duke u bazuar në paralajmërimin e hershëm në sistemin arsimor.
 2. **Identifikimi dhe aktivizimi**, e cila do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me Organizatat e Shoqërisë Civile në territor, si dhe
 3. **Këshillimi dhe parapërgatitje**. Në këtë fazë fokusi është sigurimi i shërbimeve mbështetëse ndaj të rinjve përpara se ata të rregjistrohen në Skemën e Garancisë Rinore.
- Në kuadër të fazës së Kontaktimit, është ngritur modeli i Partneritetit Lokal, i cili do të shërbejë si një organizëm proaktiv në nivel rajonal për identifikimin, referimin dhe aktivizimin e të rinjve. Modeli i miratuar në Grupin Teknik të Punës të Garancisë Rinore është si më poshtë vijon:
 - Së fundmi, në kuadër rritjes së promovimit të Skemës së Garancisë Rinore, është realizuar krijimi dhe popullimi i Portalit të Garancisë Rinore me informacion lidhur me shërbimet dhe ofertat sipas kësaj skeme, si dhe janë publikuar në kanalet zyrtare të komunikimit me publikun (media sociale): 29 publikime të rasteve të suksesit të zbatimit të Garancisë Rinore dhe 4 video promovuese për rritjen e ndërgjegjësimit të pjesëmarrjes në skemë.

Përgjatë fazës pilot të Garancisë Rinore, 21 nëntor 2023- 30 Dhjetor 2024, janë rregjistruar në Skemën e Garancisë Rinore 560 të rinj 15-29 NEET.

Në kuadër të zbatimit të Skemës së Garancisë Rinore, me mbështetjen e EU4Youth, gjatë vitit 2024 ka nisur komponenti i zbatimi të Modelit mbi Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm (EWS) në 12 ofrues të AFP-së në tre bashkitë pilote për monitorimin dhe parandalimin e braktisjes shkollore, duke përfshirë elemente të vlerësimit të nevojave dhe mekanizmit të reagimit – mësimin socio-emocional për të rinjtë në rrezik, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë së tyre. Përmes këtij komponenti, synohet të ngrihen gjithashtu programe mbështetëse për nxënësit vulnerabël me rezultate të ulëta, si dhe të krijohet një bashkëpunim i qëndrueshëm midis shkollave të mesme dhe zyrave të punësimit.

TREGUESIT/INDIKATORET

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2024 rezultojnë rreth 16,707 punëkërkues të papunë të grupmoshës 15-29 vjeç të cilët janë përfshirë në programet aktive të tregut të punës.

Pu.pa 15-29 vjeç pjesëmarrës në Programet Aktive të Tregut të Punës

	12 Mujori 2024
Punësim (Nëpërmjet Zyrave të Punës)	10,271
Nxitje Punësimi (PNP)	1,039
Programi i Kodimit	47
Formim Profesional	5,350
Total PATP	16,707

Realizimi financiar

Për këtë masë, aktivitetet që do realizoheshin ishin bazuar tek vënia në zbatim e Garancisë Rinore. Por, siç shpjegohet edhe më sipër, Garancia Rinore filloi të zbatohet vetëm në fund të 2023. Fondet totale janë planifikuar vetëm për zërin Mallra, shërbime dhe kontigjenca dhe norma e realizimit është 100%. Ky nivel realizimi është arritur pasi është realizuar mbështetja e aktiviteteve të organizatave rinore në ndihmë të të rinjve në rrezik braktisje shkolle


Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Përmbledhje për objektivin specifik 2.3.

Realizimi financiar

Realizimi i 2 masave në bazë të analizës financiare do të detajohet në vazhdim dhe grafiku më poshtë jep raportin e masave të realizuara me ato pjesërisht të realizuara.

Statusi i realizimit të masave të Objektivit 2.3



QËLLIMI I POLITIKËS III

Mirëqenia dhe Përfshirja

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

Ky qëllim i politikës ka të parashikuar 3 Objektiva Specifike dhe konkretisht Objektivi Specifik 3.1, me 7 masa, Objektivi Specifik 3.2, me 5 masa dhe Objektivi Specifik 3.3, me 3 masa, në total 15 masa.

Masa 3.1.4 është planifikuar të fillojë në 2025 dhe nuk përfshihet në monitorim financiar, ndërkohë që masa 3.3.3 që lidhet me mbështetjen e të rinjve për strehim është planifikuar në 2027, por vendimi i qeverisë ka bërë që të mbështeten çiftet e reja që në vitin 2024.

Ky qëllim i politikës zbërthehet në masa që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e të rinjve, duke përfshirë dhe hapësirën digjitale, gjithëpërfshirjen, tolerancën dhe të drejtat e njeriut dhe të pakicave, mirëqenien dhe shërbimet miqësore, shëndetin mendor dhe psikologjik, shëndetin riprodhues, programet e strehimit dhe hapësirave publike për të rinjtë.


Përmbledhje për Qëllimin e Politikës 3

Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik.

Realizimi financiar


Realizimi i 14 masave në bazë të analizës financiare për të tre objektivat e qëllimit të tretë është si në grafikun e mëposhtëm

Statusi i realizimit të masave të Qëllimit III




Për këtë qëllim të politikës nuk ka masa të parealizuara. Ndërkohë nga analiza e fondeve rezulton se norma e realizimit e fondeve totale është 72%.

Realizimi Qëllimi 3 i SKR për vitin 2024



Pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shërbime dhe mallra dhe kontigjenca kanë normat e realizimit respektivisht 47% dhe 73%. Për këtë qëllim nuk ka planifikim të shpenzimeve kapitale.

Realizimi Qëllimi III dhe tre objektivat



Për disa nga masat e këtij qëllimi ka përfshirje të donatorëve që nuk ishin planifikuar më përpara. Kjo ka bërë që të rritet mbështetja e organizatave dhe të reduktohet hendeku financiar.


Më poshtë paraqitet një panoramë e detajuar mbi hapat konkretë të ndërmarrë gjatë periudhës raportuese, me qëllim realizimin e masave të parashikuara për secilin objektiv specifik. Gjithashtu

jepet informacioni në lidhje me shkallën e realizimit nga ana financiare për secilin nga objektivat dhe masat përkatëse.

Objektivi specifik 3.1. Mbrojtja mbështetja dhe siguria e të rejave dhe të rinjve, veçanërisht e atyre në situatë rreziku, në vendin ku jetojnë dhe hapësirën digjitale.

Edhe në vitin 2024 ka vazhduar realizimi i 6 nga 7 masat e planifikuara. Realizimi i fondeve totale është 78%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 3%. Ndërsa për mallra, shërbime dhe kontigjenca norma e realizimit është 78%.

Realizimi Objektivi 3.1 i SKR për vitin 2024



Për masat e këtij objektivi nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

Masa 3.1.1 Bashkërendohet zbatimi i strategjive dhe programeve Kombëtare të Mbrojtjes dhe Sigurisë me një fokus të veçantë tek prezenca virtuale e të rinjve online, krijimi i hapësirave të sigurta, krimi kibernetik dhe bullizmi online (digjital).

Kjo masë konvergjon me qëllimet dhe objektivat specifike të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025, sa i përket internetit të sigurt dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve online, ku në kuadër të kësaj Strategjie dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), gjatë periudhës raportuese, ka hartuar materiale trajnimi dhe ka organizuar aktivitete, me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e kapaciteteve sa i përket sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijëve në internet, për fëmijët, prindërit, mësuesit, punonjësin social, përfaqësues të organizatave joqeveritare etj.

Në zbatim të angazhimeve strategjike të përcaktuara në Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, si dhe në Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025 dhe ligjin 18/2017

“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në shkurt 2024, ka nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) me qëllim ndërgjegjësimin për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijës në mjedisin digjital. Bazuar në këtë Marrëveshje ASHDMF ne bashkepunim me AKSK për periudhën shkurt - dhjetor 2024 ka realizuar 4 workshopë për profesionistë dhe prindër ku janë trajnuar e ndërgjegjësuar 200 profesioniste (PMF, mësues, punonjës psikosociale në shkolla) dhe 43 prindër në Tiranë, Kukës, Durrës, Cërrik. Janë organizuar 30 aktivitete ndërgjegjëse në shkollat 9-vjecare dhe të mesme. Konkretisht janë realizuar 19 takime në shkollat 9 vjecare dhe të mesme në bashkinë Tiranë dhe 11 takime ndërgjegjëse janë zhvilluar me fëmijë të shkollave në bashkitë: Durrës, Kukës, Gramsh, Cërrik, Lezhë, Kucovë, Fier, Shkoder, Gjirokastrë, Permet, Berat. Në këto takime janë ndërgjegjësuar 1277 fëmijë.

Gjatë muajit Shtator 2024, AKSK në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ka rinisur fushatën ndërgjegjëse për mbrojtjen online të fëmijëve dhe të rinjve. Në shkollën "Ahmet Zogu" në Kamëz u mbajt takimi i parë, pjesë e një nisme më të gjerë kombëtare e cila, që nga janari, ka përfshirë rreth 600 nxënës nga 13 shkolla në vend. Këto aktivitete do të vazhdojnë gjatë gjithë vitit shkollor për të ndihmuar brezin e ri të përdorë internetin në mënyrë të sigurt.¹³

Në vazhdim të fushatës për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi higjienën kibernetike dhe mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) organizoi një seri trajnimesh me temën “Higjiena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë”. Këto trajnime u realizuan nga AKSK gjatë muajit shtator 2024 në qytetin e Shkodrës dhe Korçës me pjesëmarrjen e mbi 1,500 personave.¹⁴

AKSK me bashkëpunim me CRDF Global dhe me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit, organizoi eventin Cyber Fortress më datë 23 dhe 24 korrik 2024. Ky aktivitet dy ditor bashkoi ekspertë të sigurisë kibernetike nga Shqipëria dhe Kosova me një stimulim të incidenteve kibernetike, duke përdorur skenarë të ndryshëm dhe sfidues. Pjesëmarrësit të ndarë në ekipe konkuruan për të zgjidhur skenarët e incidenteve kibernetike, duke u fokusuar në krijimin e zgjidhjeve, në vlerësimin dhe diskutimin e tyre për të arritur rezultatet më të mira.¹⁵

Në kuadër të hartimit të strategjisë së re të sigurisë kibernetike 2025-2030, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, gjatë muajit Nëntor 2024 ftoi të gjithë aktorët që do të përfshihen në planin e veprimtimit për forcimin e kësaj strategjie. Qëllimi kryesor është përmirësimi i ekosistemit kibernetik,

¹³ <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/BULETIN-MUJOR-SHTATOR-2024.pdf>

¹⁴ <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/buletin-mujor-shtator-2024.pdf>

¹⁵ <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Buletini-Mujor.pdf>

duke sjellë një qasje të re për mbrojtjen e infrastrukturave kritike, sigurimin e qytetarëve dhe rritjen e rolit të Shqipërisë në rajon dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.¹⁶

Në kuadër të programit “Open Days”, Agjencia për Media dhe Informim mundësoi një vizitë për të rinjtë e Qendrës Rinore Berat dhe aktivistët e organizatës “New Bridges”, në Qendrën e Inovacionit të Sgurisë dhe Mbrojtjes. Ekspertët e fushës informuan të rinjtë mbi rolin e teknologjive të reja në siguri, sigurinë kibernetike dhe sfidat e botës dixhitale.

ASCAP ka hartuar "Manualin për sigurinë në internet", një material i cili ofron një paketë udhëzimesh dhe këshillash lidhur me promovimin e përdorimit të internetit në mënyrë të sigurt dhe efektive nga ana e nxënësve dhe mësuesve. Ky material është publikuar në faqen zyrtare të ASCAP, si dhe është ndarë me mësues dhe drejtues rrjetesh.¹⁷

Aktivitetet/veprimtari, fushata ndërgjegjëse, të zhvilluara me nxënësit e arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë, prindër, mësues, aktorë lokalë, përfaqësues të komunitetit në kuadër të zbatimit të programeve për sigurinë në internet nga punonjësit e shërbimit psiko-social në shkollë, mësues të arsimit të mesëm të ulët dhe atij të lartë, punonjës të policisë vendore dhe përfaqësues të NJMF-së, Bashkisë.

Në kuadër të punës edukative në institucione, dhe planit të veprimtarive kundër ekstremizmit të dhunshëm, psikologët e shkollave, në bashkëpunim me mësuesin koordinator të planit KEDH në shkollë kanë organizuar veprimtari sensibilizuese mbi çështjen e sigurisë, me nxënës dhe mësues me tematikë: “Fëmijët dhe ekstremizmi në internet”.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar takime informuese/ndërgjegjëse nga SHPS me tematika:

- Fëmijë të sigurt në internet. Si të lundrosh i sigurt në internet?
- Fëmijë të sigurt në internet dhe mbrojtja nga dhuna virtuale?

Takime me qeverinë e nxënësve me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm shkollorë dhe lokalë me tematikë: “Problemet që hasen në klasë dhe adresimi i tyre”, Marrëdhëniet mësues-nxënës dhe përhapja e fenomenit të bullizmit”, “Agresiviteti, baza shoqërore dhe gjenetike e tij”, “Zhvillimi emocional në fëmijëri”, “Normat sociale dhe sjelljet antisociale ” etj. Organizimi i sesioneve informuese mbi programet për sigurinë në internet për të rinjtë, prindërit dhe ata që punojnë me të rinjtë në arsimi formal dhe joformal: Pyetësorë për bullizmin kibernetik me nxënësit realizuar nga SHPS në bashkëpunim me mësuesin e TIK-ut. Gjithashtu janë realizuar pyetësorë me nxënës për të matur kohën që shpenzojnë nxënësit në rrjete sociale. Gjatë takimeve informuese për lundrimin e sigurt në internet janë shpërndarë fletëpalosje për nxënës dhe prindër. Shërbimi psiko-social ndjek një

¹⁶://efaidnbmnnnibpcajpcgclclefindmkaj/https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2024/12/Buletini-Mujor-1.pdf

¹⁷://efaidnbmnnnibpcajpcgclclefindmkaj/https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2023/12/Siguria-ne-internet-manuali.pdf


plan vjetor me aktivitete, seminare informuese dhe ndërgjegjësuere për sigurinë në internet me të gjitha grupmoshat e përfshira. Në fokus janë adoleshentët dhe rrjetet sociale, komunikimi me prindër. Ministria e Arsimit dhe Sportit, në kuadër të kësaj mase dhe në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), kanë krijuar një faqe të posaçme për raportimin e përmbajtjeve të paligjshme gjatë shfletimit në internet¹⁸. Ky shërbim synon të ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë të raportojnë lidhje të paligjshme/të dëmshme, që hasen gjatë shfletimit në internet. Raportimet trajtohen me konfidencialitet të plotë nga autoritetet përgjegjëse për të ndërmarrë veprimet e duhura, si dhe për të marrë masa të menjëhershme ndaj këtyre përmbajtjeve.

Në faqen zyrtare të MAS-it, dhe institucioneve vartëse të saj, që lidhen me portalin online www.cesk.gov.al të AKCESK-ut, është vënë në funksion shërbimi “Raportoni përmbajtje të paligjshme”, për bllokimin e aksesit në faqet e internetit me përmbajtje të paligjshme.

Realizimi financiar

Për këtë masë ka një realizim të mirë të zërave të kostos. Kjo pasi në aktivitete janë përfshirë më shumë punonjës nga institucione të ndryshme shtetërore. I vetmi aktivitet që nuk është realizuar është ai i përdorimit të portalit Të Trinjtë për Të Rinjtë. Ministria e Arsimit dhe Sportit, në kuadër të kësaj mase dhe në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), kanë krijuar një faqe të posaçme për raportimin e përmbajtjeve të paligjshme gjatë shfletimit në internet. Gjithashtu nuk është bërë aplikacioni për bullizmin.

Realizimi Masa 3.1.1 i SKR për vitin 2024



Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është 94%. Përsa i përket zërave specifikë pagat dhe sigurimet shoqërore kanë një realizim prej 100% dhe

¹⁸ <https://cesk.gov.al/raporto/>

shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 94%. Në këtë masë nuk janë planifikuar shpenzime kapitale.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 3.1.2 Fuqizohen programet që trajtojnë çështjet e rreziqet e sigurisë, me të cilat përballen të rejtat dhe të rinjtë e trafikuar, rreziqet e formave të ndryshme të krimit dhe, parandalimi dhe luftimi i dhunës seksuale me bazë gjinore dhe dhunës nga partneri ndaj grave të reja dhe parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore/të rinjve.

Në kuadër të Strategjisë së Sigurisë në Komunitet, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët është institucion kontribuues në Planin e Veprimit 2024-2026 të kësaj Strategjie, me në krye Ministrinë e Brendshme.

Gjatë vitit 2024 është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 678 datë 30.10.2024 “Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet”, Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet funksionon si organ kolegjal i cili kryesohet nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe ka në përbërje përfaqësues edhe nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Mbledhjet e këtij Këshilli pritet të fillojnë gjatë muajit janar 2025.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet janë, si më poshtë vijon:

- a) shqyrton përmes raporteve problematikat e identifikuara nga këshillat vendorë të sigurisë publike, me qëllim zgjidhjen e tyre pranë institucioneve përkatëse shtetërore qendrore;
- b) kërkon raportim për realizimin e planit vjetor të punës nga këshillat vendorë të sigurisë publike;
- c) relaton nëpërmjet raporteve dhe analizave te ministri i Brendshëm nevojën për hartimin e politikave të caktuara në fushën e sigurisë publike;
- ç) orienton Këshillin Vendor të Sigurisë Publike për aplikimin dhe përfshirjen e praktikave më të mira në trajtimin e çështjeve të sigurisë në komunitet;
- d) rekomandon Këshillin Vendor të Sigurisë Publike për zbatimin, në mënyrë të njëjtë, të politikave kombëtare në fushën e sigurisë.

Realizimi financiar

Për këtë masë nuk ka raportim të aktiviteteve të realizuara dhe është e vështirë të bëhet analiza e realizimit financiar.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e paraportuar**

Masa 3.1.3. Fuqizohen programet që u mundësojnë të rinjve të përfshirë në grupe të dhunshme ose të radikalizuara të braktisin dhunën duke propozuar të ashtuquajturat "strategjitë e daljes".

Strategjia Ndërsektorale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Plani i Veprimit 2023-2025 është miratuar me VKM Nr. 81, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit 2023-2025” dhe Planeve të Veprimit 2023-2025, e cila parashikon përfshirjen e aktorëve kryesorë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, duke promovuar vlerat demokratike dhe adresimin e shqetësimeve në nivel lokal që mund të nxisin radikalizimin.

Gjatë muajit nëntor 2024, Qendra Kombëtare Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm udhëhoqi sesione të rëndësishme informuese në Shkodër dhe Kukës duke punuar ngushtë me oficerët e policimit të komunitetit dhe policisë kufitare. Këto sesione, pjesë e e ndërgjegjësimit dhe informimit, u zhvilluan në partneritet me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe synuan forcimin e kapaciteteve të strukturave policore vendore në identifikimin e hershëm dhe përgjigjen ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.

Në Shkodër, oficerët u pajisen me informacione dhe njohuri të vlefshme për njohjen dhe referimin e shenjave të hershme të radikalizimit, duke siguruar aftësitë për të kontribuar në një komunitet më të sigurt dhe më të qëndrueshëm. Në Kukës, fokusi ishte në fuqizimin e oficerëve me strategji praktike për të ndërtuar një mjedis më të qëndrueshëm kundër kërcënimeve të mundshme.¹⁹

Në kuadër të forcimit të Sigurisë së Komunitetit në Korçë kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, më datë 19 nëntor 2024, Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) koordinoi sëbashku me Policinë e Shtetit dhe mori pjesë në një sesion të rëndësishëm informues në Korçë, duke punuar ngushtë me oficerët e policimit të komunitetit, policisë kufitare dhe oficerë të patrullës së përgjithshme në DVP Korçë.²⁰

Gjatë muajit nëntor 2024, QKEDH, koordinoi dhe mori pjesë në tre mbledhje të Komiteteve Rajonale të Parandalimit të Radikalizimit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Qarkun Korçë, Berat dhe Kukës me mbështetjen e Prefektëve. Këto Komitete Rajonale kanë përgatitur masa për fluksin e shtuar të lëvizjes së individëve nga vende të ndryshme, të gjitha institucionet përkatëse do kenë një angazhim dhe vigjilencë të shtuar për ta kryer sa më mirë detyrën dhe për të ofruar siguri maksimale për turistët dhe banorët e qarkut.

Gjatë muajit dhjetor 2024 QKEDH mori pjesë në një sesion trajnimi katërditor të titulluar “Shërbime të integruara dhe të qëndrueshme për profesionistët që punojnë me familjet që kthehen nga zonat e

¹⁹ Për më shumë informacion klikoni në linkun: <https://cve.gov.al/forcimi-i-sigurise-se-komunitetit-ne-shkoder-dhe-kukes-kunder-ekstremizmit-te-dhunshem/>

²⁰ Për më shumë informacion klikoni në linkun: <https://cve.gov.al/forcimi-i-sigurise-se-komunitetit-ne-korce-kunder-ekstremizmit-te-dhunshem/>

luftës”. Organizuar nga Terre des hommes në kuadër të projektit “Parandalimi dhe riintegrimi i sigurt: Qasje holistike dhe fleksibilitet ndaj ekstremizmit të dhunshëm”, financuar nga GCERF. Trajnimi mbledhi së bashku rreth 20 profesionistë përfshirë psikologë, menaxherë rastesh, specialistë dhe përfaqësues nga QKEDH, PMF, qendrat sociale dhe policia. Nisma ka pasur për qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale, përmirësimin e komunikimit ndërinstytucional dhe rritjen e mbështetjes për familjet e prekura nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm.

Trajnimit theksoi rëndësinë e konfidencialitetit, bashkëpunimit dhe ndërhyrjeve të synuara për të mbështetur riintegrimin e sigurt të familjeve të kthyer. Ai u fokusua gjithashtu në rritjen e ndërgjegjësisë për nevojën për përpjekje të koordinuara për të ndërtuar qëndrueshmëri ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe për të mbrojtur shoqërinë shqiptare. Nëpërmjet kësaj nisme, QKEDH rikonfirmon angazhimin e saj për të nxitur zgjidhje të qëndrueshme për rehabilitim dhe riintegrim, duke siguruar një shoqëri më të sigurt dhe të bashkuar.²¹

Më 26 dhjetor 2024, Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) koordinoi dy seanca trajnimit për Komitetet Rajonale për Ekstremizmin e Dhunshëm të Qarqeve Elbasan dhe Fier, me temë “Adresimi i rasteve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit fetar në komunitet, si dhe përgjigja ndaj nevojave të të kthyerve nga zonat e konfliktit.”

Trajnimet, të zhvilluara në bashkëpunim me Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza nëpërmjet mbështetjes së financuar nga Fondi Global i Angazhimit dhe Qëndrueshmërisë në Komunitet synuan rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Sekretariateve Teknike të Komiteteve Rajonale për të identifikuar rastet dhe për t’i referuar ato si dhe për të diskutuar aspektet që lidhen me parandalimin e radikalizmin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm në kuadër të aktivitetit të Komiteteve Rajonale.

Në fokus të sesioneve ishte kuptimi i kontekstit shqiptar të radikalizimit, përvoja e krijuar me proceset e riintegrimin në komunitet të të kthyerve nga zonat e konfliktit, profili psiko-social dhe nevojat specifike, si dhe faktorët që ndikojnë në një riintegrim të suksesshëm. Gjithashtu, pjesëmarrësit u thelluan mbi funksionimin e mekanizmave kombëtarë të referimit për raste të ekstremizmit të dhunshëm, si dhe u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstytucional. Diskutimet gjatë trajnimeve nënvizuan nevojën për ndërgjegjësim të shtuar, trajtime të përshtatura dhe ndërtimin e një komuniteti më të sigurt dhe të qëndrueshëm në Shqipëri.²²

²¹ Për më shumë informacion klikoni në linkun: <https://cve.gov.al/qendra-e-koordinimit-kunder-ekstremizmit-te-dhunshem-mori-pjese-ne-trajnimin-e-specializuar-per-te-mbeshtetur-familjet-e-kthyer-nga-zonat-e-luftes/>

²² Për më shumë informacion klikoni në linkun: <https://cve.gov.al/trajtime-per-komitetet-rajonale-te-qarqeve-elbasan-dhe-fier-mbi-ekstremizmin-e-dhunshem-dhe-riintegrimin/>

Realizimi Masa 3.1.3 i SKR për vitin 2024



Realizimi financiar

Nga analiza e aktiviteteve rezulton se si paga dhe sigurime, ashtu edhe mallra, shërbime dhe kontigjenca janë realizuar plotësisht pra 100%.

Kjo masë është e realizuar.

Masa 3.1.5 Përmirësohen me qasje specifike rinore, miqësore dhe të pranueshme, programet që trajtojnë migrimin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore me në fokus parandalimin e këtyre fenomeneve dhe kthimin e të rinjve në shkollë, trajnim ose punë.

Ministria e Brendshme ka hartuar Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Planin e saj të Veprimit 2024-2026, i cili është përgatitur në vijim të strategjisë kombëtare për migracionin 2019-2022, që përfundoi afatin e zbatimit në dhjetor 2022.

Vizioni për migracionin është që deri në vitin 2030, në frymën e proceseve globale të migracionit dhe integritit të Shqipërisë në BE, të jepet një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit”. Në linjë me këtë vizion, objektivi kryesor strategjik është “Qeverisja efektive e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problemeve dhe sfidave që dalin nga lëvizjet e migrantëve, me synim rritjen e ndikimit të migracionit në zhvillimin e vendit, në dobi të emigrantëve dhe shoqërisë shqiptare”.

Qeveria shqiptare synon të realizojë objektivin kryesor strategjik duke u fokusuar në tre qëllime kryesore politike: Garantimin e qeverisjes strategjike të migracionit, zhvillimin e politikave efektive për migracionin për arsye punësimi, duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik kombëtar/lokal, si dhe promovimin e migracionit të rregullt, mbrojtjen e të drejtave të

migrantëve dhe integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare. Nëpërmjet Projektit me titull “ConnectED: Building Bridges, Creating Futures”, financuar nga British Council në kuadër të programit Alternative Pathways-“Reduktimi i emigracionit ilegal nga Shqipëria në Mbretërinë e Bashkuar”, përgjatë muajit dhjetor janë zhvilluar disa trajnime me të rinj të Këshillave Vendor Rinorë.

Realizimi financiar

Për këtë masë ka një kontribut shumë të rëndësishëm të donatorëve dhe specifikisht qeverisë britanike nëpërmjet projekti “Alternative Pathways”i financuar nga British Council. Nga të dhënat janë realizuar 100% si paga dhe sigurime shoqërore, ashtu edhe mallra, shërbime dhe kontigjenca. Si konkluzion edhe norma e realizimit të masës është 100%.

Mund të thuhet se **është masë e realizuar**

Masa 3.1.6 Fuqizohen programet rinore që fokusohen në të drejtat e njeriut dhe të pakicave, antikorrupsionin, barazinë gjinore, pranimin të diversitetit, tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm.

Në thirrjen publike numër IV për projekte rinore, AKR-ja ka mbështetur financiarisht Organizatat:

- Qendra psikosociale "VATRA" me projektin me titull “Përtej plagëve të fshehura të traumës ka jetë”, i cili ka për qëllim të rrisë dhe të mundësojë riintegrimin dhe përfshirjen sociale tek të rejtat, viktima të mbijetuara të trafikimit, abuzimit seksual dhe dhunës nëpërmjet mbështetjes psikologjike individuale dhe terapi në grup; aktivitete okupacionale; aktivitete argëtuese dhe social-kulturore brenda dhe jashtë strehëzës; ashtu edhe aktivitete të reja bazuar tek metoda të avancuara për reduktimin e stresit.
- Qendra Aleanca Sociale me projektin me titull “Fuqizimi i vullnetarizmit i të rinjve për shërbimet psiko-sociale”, i cili synon të ndikojë në rritjen, fuqizimin, informimin, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e të rinjve për të mbrojtur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara që shpesh vihet re nuk respektohen gjerësisht. Le të jenë të rinjtë që të rrisin ndërgjegjësimin dhe informimin për regjistrimin dhe aksesimin e shërbimeve sociale për personat me crregullim të spektrit autik.
- Shoqata Rinore Soek-In po implementon projektin “Rin/ON-Rini Aktive në Zonat Rurale”. Qëllimi i Projektit është përfshirja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes lokale dhe të promovojë potencialin e tyre për të ndikuar në zhvillimin e komuniteteve ku ata jetojnë, fokusuar në përfshirjen e të rinjve në zonat rurale. Përfshirja e të rinjve nga minoriteti Bullgar në Njësinë Administrative Steblevë, komunitet Rom & Egjiptian për promovimin e trashëgimisë natyror dhe kulturore.
- Shoqata MEGA ART me projektin me titull “Move Albania”, i cili ka qëllim ruajtjen dhe rritjen e formave tradicionale të vlerave popullore dhe asaj të kultivuar, të cilat rrezikojnë të lihen në harresë apo të humbasin. Duke organizuar workshope, performanca dhe trajnime, projekti synon të ndërgjegjësojë komunitetin dhe të nxisë e promovojë vlerat popullore dhe atë

të kultivuar. Projekti shtrihet në Bashkitë e Tiranës, Elbasanit, Librazhdit, Lushnjes, Fierit dhe Prrenjasit.

Nga Thirrja e III-të për grante e AKR-së janë mbështetur gjithashtu:

- Qendra Shqiptare për Integrimin e Njerëzve me Nevoja të Veçanta e cila ka implementon projektin “Çelësi i Harmonisë” ku janë përfshirë 120 të rinj të moshës 15-26 vjeç, nga Bashkia Elbasan, Bashkia Peqin, Bashkia Cërrik dhe 20 nga të cilët janë të rinj me aftësi të kufizuara. Projekti ka për funduar implementimin gjatë periudhës raportuese.
- Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (CRCA/ECPAT Shqipëri) - Titulli i projektit: “Një ndalesë për shërbime rinore të integruara”. Qëllimi i këtij projekti: Qeverisje lokale efektive dhe gjithëpërfshirëse që garanton mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe ekonomike të të rinjve në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll. Grupi i synuar i përfituesve direkt do të jetë të paktën 2000 të rinj e të reja në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll (të paktën 200 të rinj e të reja nga grupet në nevojë, nga komuniteti Rom/Egjiptian/PAK, LGBTI etj.) (50% je grupit të synuar janë vajza) përfitojnë shërbime të drejtpërdrejta të këshillimit, mbështetjes dhe fuqizimit, informacion në punësim, shkollim, biznes rinor, shërbime shoqërore dhe ato të shëndetit mendor në Qendrën Rinore me një Ndalesë;
- Qendra You Are Not Alone (Donator UNFPA) - Titulli i Projektit: “ROMActivism”. Qëllimi i Projektit: Qëllimi i këtij projekti është të kontribuohet në përmirësimin e përfshirjes sociale të të rinjve nga komuniteti rom dhe egjiptian duke i mbështetur të integrohen në tregun e punës, duke i fuqizuar për të mbrojtur nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, si dhe duke rritur aktivizimin e tyre qytetar përmes bashkëpunimit me Këshillat Vendore Rinore (KVR). Grupi i synuar: 40-50 të rinj të moshës 15-19 vjeç, nga komuniteti ROM dhe Egjiptiane.

Aktivitete të AKR:

- Në kuadër të mbështetjes së aktiviteteve të organizatave rinore për të drejtat e njeriut dhe të pakicave, barazinë gjinore, pranimit të diversitetit, tolerancës dhe komunikimit jo të dhunshëm, në datë 20 Maj 2024, AKR realizoi një takim me përfaqësuesit e "Qendra për Advokim Social", znj. Romina Sefa dhe Xhuljana Sakollari. Gjatë këtij takimi u diskutua lidhur me mundësitë për bashkëpunim dhe fuqizimin e **të rinjve të komunitetit rom dhe egjiptian**. Në 15 Korrik, AKR dhe Qendra për Advokim Social zhvilluan trajnimin “Teknologji dhe Sport për Gjithpërfshirje Sociale”. Ky aktivitet synoi të trajnojë 12 të rinj **rom dhe egjiptian** të grupmoshës 16 – 30 vjeç me qëllim përfitimin e njohurive teknologjike dhe digjitale, duke iu referuar aftësive teknike për aksesimin e portalit E-albania dhe jo vetëm.

Realizimi financiar

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 100%. Fondet për këtë janë pjesë e fondeve që AKR dhe MSHRF japin nëpërmjet thirrjeve dhe realizimi do të kalonte 100% nëse do kishte filluar të zbatohet edhe Garancia Rinore. Në aktivitete të kryera nga organizatat fituese të thirrjeve të AKR dhe MSHRF apo edhe aktivitete të organizuara nga donatorë apo institucione shtetërore është diskutuar për këto tema. Në kuadër të thirrjeve të hapura

nga AKR për projekt propozime, janë financuar disa organizata që kanë zbatuar apo zbatojnë projekte për elementë të ndryshëm që mbulohen nga masa. Përsa i përket zërave specifike nuk janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 100%.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 3.1.7 Fuqizohen programet dhe aktivitetet rinore, që trajtojnë çështje në lidhje me format e ndryshme të diskriminimit kundrejt identiteteve socio-kulturore, fetare, seksuale dhe të tjera

Pas takimit të realizuar me organizatën "Qendra për Advokim Social", me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe formave të përfshirjes së grupeve vulnerabël si p.sh., komuniteti rom dhe egjiptian, në datën 9 Korrik u trajnuan 15 të rinj të komunitetit rom dhe egjiptian mbi aftësitë teknologjike, përdorimin e e-albania dhe me datë 10 Korrik u zhvillua një ndeshje volejboli me të rinjtë e komunitetit rom dhe egjiptian dhe të rinj aktiv të bashkisë Kamëz. Në këtë aktivitet morrën pjesë rreth 40 të rinj.

Nëpërmjet thirrjes publike nr.IV MSHRF dhe AKR kanë vënë theks të veçantë në mbështetjen e si në rastin e organizatës OMSA me projektin me titull "Diversiteti dhe Gjithëpërfshirja për Komunitetin LGBTIQ+", i cili i përgjigjet nevojave të komunitetit LGBTIQ+ për një shoqëri më të hapur dhe më të përkushtuar ndaj diversitetit, duke ndikuar drejtpërdrejtë në jetën e djemve dhe vajzave në komunitetin LGBTIQ+ duke u përpjekur të eliminojë diskriminimin dhe të promovojë të drejtat dhe liritë e tyre themelore.

Realizimi financiar

Edhe në këtë masë, si tek masa e mëparshme, kontributi kryesor është i AKR dhe MSHRF nëpërmjet thirrjeve për projekte ku janë financuar disa organizata që kanë zbatuar apo zbatojnë projekte për elementë të ndryshëm që mbulohen nga masa. Përsa i përket zërave specifike nuk janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 100%. Në kostot e parashikuar nuk është përfshirë në kostim aktiviteti i donatorëve

Sipas planifikimit 100% e fondeve të realizuara janë të financuara nga buxheti i shtetit


Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**

Përmbledhje për objektivin specifik 3.1

Realizimi financiar

Realizimi i 6 masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë

Statusi i realizimit të masave të Objektivit 3.1




Ecuria e realizimit të masave është e mirë dhe tregohet edhe nga shkalla e lartë e realizimit prej 83%.

Objektivi Specifik 3.2: Të rejave dhe të rinjve ju ofrohen shërbime shëndetësore miqësore dhe ata praktikojnë stile jetese të shëndetshme, veçanërisht në lidhje me shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike, sociale, mendore dhe seksuale.

Në vitin 2024 ka vazhduar apo filluar realizimi i të gjitha masave të planifikuara. Realizimi i fondeve totale është 75%. Kurse përsa i përket zërave specifike mund të thuhet se për pagat dhe sigurimet shoqërore, niveli i realizimit është 61% dhe për mallra, shërbime dhe kontigjenca norma e realizimit është 76%.

Realizimi Objektivi 3.2 i SKR për vitin 2024




Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

Masa 3.2.1 Bashkërendohet Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021-2030, Agjenda e Fëmijëve 2021 – 2026, planet e veprimit dhe strategjitë e tjera lidhur me to, me masat e propozuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë, në veçanti promovimin e jetesës së shëndetshme.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kanë realizuar një sërë aktivitete në kuadër të zbatimit të objektivave të përbashkët të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026, duke përfshirë këtu promovimin e sportit për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, panairë sportive, aktivitete të shumëllojshme që lidhen me promovimin e artit, kulturës lokale dhe kombëtare, mbështetjen e mirëqenies fizike, sociale, kulturore dhe mendore të të rinjve, etj., në kuadër të thirrjeve për rininë të Agjencisë Kombëtare të Rinisë, etj. Në kuadër të promovimit të një jete të shëndetshme për të rinjtë, gjatë vitit 2024 janë zbatuar programe të dedikuara për krijimin e ekipeve sportive në volleyball dhe basketball, dhe zhvillimin e aktiviteteve të arteve dhe zejeve në shkolla. Këto iniciativa kanë synuar të nxisin aktivitetin fizik, kreativitetin, zbulimin dhe zhvillimin e talenteve të rinjve dhe mirëqenien emocionale të nxënësve, duke u dhënë atyre mundësi për të shprehur veten dhe për të ndërtuar aftësi bashkëpunimi. Të dy programet janë ndërthurur me orët mësimore dhe aktivitetet jashtëshkollore, duke pasuruar jetën shkollore dhe duke kontribuar në formimin e një brezi më aktiv dhe të balancuar.

Realizimi Masa 3.2.1 i SKR për vitin 2024



Realizimi financiar

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 94% pasi këtu është planifikuar një komponent nga fondi i Arte Zeje. Gjithashtu, edhe nga raportimi i mësipërm mund të thuhet se janë realizuar shumë aktivitete.

Përsa i përket zërave specifike për këtë masë nuk janë parashikuar shpenzime në zërat pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 94%. Në kostot e parashikuar nuk është përfshirë në kostim aktiviteti i organizatave fituese të thirrjes së tretë të AKR pasi ato fonde janë përfshirë në kostot e masave të mëparshme.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar.**

Masa 3.2.2 Zhvillohen qasje të pranueshme dhe miqësore për të rinjtë në strukturat shëndetësore, të cilat marrin në konsideratë tranzicionin nga strukturat dhe shërbimet mjekësore për fëmijë te ato për të rriturit (nevoja për të zhvilluar standarde miqësore për të rinjtë)

Përfshirja e organizatave rinore dhe të rinjve në hartimin e politikave në fushën e shëndetësisë, si dhe në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara për ta, tashmë është një praktikë e zbatuar. Të rinjtë janë përfshirë në një sërë aktiviteteve me dhe për të rinjtë mbi çështje të ndryshme të shëndetit publik, si shëndeti seksual dhe riprodhues, shëndeti mendor, etj., në kuadër të promovimit të stilit të jetesës së shëndetshme, në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe pushtetin lokal.

Në kuadër të aktiviteteve të promovimit shëndetësor dhe ofrimit të kujdesit shëndetësor në institucionet e arsimit parauniversitar, Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, në koordinim me Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Institutin e Shëndetit Publik, bazuar edhe në

parashikimet e Planit Kombëtar të Promocionit Shëndetësor 2021-2030, realizojnë takime periodike për nxitjen e sjelljeve të shëndetshme te të rinjtë, duke përfshirë edhe grupet vulnerabël.

Gjithashtu Agjencia Kombëtare e Rinisë ka mbështetur projekt propozimet nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë me fokus aspektet e shëndetit për të rinjtë.

Realizimi financiar

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 83%. Fondet për këtë janë pjesë e fondeve që AKR dhe MSHRF japin nëpërmjet thirrjeve dhe gjithashtu fonde të AMSHC. Në kuadër të thirrjeve të hapura nga AKR për projekt propozime, janë financuar disa organizata që kanë zbatuar apo zbatojnë projekte²³ për elementë të ndryshëm që mbulohen nga masa. Përsa i përket zërave specifikë nuk janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 83% pasi në kostot e parashikuar nuk është përfshirë në kostim aktiviteti i donatorëve, fondet e dhëna nga AKR (janë në masë tjetër).

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë pjesërisht e realizuar.**

Masa 3.2.3 Zhvillohen shërbime të reja dhe forcohen ato ekzistuese nëpër shkolla me cilësi të garantuar për ofrimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe psikologjik, si edhe mbështeten shërbimet online të shëndetit mendor në platformën për rininë (Të Rinjtë për të Rinjtë) 2023-2029.

Në kuadër të zbatimit të parashikimeve strategjike të këtij dokumenti dhe të Strategjisë Kombëtare Shëndetësore dhe të Planit të Veprimit për Shëndetin Mendor 2023-2026, i cili ka vënë në një fokus të veçantë shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, gjatë kësaj periudhe raportimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, janë realizuar një sërë aktivitete, përkatësisht:

- Ngritja e ekipit të ri multidisciplinar për fëmijët dhe adoleshentët në Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor nr. 2 në Tiranë dhe trajnimi i tyre (5 ditë trajnim) pranë QKSHM-ve që e ofrojnë këtë shërbim.
- Me qëllim fuqizimin e rolit të Kujdesit Shëndetësor Parësor, në bashkëpunim me shërbimet e specializuara komunitare të shëndetit mendor, janë realizuar 25 trajnime njëditore (për mjekë familje, infermierë, psikologë, punonjës socialë të qendrave socio-shëndetësore, Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor, stafet psikosociale të shkollave – në total rreth 525) për identifikimin e hershëm, mbështetjen dhe referimin në kohë të fëmijëve dhe adoleshentëve me probleme të shëndetit mendor.

²³ Shëndeti mendor në epokën dixhitale me buxhet 3,149,800.00 dhe Mindful youth - Nurturing Health and Sustainability me buxhet 1,800,168.00

- Rreth 200 staf (mamia, infermierë, mjekë konsultorë, mjekë të përgjithshëm, vaksinatorë, etj.) në Lezhë dhe Elbasan u trajnuan për depresionin prenatal, ku shëndeti mendor i mirë i gruas shtatzënë dhe nënës së një të porsalinduri është një parakusht i shëndetit të mirë mendor të fëmijës së porsalindur dhe të një të riu në të ardhmen.
- Janë trajnuar 80 stafe psikosociale të KSHP mbi shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe adoleshentëve dhe rrugët e referimit.
- Është zhvilluar dhe akredituar një paketë trajnimi për ofrimin e shërbimeve të integruara për shëndetin mendor dhe mirëqenien dhe zhvillimin psikosocial të fëmijëve, adoleshentëve dhe familjeve të tyre; dhe janë trajnuar 350 stafe mjekësore dhe psikosociale nga KSHP, shërbimet e shëndetit mendor, dhe stafet e kujdesit shëndetësor në shkolla.
- Është rishikuar rregullorja e brendshme e QKSHM-ve, me në fokus standardizimin e shërbimit për fëmijët dhe adoleshentët dhe unifikimin e instrumenteve/testeve të përdorura për vlerësimin e kësaj grupmoshe.
- Është hartuar manuali “Si të flasim për shëndetin mendor me nxënësit” nga ekspertë të ASKAP dhe ISHP dhe janë trajnuar 36 stafe arsimore për njohjen dhe zbatimin e tij.

Ndërkohë, vijon politika e hapjes së specializimeve në shëndetësi, ku çdo vit sigurohet ndjekja e specializimit në psikiatrinë për fëmijë dhe adoleshentë, si kuota të mbuluara nga MSHMS, një inkurajim për mjekët e rinj për ndjekjen e këtij specializimi.

- Është zbatuar një program **“Peer to peer”** kundër stigmës ndaj shëndetit mendor të të rinjve nëpërmjet një organizate rinore, me angazhimin e adoleshentëve dhe të rinjve me mbështetjen e OBSH dhe UNICEF.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar takime lokale në 4 DROSHKSH për të diskutuar mbi aktivitetet e parashikuara në PVSHM 2023-2026 me përfaqësues të NJVKSH-ve, në varësi të NJVV-ve, kryesisht ata që mbulojnë shërbimet sociale dhe NJMF-të, nga DRSHTSH dhe nga arsimi parauniversitar. Këto diskutime kanë orientuar planet rajonale për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Ka filluar puna për hartimin e Planit të Veprimit për Parandalimin e Vetëvrasjeve nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim me urdhër ministri, proces i cili synon të adresojë këtë fenomen global që prek më së shumti të rinjtë, nga informimi mbi rëndësinë e të folurit për vetëvrasjen, veçanërisht mes adoleshentëve dhe të rinjve dhe kërkimi i ndihmës, në periudhën e raportimit mediatik, drejt një raportimi të përgjegjshëm mbi vetëvrasjet duke synuar njohjen e ndikimit të mënyrës së raportimit të lajmeve mbi këtë fenomen dhe se si kjo fuqi (raportimi mediatik) mund të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit publik të popullatës nëpërmjet raportimit mediatik të përgjegjshëm, si dhe në zhvillimin e kapaciteteve të stafit psikosocial dhe shëndetësor për ofrimin e mbështetjes psikosociale, të bazuar në prova, për reduktimin e rrezikut të dëmtimit të vetes dhe rreziqeve të tjera të sjelljes mes adoleshentëve dhe të rinjve, kryesisht.

Në terma të fuqizimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të qeverisjes në shëndetin mendor, veçanërisht të shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, pas fuqizimit të Komitetit Kombëtar për Shëndetin Mendor me qëllim zbatimin e qasjes gjithëpërfshirëse të qeverisjes së shëndetit mendor, nëpërmjet zgjerimit të pjesëmarrjes me përfaqësues të ministrive të linjës, përfshirë MSHRF, institucioneve shëndetësore dhe sociale në nivel qendror, të qeverisjes vendore, të agjencive të pavarura dhe aktorëve të shoqërisë civile, nëpërmjet amendimeve të VKM nr. 456, datë 22.05.2013 “Për përbërjen dhe

mënyrën e funksionimit të Komitetit Kombëtar të Shëndetit Mendor”, është ngritur edhe Nënkomiteti për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të fëmijëve dhe të adoleshentëve, sipas parashikimeve të kësaj VKM-je dhe janë realizuar tre takime të kësaj strukture këshillimore.

Ndërkohë, në korrik të 2024, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe përfaqësues të NJVKSH në Elbasan bashkëorganizuan me UNICEF aktivitetin e radhës në Elbasan, në kuadër të programit UPSHIFT mbi Shëndetin dhe Mirëqenien Mendore të UNICEF, i cili synonte të informonte të rinjtë mbi adresimin e problematikave të shëndetit mendor të adoleshentëve dhe të rinjve, që mund të bëhet edhe nga vetë ata. Në 2 ditët e workshop-it, 60 të rinj pjesëmarrës, të ndarë në grupe dhe me ndihmën e mentorëve, zhvilluan projekte të ndryshme inovative, gjithëpërfshirëse dhe konkrete mbi adresimin e problemeve të shëndetit mendor në komunitetin e tyre, duke mundësuar një ndikim pozitiv dhe të qëndrueshëm.

Përveç aktiviteteve të trajtuara më sipër, ku stafet psikosociale në shkolla kanë qenë pjesë e trajnimeve multidisiplinare të ofruara për shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve, të cilat kanë trajtuar edhe sfidat e shëndetit mendor në rast emergjencash, gjatë vitit 2024 është hartuar (përkthyer dhe përshtatur). Udhëzuesi për ofruesit jo-profesionistë dhe kujdestarët mbi strategjitë për promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor dhe reduktimin e vetëdëmtimit dhe rreziqeve të tjera. Ky udhëzues është bazuar në manualin e OBSH-së dhe UNICEF-it, *“Helping Adolescents Thrive Toolkit”* (*“Të ndihmojmë adoleshentët të ecin përpara”*), si dhe Udhëzuesi për mësuesit *“Teacher’s Guide and Comic Book”* (*“Udhëzues për mësuesin dhe libër vizatimor”*), pjesë e paketës *“Helping Adolescents Thrive Toolkit”* të OBSH-së dhe UNICEF-it, dhe zbatuesit e tyre janë informuar.

Në kuadër të thirrjes së IV për projektpropozime nga Agjencia Kombëtare e Rinisë: Qendra Be the Change ka nisur të implementojë projektin me titull "Shëndeti mendor ne epokën dixhitale", me qëllim rritjen e kompetencës psiko-edukative midis të rinjve që banojnë në rrethet e Durrës, Tiranës dhe Librazhdit, duke synuar vecanërisht sfidat e shëndetit mendor që rrjedhin nga përdorimi i teknologjisë.

Realizimi financiar

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 86%. Përsa i përket zërave specifike janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore por janë përgatitur materiale informative dhe janë organizuar trajnime, pra praktikisht janë kryer aktivitetet e planifikuara për 2024. Por fushatat nëpërmjet platformës “Të rinjtë për Të Rinjtë” nuk janë realizuar për shkak të mosngritjes së platformës. Kështu që ky zë njihet me realizim 2%. Shpenzimet kapitale nuk janë parashikuar. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 90% pasi në këtë masë janë aplikuar financime të WHO dhe UNFPA.

Sipas planifikimit pjesa më e madhe e fondeve të realizuara janë fonde të financuara nga donatorët.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 3.2.4 Sigurohet pranimi i të rinjve në shërbimet e duhura të parandalimit dhe promovimit sipas Planit Kombëtar të Veprimit mbi Shëndetin dhe të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese 2022

- 2030, për të siguruar që të rinjtë që jetojnë në Shqipëri marrin edukim / informacione të përgjithshme në formë të pranueshme dhe miqësore ndaj tyre 2023-2029.

Gjatë periudhës raportuese, ekspertët të ASCAP dhe ISHP kanë shpërndarë manualin mbështetës për stafin psikosocial në shkolla, mbi diskutimin për çështje të shëndetit mendor me nxënësit, ku është përfshirë dhe një kapitull mbi imazhin trupor dhe udhëzime mbi zhvillimin e ushtrimeve në klasë për rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve mbi imazhin pozitiv trupor.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese:

- janë realizuar trajnime me staf nga QKSHM mbi shëndetin mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve.
- ISHP ka marrë pjesë në sesione ndërgjegjëse për shëndetin mendor me të rinj që ndjekin shkollën, ku janë trajtuar dhe çështje të lidhura me imazhin trupor.
- ISHP lancon nëpërmjet rrjeteve sociale mesazhe për promovimin e shëndetit mendor pozitiv, duke përfshirë edhe qëndrimin ndaj imazhit fizik.
- Janë shpërndarë materiale informative dhe është organizuar trajnim për profesionistët shëndetësor të shkollave, ku janë përfshirë mbi 12 module, mes të cilave është edhe shëndeti riprodhues i të rinjve. Gjithashtu, janë promovuar materiale informuese për HPV dhe janë organizuar aktivitete ndërgjegjëse me të rinjtë në shkolla, me qëllim informimin për HPV.

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët zhvilloi një takim me znj. Justine Coulson, Drejtor Vendor i UNFPA Shqipëri, ku u diskutua mbi bashkëpunimin e suksesshëm gjatë përgatitjes së Strategjisë Kombëtare të Rinisë, por edhe dakordësua për ndërmarrjen e disa iniciativave të rëndësishme për të adresuar çështje si bullizmi, mbrojtjen e mirëqenies së të rinjve dhe shëndetin riprodhues si dhe problematika të tjera që përballen të rinjtë.

Realizimi financiar

Në këtë masë, krahas aktiviteteve që janë përmendur më lart janë të parashikuara të realizohen fushata ndërgjegjëse online për imazhin. Janë bërë postime në rrjete sociale nga institucionet e shëndetit por nuk ka fushata të mirëfillta.

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë pjesërisht e realizuar.**

Masa 3.2.5 Propozohen dhe zhvillohen veprimtari në lidhje me sjelljen e rrezikshme dhe konsumin e drogës duke siguruar që të rinjtë marrin informacione dhe edukim tërësor. Sigurohet që të rinjtë kanë akses në ndërhyrjet e duhura parandaluese dhe shërbimet e trajtimit të varësisë 2023-2029.

Në lidhje me ndërhyrjet për parandalimin e përdorimit të substancave, specifikisht drogave, te fëmijët dhe adoleshentët e arsimit parauniversitar, një sërë aktivitete janë parashikuar në Planin e Veprimit për Parandalimin, Trajtimin dhe Reduktimin e Dëmit nga Drogat në Shqipëri 2023 - 2026, miratuar në mars të vitit 2024. Këto aktivitete realizohen periodikisht nga stafet e promocionit shëndetësor në bashkëpunim me stafet arsimore.

Një nga aktivitetet e parashikuara në këtë dokument strategjik është edhe rishikimi i Marrëveshjes mes MSHMS dhe MAS për përfitimin e sjelljeve të shëndetshme të fëmijët në shkolla gjatë vitit 2025.

Në kuadër të Ditës Botërore të Luftës ndaj Abuzimit me Drogat dhe Trafikimit të Tyre, gjatë vitit 2024, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) zhvilloi një aktivitet me pjesëmarrjen e stafeve të promocionit të NJVKSH-ve në rrethe, me temë: *"Implementimi i ndërhyrjeve parandaluese të bazuara në evidenca"*, me qëllim rritjen e njohurive, përmirësimin dhe organizimin e punës së tyre mbi baza shkencore.

Pjesëmarrësit u informuan mbi një model konkret të parandalimit, siç është "Listen First" i UNODC, për edukimin e prindërve, edukatorëve dhe stafit shëndetësor mbi parimet që mundësojnë zhvillimin e shëndetshëm psiko-emocional të fëmijëve dhe krijimin e modeleve të sjelljeve të shëndetshme gjatë jetës.

Çështjet e parandalimit të abuzimit me substanca, përfshirë drogat dhe alkoolin, trajtohen gjerësisht në **Planin e Veprimit për Parandalimin, Trajtimin dhe Reduktimin e Dëmit nga Drogat në Shqipëri 2023 - 2026**, miratuar në mars të vitit 2024, si dhe në **Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Dëmeve të Lidhura me Alkoolin në Shqipëri 2025 – 2030**, i cili është në proces hartimi nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim. Në këtë plan, komponenti i ndërhyrjeve parandaluese primare dhe sekondare tek të rinjtë do të zërë një vend të veçantë.

Realizimi financiar

Nga raportimi i ISHP janë përgatitur 12 module trajnimi që ofrohen.


Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se aktivitetet në lidhje me krijimin e programeve nuk janë plotësisht të realizuara. Norma e realizimit e fondeve totale të planifikuara është në nivelin 50%. Përsa i përket zërave specifike janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore dhe janë realizuar 100% dhe mallrat, shërbimet dhe kontigjencat me 0%

Si konkluzion mund të thuhet se **është masë pjesërisht e realizuar.**

Përmbledhje për objektivin specifik 3.2

Realizimi i 5 masave në bazë të analizës financiare është si më poshtë:

Statusi i realizimit të masave të Objektivit 3.2



Objektivi Specifik 3.3: Të rejat dhe të rinjtë mbështeten në përfshirjen dhe integrimi në tyre në shoqëri dhe kanë mundësi rekreative dhe kulturore, duke përfshirë artet dhe sportet.

Gjatë 2024 ka vazhduar realizimi i të gjitha masave të planifikuara. Në 3 masat e këtij objekti nuk janë planifikuar shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore. Realizimi i fondeve totale është 100%. Kurse përsa i përket zërave specifikë mund të thuhet se për zërin materiale shërbime dhe kontigjenca dhe shpenzimet e kapitalit niveli i realizimit është 100%.

Më poshtë jepet informacioni për secilën nga masat.

Masa 3.3.1 Mbështetet ndërtimi, riparimi dhe rinovimi i hapësirave publike të projektuara për të rinjtë, me qëllim përmirësimin e qasjes së të rinjve në hapësira të sigurta takimi, edhe në kohën e lirë.

Nëpërmjet Thirrjes Publike Nr. III për projekt-propozime për infrastrukturë rinore, për Njësitë e Vetqeverisjes Vendore janë mbështetur financiarisht nga MSHRF dhe AKR 6 bashki, përkatësisht:

1. Bashkia Fier me projektin me titull “Skyhigh Rinor: Projekti i hapësirës së Rinisë që Shkëlqen mbi Qytet”
2. Bashkia Mat me projektin me titull “Rinovart, Qendër rinore multifunksionale, rekreative, inovacion dhe art”
3. Bashkia Malësi e Madhe me projektin me titull “Kompleksi Rinor “Syri i Sheganit”
4. Bashkia Librazhd me projektin me titull “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd”

5. Bashkia Korçë me projektin me titull “Rehabilitimi i Qendrës Rinore Korçë”
6. Bashkia Sarandë me projektin me titull “Qendra Rinore Sarandë”

Në kuadër të thirrjeve për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore:

Më datë në 26 nëntor u zhvillua aktiviteti i inagurimit të kompleksit rinor "Syri i Sheganit", Bashkia Malësi e Madhe. Në datë 20 nëntor 2024 AKR ka hapur thirrjen Publike Nr. 4 për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Thirrja qëndroi e hapur për 30 ditë.

Realizimi financiar

Fondet e kësaj mase janë përfshirë tek kostot 1.1.4 dhe ato fonde janë të realizuara.

Si rrjedhim mund të thuhet se **është masë e realizuar**.

Masa 3.3.2 Mbështetja e programeve të gjithëpërfshirjes dhe politikave të përfshirjes, sigurisë dhe mbrojtjes me fokus të veçantë tek të rejtat dhe të rinjtë.

Në kuadër të forcimit të programeve për trajnimin e mësuesve nga MAS janë organizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Janë hartuar module dhe manuale në mbështetje të mësuesve ndihmës të cilat janë publikuar ne ëeb-in e ASCAP²⁴.
- Janë ngritur kapacitetet e drejtuesve të rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës në çdo ZVAP, mbi trajtimin e koncepteve të arsimit gjithëpërfshirës dhe identifikimit të mënyrave dhe formave efektive të ofrimit të tij me qëllim mbështetjen dhe përfshirjen e të rinjve nga grupet vulnerable në aktivitet të ndryshme sociale dhe nxitjen e ndjekjes së procesit arsimor përmes ofrimit të mbështetjes financiare përmes bursave
- Bashkëpunim me Bashkinë dhe Drejtorinë e Shërbimit Social pranë Bashkisë.
- Aktivitete ndërgjegjësuere me aktorë të ndryshëm shkollorë dhe lokalë mbi rëndësinë e ofrimit të arsimit gjithëpërfshirës si mundësi e garantimit të një arsimi cilësor për të gjithë nxënësit, pavarësisht statusit dhe pozicionimit të tyre ekonomik dhe social. Gjithashtu mësuesit janë pjesë e trajnimeve të gjithpëfshirjes nga ASCAP.

Qëllimi i veprimtarive ka qenë fuqizimi dhe zhvillimi i të rinjve për të ardhmen. Temat kanë pasur për synim të ndërgjegjësojnë nxënësin për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në shoqëri dhe gjithashtu të kuptojnë sa i rëndësishëm është zëri i tyre.

²⁴ Për më shumë informacion (<https://www.ascap.edu.al/>)

Në kuadër të mbështetjes së organizatave rinore në zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve parandaluese për të rinjtë në rrezik të përjashtimit social, projektet fituese të thirrjes së 3-të për projekt-propozime rinore që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me synimin janë:

- “Qendra Youth Rise” - ka implementuar projektin me titull “Unlock Your technological Skills”. Qëllimi i të cilit është krijimi i një mjedisi mbështetës për të rinjtë duke promovuar aftësitë inovative, digjitale dhe sipërmarrëse.
- “Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” (CRCA/ECPAT Shqipëri)” - Titulli i projektit: “Një ndalesë për shërbime rinore të integruara”. Qëllimi i këtij projekti: Qeverisje lokale efektive dhe gjithëpërfshirëse që garanton mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen në jetën sociale dhe ekonomike të të rinjve në Bashkitë Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll. Të rinjtë përfitojnë shërbime të drejtpërdrejta të këshillimit, mbështetjes dhe fuqizimit, informacion në punësim, shkollim, biznes rinor, shërbime shoqërore dhe ato të shëndetit mendor në Qendrën Rinore me një Ndalesë;
- Action for Albania - Titulli i Projektit: “Action for Youth”. Qëllimi i Projektit: Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është ngritja e kapaciteteve të të rinjve për aftësimin profesional si dhe monitorimi dhe mbështetja e ideve inovatore të sipërmarrjes (start upet), si aktivitet kritik për ndërlidhjen e të rinjve me tregun e punës, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të bashkive si dhe rritjen e mirëqenies së komunitetit.
- Qendra You Are Not Alone - (Donator UNFPA) - Titulli i Projektit: “ROMActivism”. Qëllimi i Projektit: Qëllimi i këtij projekti është të kontribuohet në përmirësimin e përfshirjes sociale të të rinjve nga komuniteti rom dhe egjiptian duke i mbështetur të integrohen në tregun e punës, duke i fuqizuar për tu mbrojtur nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, si dhe duke rritur aktivizimin e tyre qytetar përmes bashkëpunimit me Këshillat Vendore Rinore (KVRProjektet fituese të thirrjes së 4 për projekt-propozime rinore që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me mbështetjen e organizatave rinore në zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve parandaluese për të rinjtë në rrezik të përjashtimit social.
- Qendra “TISS” po implementon projektin “Zëri ynë, forca jonë”. Qëllimi i projektit është fuqizimi i kapaciteteve dhe rritja e pjesëmarrjes të të rinjve me nevoja të veçanta në proceset vendimmarrëse në komunitet dhe në dhe në pushtetin lokal; integrimin e tyre në politikat vendore, nëpërmjet gjithëpërfshirjes dhe aktiviteteve social-kulturore, duke zhvilluar një qasje inovative të ndërhyrjes dhe rritjes së ndërgjegjësimit komunitar nëpërmjet angazhimit direkt të të rinjve me aftësi ndryshe, në Bashkitë Kamzës, Durrës dhe Elbasan nëpërmjet shprehjes së vullnetit jo vetëm nëpërmjet zërit por edhe nëpërmjet artit.
- Qendra Aleanca Sociale po implementon projektin “Fuqizimi i vullnetarizmit i të rinjve për shërbimet psiko-social”. Projekti ka për qëllim nëpërmjet trajnimeve, ëorkshopeve të rrisë vullnetarizmin, ndërgjegjësimin dhe informimin e të rinjve për identifikimin, regjistrimin dhe aksesimin e shërbimeve sociale për personat me probleme të spektrit të autizmit për të përfituar nga të drejtat që ofron kuadri ligjor pranë njësive Bashkiake Elbasan, Cërrik, Gramsh dhe Librazhd nëpërmjet të rinjve vullnetar.
- Shoqata Rinore Soek-In po implementon projektin “Rin/ON-Rini Aktive në Zonat Rurale” Qëllimi i Projektit është përfshirja e të rinjve në proceset e vendimmarrjes lokale dhe të promovojë potencialin e tyre për të ndikuar në zhvillimin e komuniteteve ku ata jetojnë, fokusuar në përfshirjen

e të rinjve në zonat rurale. Përfshirja e të rinjve nga minoriteti Bullgar në Njësinë Administrative Steblevë, komunitet Rom & Egjiptian për promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

- Organizata OMSA me projektin me titull “Diversiteti dhe Gjithëpërfshirja për Komunitetin LGBTIQ+”, i cili ka për qëllim të sigurojë një shoqëri më të barabartë, më të diversifikuar dhe më të përfshirë për të gjithë pjesëtarët e komunitetit LGBTIQ+ në Shqipëri, për të garantuar një ndikim të qëndrueshëm dhe të gjerë në nivel lokal.
- Qendra psikosociale "VATRA" po implementon projektin “Përtej plagëve të fshehura të traumës ka jetë”, qëllimi i të cilit është të mundësojë riintegrimin dhe përfshirjen sociale tek të rejtat, viktimat të mbijetuara të trafikimit, abuzimit seksual dhe dhunës duke ofruar dhe promovuar shërbime cilësore psiko-sociale nëpërmjet terapive, aktiviteteve krijuese, relaksuese, e tjerë. Synohet të impaktohen të reja të moshës 15-29 vjeç, viktimat të trafikimit, të abuzimit seksual dhe dhunës në familje të akomoduara në Strehëzën e Qendrës Psiko-Sociale Vatra, të cilat vijnë nga të gjitha qarqet e Shqipërisë Shkodër, Vlorë, Lezhë, Fier, Berat, Gjirokastrë, Kukës, Tiranë, Elbasan, Korçë, Dibër, Durrës.

Realizimi financiar

Për këtë masë janë realizuar aktivitete me fonde të buxhetit të shtetit dhe gjithashtu ka pasur mbështetje të donatorëve që nuk janë parashikuar në kostot e planifikuara.

Duke u bazuar tek analiza e fondeve mund të thuhet se realizimi i fondeve totale të planifikuara është në nivelin 100%. Përsa i përket zërave specifike nuk janë parashikuar pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shpenzimet kapitale. Ndërkohë, shpenzimet materiale shërbime dhe kontigjenca janë realizuar 100% pasi janë përgatitur materiale dhe janë organizuar trajnime

Si konkluzion mund të quhet **masë e realizuar**.

Masa 3.3.3 Mbështetet dhe promovohet programi i qeverisë në lidhje me mbështetjen financiare të strehimit për familjet e reja dhe në bashkëpunim me aktorë qeveritarë qendrorë e vendorë, si edhe organizatat donatore, nxitet zhvillimi programeve të tjera, në mbështetje të familjeve dhe çifteve të reja.

Në Qershor 2023 u miratuan nga Kuvendi i Shqipërisë ndryshimet në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, ku për herë të parë u parashikua përfshirja në skemën e programit të subvencionit të interesave të kredive punonjësit e administratës publike, si dhe përfshirja e familjeve të reja, duke qenë se problemi i strehimit të të rinjve dhe familjeve të reja, vitet e fundit, është kthyer në prioritet.

Në zbatim të Ligjit nr. 22/2018 ‘Për strehimin social’ është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 19.06.2024 “Për miratimin e kuotave të reja përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike”. Në këtë vendim janë përcaktuar 300 kuota të përgjithshme të kredive të lehtësuara me interes 0 për administratën publike për vitin 2024. Aplikimet për trajtimin me kredi të lehtësuara të të punësuarve në administratën publike kanë qenë aktive deri me datë 14 Gusht 2024.

Gjatë muajit janar 2025, pritet të miratohet Vendimi i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë e të punësuarve përfitues në administratën publike.

Në vijim të programit kombëtar të strehimit social, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në bashkëpunim me bashkitë e vendit ka hapur aplikimet për kredi të subvencionuara me interes vetëm 3% në vit për 2000 familje në 26 Bashki të vendit. Këto kredi mbështetin individët që kërkojnë të nisin një jetë të re dhe të qëndrueshme.

Prioritet do të jenë:

- Familjet e reja dhe të rinjtë deri 40 vjec
- Gratë kryefamiljare dhe fratë e dhunuara
- Familjet njëprindërore me fëmijë në ngarkim
- Familjet me më shumë se 4 fëmijë
- Afati i aplikimeve deri më 13 Janar 2025.

Realizimi financiar

Kjo masë ishte planifikuar të fillonte më 2027. Në 2023 janë bërë ndryshimet ligjore kështu që kjo **masë konsiderohet që ka filluar zbatimin.**

Përmbledhje për objektivin specifik 3.3

Realizimi i masave në bazë të analizës financiare është 100%

3. Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit e performancës

Në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 janë parashikuar të monitorohen 15 tregues të rezultateve, të cilët janë të ndarë për secilin qëllim të politikës. Më poshtë pasqyrohet performanca e zbatimit të SKR-së sipas treguesve të performancës, për çdo qëllim të politikës, të cilët janë të zbatueshëm për periudhën raportuese, pra mund të maten dhe mund të vlerësohet realizimi i tyre.

Treguesit e performancës, sipas qëllimeve të politikës janë si më poshtë

Qëllimi i Politikës 1	Qëllimi i Politikës 2	Qëllimi i Politikës 3
Përqindja e buxhetit të shtetit dedikuar për programet mbi rininë	Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës sipas gjinisë	Përqindja e të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme
Përqindja e bashkive ku janë ngritur Qendrat Rinore Multifunkionale	Shkalla e papunësisë së të rinjve në përqindje të ndarë sipas gjinisë	Përqindja e qendrave shëndetësore të pajisura me mjedise miqësore për të rinjtë
Ligji "Për Rininë" i rishikuar dhe miratuar	Numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimor	Përqindja e nëpunësve publikë të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë
Ligji "Për Vullnetarizmin" i rishikuar dhe miratuar	Përqindja e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit	
Platforma Rinore "Të Rinjtë për të Rinjtë" e ngritur, funksionale dhe e përditësuar	Përqindja e të rinjve që kanë filluar biznesin me mbështetjen financiare të shtetit	
Numri i Këshillave Vendore të ngritur dhe funksional (në nivel bashkie)		
Numri/Përqindja i/e bashkive që kanë ngritur Kënde Digjitale të Informimit Rinor (info points)		

Realizimi i treguesve të performancës

Nga analiza e bërë për secilin nga treguesit e performancës të SKR 2022 - 2029 rezulton se nga 19 tregues performance që përmban Pasaporta e treguesve të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, për vitin raportues (Janar-Dhjetor 2024) rezultojnë të matshëm 15 tregues performance të ndarë si më poshtë:

Qëllimi i Parë: 7 tregues të matshëm për 2024, 2 tregues nuk është planifikuar të maten në 2024


Qëllimi i Dytë: 5 tregues të matshëm për 2024

Qëllimi i tretë: 3 tregues të matshëm për vitin 2024, 1 tregues është planifikuar të matet në 2029

Një tregues në nivel impakti dhe një tregues rezultati për qëllimin e politikës 3 janë parashikuar që të maten vetëm në fund të periudhës që mbulon SKR, pra në vitin 2029.

Analiza e bërë edhe më sipër përmbledhet në grafikun e mëposhtëm ku jepet statusi i realizimit të treguesve në nivel të strategjisë

Statusi i realizimit të Treguesve të Performancës 2024



Nga analiza rezulton se

4 tregues ose 27% e treguesve janë realizuar

5 tregues ose 33% e treguesve janë realizuar pjesërisht

6 tregues ose 40% nuk janë realizuar


Në vazhdim jepet analiza e detajuar për treguesit e identifikuar për secilin nga qëllimet e politikës

QËLLIMI I POLITIKËS 1:

Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre. Politikat ndërsektorale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar, ka të parashikuar 7 (shtatë) tregues të performancës, të cilët janë të matshëm për periudhën raportuese.

Nga analiza e shkallës së realizimit të treguesve të performancës të qëllimit të politikës 1, vihet re se tek qëllimi i parë i politikës janë realizuar 1 tregues ose 14% e treguesve të planifikuar për tu monitoruar në 2024.

Statusi i realizimit të Treguesve për Qëllimin 1



Siç paraqitet edhe më lart, 3 tregues të performancës ose 43% e treguesve të parashikuar për tu monitoruar në 2024 janë realizuar pjesërisht dhe 3 tregues të performancës nuk janë realizuar.

Më poshtë jepet analiza e detajuar për secilin nga treguesit e performancës ku përfshihen vlera e synuar e treguesit, vlera aktuale e treguesit dhe shkalla e realizimit.

Treguesi 3: % e buxhetit të shtetit dedikuar për programet mbi rininë.

Ky tregues është parashikuar të matet çdo vit. Vlera e synuar për vitin 2024 është 1%. Ndërkohë, referuar Ligjit Nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, shpenzimet e planifikuara në mbështetje të rinisë dhe fëmijëve në raport me buxhetin e shtetit²⁵ llogariten në masën 0.053 %. Vlera e synuar e treguesit për 2024 është 1%. Siç duket nga vlera mund të thuhet se ky tregues është i parealizuar.

Treguesi 1.1 a. Përqindja e bashkive ku janë ngritur Qendrat Rinore Multifunktionale

Ky tregues është planifikuar në nivel objektiv dhe do të matet në periudha vjetore. Në vitin 2024 Agjencia Kombëtare e Rinisë ka vazhduar financimin, rikonstruksionin, ndërtimin, rindërtimin dhe vënia në funksion e qendrave rinore në qytetin e Lezhës, qytetin e Elbasanit, NjA Petrelë të bashkisë Tiranë, të qytetit të Durrësit, të qytetit të Gjirokastrës, të qytetit të Fierit, të qytetit të Librazhdit, të bashkisë Mat, të bashkisë Malësi e Madhe, të qytetit të Sarandës dhe bibliotekave publike në

²⁵ Mbështetje për Rininë dhe Fëmijët tek [Tabela-1-Buxheti-2024-1.xls](#),

Roskovec, Dibër, Lushnje dhe Kamëz. Në thirrjen e tretë për Njësitë e Qeverisjes Vendore, në 2024, AKR miratoi projektet e bashkive Berat, Cërrik, Delvinë, Librazhd, Lushnje dhe Prrnjas

Në total deri në fund të 2024 rezultojnë të financuara 20 qendra rinore të shtrira në 20 bashki të vendit, duke bërë që treguesi të realizohet në vlerës 33 %. Bazuar në vlerën e synuar për 2024, duhej që 50% e bashkive të kishin qendra multifunksionale të ngritura. Bazuar në të dhënat si më sipër, ky tregues është realizuar në masën 67% gjatë periudhës që mbulon ky raport monitorimi. Treguesi është pjesërisht i realizuar.

Treguesi 1.1.b: Numri i Këshillave Vendore të ngritur dhe funksionale (në nivel bashkie)

Vlera bazë për përlogaritjen e këtij treguesi do t'i referohet vitit 2022 ku KVR-të ja ngritur në 21 bashki. Ndërkohë në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 është parashikuar që në fund të vitit 2024 të jenë ngritur këshillat vendorë në 61 bashki të vendit. Gjatë 2024 janë ngritur Këshillat Vendorë Rinorë edhe në 2 bashkitë që nuk i kishin ngritur në 2023. Duke pasur parasysh këtë situatë mund të thuhet se treguesi është i realizuar.

Treguesi 1.1.c: Ligji "Për Rininë" i rishikuar dhe miratuar

Puna për rishikimin e ligjit nr. 75/2019 ka nisur në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 me ndërmarrjen e procesit të vlerësimit të brendshëm nga MSHRF-ja dhe AKR-ja lidhur me zbatimin dhe ndikimin e tij, duke synuar analizën e situatës, identifikuar problematikën dhe nevojat për ndryshim në përputhje me zhvillimet e reja në fushën e rinisë.

Gjatë muajve korrik - shtator 2024, është zhvilluar turi i Konsultimeve me të Rinjtë "Rinia Ndryshon Ligjet". Pas zhvillimit të këtij turi, është realizuar zbardhja dhe përpunimi i të dhënave dhe rekomandimeve, duke përfshirë ëorkshopen me organizatat e shoqërisë civile dhe rekomandimet e përcjella pranë MSHRF nga aktorë të ndryshëm shoqërorë gjatë kësaj periudhe. Janë hartuar dokumentet përkatëse, si projektligji dhe relacioni shoqërues, të cilat janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP) në datat 27.11.2024 - 25.12.2024.

Projektligji është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-aktet pranë ministrive të linjës. Në vijim, janë reflektuar propozimet dhe sugjerimet e Ministrive me qëllim finalizimin e procesit dhe përcjelljen e tij për miratim në Këshillin e Ministrave, në përputhje me parashikimet në Planin e Veprimit të SKR-së, si dhe raportimet përkatëse në PPAP 2024 dhe Programin Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2030. Duke pasur parasysh se gjatë vitit 2024 ka përfunduar procesi i rishikimit të projektligjit dhe miratimi i tij pritet gjatë Q1 të 2025 mund të thuhet se ky tregues është pjesërisht i realizuar.

Treguesi 1.1.d: Ligji "Për Vullnetarizmin" i rishikuar dhe miratuar

Gjatë vitit 2022 ka nisur proces konsultimi në nivel politik dhe teknik mes Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe

Aftësive dhe rrjetit të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin”, gjatë vitit 2020 e në vijim, me qëllim identifikimin dhe adresimin e të gjitha problematikave gjatë procesit të rishikimit ligjor.

Në përfundim të procesit të konsultimeve u vendos nisja e procesit të rishikimit tërësor të Ligjit nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin” dhe nga një grup i përbashkët pune, me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe rrjetit të organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në këtë proces, ka nisur puna, duke synuar angazhimin e të gjitha resurseve të disponueshme dhe të dhënave të mbledhura gjatë dy viteve të fundit për përgatitjen e një ligji efektiv, të qëndrueshëm dhe të gjithë pranuar, që do përmirësonte strukturën e vullnetarizmit dhe krijonte një mjedis më mundësues për sektorin në Shqipëri.

Gjatë muajit korrik 2024, u zhvillua Turi i Konsultimeve me të Rinjtë “Rinia Ndryshon Ligjet” për rishikimin e ligjit "Për Vullnetarizmin" përmes takimeve të organizuara dhe të drejtuara nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me mbështetjen e grupit të punës, duke përfshirë takime të veçanta në 11 bashki të vendit përkatësisht: Kurbin, Shkodër, Lushnjë, Kuçovë, Dibër, Durrës, Librazhd, Tiranë, Tropojë, Konispol dhe në një Bootcamp të dedikuar tre ditor. Ky tur u zhvillua me qëllim lehtësimin e marrjes së kontributeve nga të rinjtë.

Grupi i punës ka hartuar dokumentet përkatëse, projektligj, relacion shoqërues dhe janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJKP) në datat 18.11.2024-16.12.2024.

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, projektligji është dërguar për mendim nëpërmjet sistemit e-aktet pranë ministrive të linjës me qëllim dhënien e mendimeve dhe propozimeve të tyre për këtë projekt-akt.

Duke pasur parasysh se gjatë vitit 2024 ka përfunduar procesi i rishikimit të projektligjit dhe miratimi i tij pritet gjatë Q3 të 2025 mund të thuhet se ky tregues është pjesërisht i realizuar.

Treguesi 1.2 a Numri/përqindja i/e bashkive që kanë ngritur kënde digjitale të informimit rinor (info-points)

Ky tregues ka si qëllim të masë shkallën e ngritjes së këndëve digjitale të informimit rinor në nivel bashkie gjatë gjithë kohëzgjatjes së Strategjisë Kombëtare për Rininë. Bazuar në SKR 2022-2029, ky tregues do të matet për herë të parë në vitin 2023, ku është parashikuar ngritja e këndeve digjitale të informimit rinor në 25 bashki që përbëjnë edhe 40% të totalit të bashkive. Bazuar në të dhënat e marra nga AKR, gjatë vitin 2023 nuk rezulton se janë ngritur kënde të tilla digjitale në bashki, duke bërë që treguesi të raportohet i mosrealizuar. Për 2024 është parashikuar që xx% e bashkive do kenë kënde të tilla digjitale. Por në 2024 nuk janë ngritur këndet digjitale. Pra treguesi nuk është realizuar.

Treguesi 1.2.b: Platforma rinore "Të rinjtë për të rinjtë" e ngritur, funksionale dhe e përditësuar

Strategjia Kombëtare e Rinisë ka parashikuar se, në fund të vitit 2022 duhet të ketë filluar përgatitja e procesit dhe infrastrukturës për ngritjen e platformës "Të rinjtë për të rinjtë".


Referuar raportimit nga institucioni përgjegjës, nuk rezulton të jenë ndërmarrë hapat e nevojshëm për përmbushjen e këtij indikator gjatë periudhës së monitorimit. Për këtë arsye treguesi nuk konsiderohet i realizuar.

QËLLIMI I POLITIKËS 2:

Novacioni, edukimi, autonomia, drejtësia si barazi (equity). Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

Për periudhën e raportimit, për këtë qëllim rezultojnë 5 (pesë) tregues performance . Realizimi i tyre jepet në grafikun e mëposhtëm

Statusi i realizimit të Treguesve për Qëllimin 2



Kështu 3 tregues të performancës ose 60% e treguesve janë të realizuar, dhe 2 tregues ose 40% e treguesve janë të realizuar pjesërisht.

Më poshtë jepet informacioni i detajuar për secilin nga treguesit e performancës, vlerat e synuara të tyre për 2024, vlerat faktike të tyre për 2024 dhe niveli i realizimit të tyre.

Treguesi 2.1.a: Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës sipas gjinisë

Në këtë tregues jepet situata e pjesëmarrjes të të rinjve dhe të rejave në tregun e punës dhe bazohet tek të dhënat e INSTAT.

Në vitin 2024, bazuar në të dhënat e Anketës së Forcës së Punës, publikuar nga INSTAT rezultojnë se për tremujorin e katërt për vitin 2024, shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve grupmosha 15-29 vjeç është 53,6 % nga të cilat 60,0 % të rinj dhe 47,2 të reja. Ndërkohë vlera vjetore e pjesëmarrjes është 54.8% ku të rinjtë e kanë shkallën e pjesëmarrjes 60.6% dhe të rejat kanë një shkallë pjesëmarrje prej 48.9%.

Ky tregues është rritur me 2,0 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2023, dhe është ulur me 2,4 pikë përqindje në krahasim me tremujorin e tretë 2024.²⁶

Në Strategji, vlera e synuar për 2024 është 53.8 %. Nëse krahasohet me vlerën faktike të vitit 2024, mund të thuhet se treguesi është i realizuar.

Treguesi 2.3.a: Shkalla e papunësisë së të rinjve (%) të ndarë sipas gjinisë

Shkalla ose norma zyrtare e papunësisë për të rinjtë 15-29 vjeç në tremujorin e katërt të 2024 është 19,1 % dhe ka pasur përmirësim nëse krahasohet me tremujorin e katërt të vitit 2023 pasi është ulur me 2,1 pikë përqindje²⁷. Ndërsa shkalla e papunësisë (norma e papunësisë) vjetore jepet në tabelën e mëposhtme

SHKALLA E PAPUNËSISË 2024			
Grupmosha	Gjithsej	Të Rinj	Të Reja
15 - 29 Vjeç	18.9%	18.8%	19.1%

Në SKR 2022 – 2029, vlera e synuar për këtë tregues performance është 20%. Siç vihet re edhe nga shifrat, objektivi është arritur dhe tejkaluar. Për këtë arsye treguesi konsiderohet i realizuar.

Treguesi 2.2.a: Numri i të rinjve që kanë marrë pjesë në programe shkëmbimi/mobiliteti arsimor

²⁶ Për më shumë shih: <https://ëëë.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/publikimet/2024/anketa-tremujore-e-forcave-t%C3%AB-pun%C3%ABs-t4-2024>

²⁷ <https://www.instat.gov.al/media/14996/atfp-tr4-2024.pdf>

Gjatë vitit 2024 janë organizuar një sërë aktivitete nga RYCO ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga shtetet e Ballkanit Perëndimor që janë pjesë e kësaj nisme. Numri total i të rinjve dhe të rejave që janë nga Shqipëria dhe që kanë marrë pjesë në aktivitetet e ndryshme është 500 të rinj dhe të reja. Gjithashtu ekzistojnë edhe programe të tjera të dhëna në tabelën e mëposhtme

INTERVET WB	139
Erasmus+ (Studentë dhe Staf)	2,311
VET for Western Balkans	6

Nëse mblidhen shifrat e raportuara, numri total i të rinjve dhe të rejave është 2956 dhe me një supozim që rreth 30 persona kanë marrë pjesë në programin CEEPUS, mund të konkludohet se nuk është arritur që numri të jetë 5% më i madh se në vitin bazë. Për këtë arsye, treguesi i performancës është pjesërisht i realizuar.

Treguesi 2.3.b: % e të rinjve që janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit

Në të gjitha VKM -të e programeve të nxitjes së punësimit , punëkërkesit e papunë të rinj të moshës 15-29 vjeç janë prioritet për tu përfshirë në programe kryesisht në programe të dedikuara për këtë kategori si programi i praktikës profesionale i cili targeton të gjithë studentët e sapodiplomuar dhe maturanët e shkollave të mesme profesionale, programi i punësimit dhe programi i vetëpunësimit i cili i jep mundësi pu.pa-ve që kanë një ide biznesi të aplikojnë dhe të përfitojnë grant deri në 500,000 lekë për hapjen e biznesit të ri.

Pu.pa 15-29 vjeç pjesëmarrës në PNP

Lloji i programit	Janar- Dhjetor 2024		
	Total	15-29 vjeç	%
V.K.M 17 (Programi 1 Punesimi)	346	167	48%
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nepermjet punes)	262	136	52%
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punes)	602	584	97%
VKM 535 (Punë në komunitet)	1135	95	8%
V.K.M 348 (Program Vetëpunësimit)	120	57	48%
Total	2,465	1,039	42%

Në 2023, numri total i të rinjve të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit ishte 1019 ose 39% e të rinjve. Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, në 2024 si numri total, si përqindja ndaj totalit janë rritur. Duke pasur parasysh që në strategji është planifikuar që të ketë trend rritës por që vlera bazë ka qenë 45%, mund të thuhet se ky tregues është pjesërisht i realizuar

Treguesi 2.3.c: % e të rinjve që kanë filluar biznesin me mbështetjen financiare të shtetit

Gjatë vitit 2023 ka vijuar zbatimi i Ligjit për mbështetjen dhe zhvillimin e startupeve²⁸ dhe thirrjeve për skemën e mbështetjes së startupeve dhe lehtësuesve të tyre përmes grantit shtetëror²⁹, si dhe skemës mbështetëse pjesëmarrjen e të rinjve në kurset profesionale në fushat e programimit kompjuterik dhe kodimit.³⁰ Referuar të dhënave të raportuara nga AKPA dhe Agjencia “Start UP Albania” janë 629 të rinj të mbështetur për ndjekjen e kurseve të formimit profesional në kodim dhe programim kompjuterik dhe janë financuar **94 startup-e dhe 94**³¹ lehtësues me grant shtetëror.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, vlera e synuar për vitin 2024, për këtë tregues është 5% rritje në raport me vitin e kaluar. Bazuar në vlerën e raportuar për vitin e kaluar (29 startup nga të rinjtë) dhe të dhënave të konfirmuara për startup e fituara nga të rinjtë, përqindja e rritjes është rreth 62.1%. Ky tregues rezulton i realizuar.

Qëllimi i politikës 3 – Mirëqenia dhe Përfshirja

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).

Në dokumentin strategjik për këtë qëllim janë parashikuar matja e 4 (katër) treguesve të performancës, nga të cilët vetëm 3(tre) janë planifikuar për t’u matur gjatë periudhës raportuese 2024. Nga analiza e bërë tre treguesve të performancës rezulton se të tre treguesit janë të përcaktuar. Kjo vjen si pasojë e (i) mospërfundimit të sondazhit që do jetë edhe burimi për njërin nga treguesit e performancës dhe (ii) mos përfshirjes në trajnime dhe në ofrimin e shërbimeve të konceptit ‘miqësor me të rinjtë’.

Më poshtë jepet analiza për secilin nga treguesit e performancës të qëllimit të politikës 3

Treguesi 3.2.a % e të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme

Ky tregues ka si qëllim të masë numrin e përgjithshëm të të rinjve që raportojnë se praktikojnë stile jetese të shëndetshme në raport me numrin përgjithshëm të të rinjve pjesëmarrës në sondazh gjatë

²⁸ <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Ligji-p%C3%ABr-mb%C3%ABshtetjen-dhe-zhvillimin-e-startup-eve.pdf>

²⁹ <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/VKM-315-Dt.11.05.2022.pdf>

³⁰ <https://riniafemijet.gov.al/rinia/kodimi-per-te-rinjte/>

³¹ [Lista-Fituese-per-shpallje.pdf](#)

periudhës raportuese. Në dokumentin strategjik është parashikuar që studimi i parë lidhur me matjen e këtij treguesi do të realizohet në 2023 dhe në 2024 % e të rinjve që raportojnë stil jetese të shëndetshëm do jetë 5% më e lartë se e vitit 2023. Nga të dhënat e raportuara nga MSHRF dhe AKR rezulton se nuk ka përfunduar sondazhi. Për këtë arsye, për 2024 treguesi konsiderohet i parealizuar.

Tregues 3.2.b % e qendrave shëndetësore të pajisura me mjedise miqësore për rininë

Treguesi ka si qëllim të masë shkallën e qendrave shëndetësore që janë të pajisura me mjedise miqësore për rininë. Edhe për këtë tregues, në dokumentin strategjik është parashikuar që studimi i parë lidhur me matjen e tij do të realizohet në 2023. Nga të dhënat e raportuara nga MSHMS rezulton se gjatë vitit 2023 ka filluar puna për realizimin e studimit, duke e bërë të pamundur raportimin e tij për vitin 2023. Në 2024 nuk ka të dhëna që janë krijuar mjedise miqësore për të rinjtë në qendrat shëndetësore. Për këtë arsye treguesi mund të konsiderohet i parealizuar.

Tregues 3.2.c % e nëpunësve publikë të trajnuar mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë

Ky treguesi ka si qëllim të masë shkallën e nëpunësve të trajnuar çdo vit mbi ofrimin e shërbimeve miqësore për rininë. Referuar dokumentit strategjik, rezulton se vlera e synuar për vitin 2023 është rritja 5% në krahasim me vitin e kaluar (2022). I njëjti parashikim është bërë edhe për vitin 2024 dhe vitet në vazhdim. Por, nga të dhënat e raportuara nga MSHRF dhe ASPA rezulton se për vitin 2024 nuk janë realizuar trajnime për nëpunës publikë në fushën e ofrimit të shërbimeve miqësore për të rinjtë. Si i tillë treguesi nuk rezulton i realizuar.

4. Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve, risqeve dhe hapat për të adresuar

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën 2023, referuar treguesve të performancës, rezulton se, objektivet specifike, që kanë treguar performancë të dobët dhe jo rezultative, janë si më poshtë:

Për sa më sipër, sfidë ngelet marrja e masave të nevojshme për fillimin e menjëhershëm të punës për kryerjen e aktiviteteve në funksion të zbatimit të masave, të cilat nuk rezultojnë me realizueshmëri të lartë, duke ndikuar kështu edhe në performancën e objektivit specifik dhe qëllimit të politikës ku bëjnë pjesë.

Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 është një dokument strategjik shumëdimensional, i cili synon të adresojë të gjithë çështjet e rinisë, duke parashikuar marrjen e masave për arritjen e objektivëve specifike dhe qëllimeve politike, në drejtim të fuqizimit, gjithë përfshirjes, arsimit, edukimit, shëndetit fizik e mendor, punësimit, lëvizshmërisë, mobilitetit të të rinjve etj.

Në këtë kuadër, institucionet përgjegjëse dhe institucionet kontribuese, të cilat kanë detyrimin e marrjes së masave dhe realizimit të aktiviteteve konkrete, janë të shumta. Drejtimi, organizimi, menaxhimi i mirë i veprimtarisë së secilit institucion, në përmbushjen e detyrave të veta, dhe veçanërisht koordinimi i punës së të gjithë institucioneve të përfshira, me qëllim edhe shkëmbimin e

informacionit dhe zgjidhjen e problemeve, janë pjesë e riskut të zbatimit të SKR-së dhe të monitorimit të zbatimit të saj.

E lidhur me sa më sipër shihet edhe fakti që, MSHRF-ja është institucioni që drejton procesin e zbatimit dhe monitorimit të SKR-së, dhe ekzistenca e stafit të reduktuar në numër të këtij institucioni është një risk që duhet të adresohet gjithashtu.

Për sa i përket, mungesës së numrit të mjaftueshëm të punonjësve të MSHRF-së, vlerësohet se, fuqizimi i Agjencisë Kombëtare të Rinisë, duke shtuar numrin e burimeve njerëzore, si institucioni në varësi të MSHRF-së, përgjegjës për zbatimin e politikave të rinisë, dhe konkretisht përgjegjës apo kontribues, në zbatimin e masave të parashikuara në SKR, është një nga hapat që duhet të ndërmerren. Në këtë kuadër, po përgatitet paketa ligjore, për propozimin e ndryshimeve strukturore të këtij institucioni, ku parashikohet edhe shtesa e punonjësve në organikën e AKR-së.

Rritja e kapaciteteve zbatuese dhe financuese, në sajë të numrit të shumtë të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në kuadër të SKR-së, si dhe faktit që zbatimi i tyre shpesh kërkon ekspertizë të veçantë, është një nga risqet e zbatimit të saj.

Bashkëpunimi me partnerët/aktorët e jashtëm, si donatorë, të cilët vënë në dispozicion të zbatimit të SKR-së dhe përmbushjes të aktiviteteve, burimet e tyre njerëzore dhe financiare, konsiderohet një vlerë dhe një nga pikat e forta të arritjeve të realizuara në kuadër të Strategjisë, dhe intensifikimi i këtij bashkëpunimi është një nga masat që duhet të ndërmerren për adresimin e mungesës së kapaciteteve zbatuese dhe financuese të SKR-së.

Me qëllim, që në të ardhmen, të përmirësohet dhe të rritet performanca e zbatueshmërisë të SKR-së, duhet të merren masat për kapërcimin e risqeve të cituara më lart, bazuar edhe në rekomandimet vijuese.

5. Konkluzione dhe rekomandime

Ky Raport është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes në kuadër të programimit IPSIS. Raporti jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës dhe të objektivave specifike të strategjisë bashë me masat respektive (output/produkte), të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave e të aktiviteteve konkrete të parashikuara, realizueshmërinë e treguesve të performancës sipas vlerave të synuara dhe atyre të arritura.

Në çdo pjesë të raportit evidentohen edhe problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve, si dhe një identifikim të masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim në procesin e zbatimit të masave prioritare.

Raporti i monitorimit janar-dhjetor 2024 përmban të dhëna statistikore dhe analitike bazuar mbi evidenca të matshme dhe të verifikueshme, mbi raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve zbatuese, mbi raporte dhe informacione të publikuara institucionet shtetërore dhe organizatat e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave janë konsultuar të gjithë faktorët (zbatues dhe vlerësues të procesit) e të dhëna mbi raport progresin e treguesve mbi baza krahasimore për çdo objektiv të strategjisë. Nga monitorimi financiar i kryer rezulton se:

Qëllimi i politikës (1) bazuar në treguesit rezulton se një shkallë realizueshmërie 83%

Qëllimi i politikës (2) bazuar në treguesit rezulton se një shkallë realizueshmërie 91%

Qëllimi i politikës (3) bazuar në treguesit rezulton se një shkallë realizueshmërie 72%

Institucionet përgjegjëse dhe kontribuuese, gjatë 8 muajve të parë, pas hyrjes në fuqi të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029, kanë dëshmuar vullnet për marrjen e hapave të menjëhershëm për zbatimin e masave të parashikuara, për çdo objektiv specifik dhe çdo qëllim politik, të këtij dokumenti të rëndësishëm strategjik, në fushën e rinisë.

Partnerët ndërkombëtar[dhe vendas kanë mbështetur zbatimin e masave të objektivave specifike edhe gjatë 2024. Kjo mbështetje ka ndihmuar në rritjen e numrit të masave të realizuara plotësisht nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara për këto masa.

Ndërkohë, mungesa e burimeve njerëzore; mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e veprimtarisë së parashikuar; mangësitë në raportimin e veprimtarive të kryera nga institucionet përgjegjëse dhe kontribuuese, duke ndikuar në kryerjen e një analizë reale dhe të saktë të zbatueshmërisë së planit të veprimit, janë faktorë që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet për vijueshmërinë e zbatimit të planit të veprimit lidhen me rezultatin e zbatueshmërisë së SKR-së në tërësi, si dhe me mangësitë e konstatuara në raportim. Në mënyrë të përmbledhur rekomandimet në përfundim të raportit të parë të monitorimit janë:

- Të ndërmerren hapat e nevojshëm për zbatimin e masave dhe objektivëve specifike, të cilët rezultojnë në nivelin e zbatimit dobët (nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara).
- Të intensifikohet bashkëpunimi mes institucioneve përgjegjëse dhe atyre kontribuuese, të cilat kanë detyrimin e ndërmarrjes së hapave të caktuar për përmbushjen e masave të parashikuara dhe kryerjen e aktiviteteve përkatëse të lidhura me to, me qëllim rritjen e nivelit të realizimit të masave dhe të saktësisë së raportimit.
- Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dërgohet në përputhje me kategorinë e informacionit, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike në përputhshmëri me raportet që prodhojnë institucionet përgjegjëse;
- Të sigurohet mbështetje financiare për masat që nuk ka buxhet për periudhën vijuese, nëpërmjet parashikimit në PBA ose nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me donatorët;
- Të rritet niveli i bashkëpunimit me AMVV dhe bashkitë e vendit, si institucione të rëndësishme në zbatimin e disa prej masave të parashikuara në SKR në nivel vendor,
- Të merren masat e nevojshme, që përveç zbatimit të masave të parashikuara, të rritet, në të ardhmen, zbatueshmëria e treguesve të performancës për çdo objektiv specifik dhe sidomps për treguesit e performancës të identifikuar nën qëllimin e politikës 3;
- Të konsolidohet metodologjia e raportimit dhe mekanizmat e parashikuar për kryerjen e monitorimit dhe vlerësimit të zbatueshmërisë së SKR-së;
- Të sigurohen trajnime për personat përgjegjës, që merren me monitorimin e strategjive, për të patur një raportim eficient, në kohë dhe në përmbajtje;

- Të evidentohen nga institucionet përgjegjëse problematikat e hasura në mos përmbushjen e masave dhe aktiviteteve, duke plotësuar në instrumentin e raportimit edhe vlerësimin e riskut.

6. Hapat e radhës

- Përmirësimi i koordinimit me palët e interesit:

Veprimtaria duhet të intensifikojë koordinimin me të gjithë palët e përfshirë, duke përfshirë institucionet, ministrat e linjës, organizatat rinore, të rinjtë, punonjësit rinorë, Këshillat vendore rinore dhe të tjerë. Një përpjekje e përbashkët për të siguruar një bashkërendim të ngushtë do të forcojë efektivitetin dhe implementimin e masave.

- Rishikimi i Ligjit të Rinisë dhe Ligjit të Vullnetarizmit:

Masat duhet të zbatohen në përputhje me parashikimet dhe qëllimet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë për periudhën 2022-2029. Finalizimi i procesit të miratimit të Rishikimi i Ligjit të Rinisë dhe Ligjit të Vullnetarizmit do të mund të konsolidojë bazën ligjore për zbatimin e masave dhe përmirësimin e mjedisit ligjor për rininë.

- Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe ndjekjes së masave të parealizuara:

Një sistem i përmirësuar i monitorimit duhet të implementohet për të vlerësuar progresin dhe për të ndjekur masat që nuk janë ende realizuar. Përveç kësaj, duhet të ndërmerren masa adekuate për të adresuar çështjet e identifikuara dhe për të përmirësuar ndjekjen e tyre.

- Integrimi i çështjeve të rinisë në procesin e raportimit për Bashkimin Evropian:

Raportimi periodik në BE përfshin masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë në kontekstin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian. Në këtë kuadër, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët përgatit dhe përcjell në mënyrë periodike kontributin e tij në fushën e rinisë, si pjesë e Kapitullit 26 ‘Arsimi dhe Kultura’, pranë strukturave negociatore dhe Zyrës së Kryenegociatorit, në lidhje me zhvillimet më të fundit në këtë sektor.”

- Vazhdimi i impaktit tek të rinjtë dhe rishikimi i masave:

Vazhdimi i vlerësimit të impaktit të masave të zbatuara në të rinjtë duhet të jetë një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve. Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, është e rëndësishme rishikimi i masave sipas nevojave dhe aspiratave të të rinjve.

- Vijimi i zbatimit të masave sipas planit

Vijimi i zbatimit të masave sipas planit është i domosdoshëm për të siguruar vazhdimësinë e ndërhyrjeve dhe arritjen e objektivave të parashikuara në fushën e rinisë.

Raport Monitorimi për Zbatueshmërinë e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 për periudhën Janar-Dhjetor 2024, është mbështetur me ekspertizë nga UNDP Albania dhe UNFPA Albania.